



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 453 Akti

Nr. 612 Vendimi
Tiranë, më 13.1.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|--------------------------|------------------|
| Brunilda Bekteshi | Kryesuese |
| Firdes Shuli | Relatore |
| Suela Zhegu | Anëtare |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 10.1.2023 dhe 13.1.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Saimir Bahiti**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneres Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Saimir Bahiti është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 26.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bektashi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Po kështu, në datën 13.1.2020, subjekti deklaroi përmes postës elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 12.4.2022, për nevoja të hetimit administrativ, trupi gjykues vendosi administrimin e dosjes që i përket bashkëshortes së subjektit, znj. E. B., gjatë procesit të saj të rivlerësimit. Përmes komunikimit elektronik të datës 16.4.2022, subjekti u shpreh dakord me të gjitha deklaratimet dhe përgjigjet e bashkëshortes së tij E. B.

6. Me vendimin nr. 3, datë 9.12.2022, trupi gjykues vendosi të pranojë gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar sipas opinionit/gjetje të datës 7.12.2022 dhe me aprovimin e tij u çmua të mos kryhen hetime të tjera shtesë.

7. Me vendimin nr. 4, datë 9.12.2022, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 15.12.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ dhe kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, jo më vonë se data 5.1.2023; (ii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 5.1.2023, subjekti i rivlerësimit dërgoi përmes postës zyrtare parashtrimet e tij dhe dokumentacionin shoqëruar mbi rezultatet e hetimit administrativ.

10. Me vendimin nr. 5, datë 6.1.2023, trupi gjykues vendosi kalimin e çështjes në seancë dëgjimore.

11. Në datën 10.1.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

13. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45,46, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga DSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe çdo informacion i marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinionet të vëzhguesit të ONM-së sipas pikës 11 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Vlerësimi i pasurisë

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 24.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007, me nr. indeksi ***, ka dorëzuar sipas ligjit deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) në vitin 2007 dhe në vijim ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë dhe, në përfundim të veprimeve verifikuese, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit

të rivlerësimit Saimir Bahiti, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016.

19. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruar në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit

20. *Pasuria me nr. ***, nr. *** zona kadastrale. Lloji: tokë “arë” me sip. 2225 m². Adresa: ***, Librazhd. Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 26.11.2004, me palë shitëse V. B. dhe familja e tij bujqësore dhe blerëse T. B., L. B., Sh. B., Saimir Bahiti dhe J. B. Burimi i krijimit janë të ardhurat familjare të blerësve. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 20%, me anëtarët e trngut tim familjar dhe 50% e 20% me bashkëshorten.*

21. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar: (i) pasuria tokë-arë me sip. 2.225 m², në ***, Librazhd, nuk konfirmohet nga ZVRPP-ja Librazhd, por subjekti ka paraqitur certifikatë pronësie, ku figuron bashkëpronar me 1/5; (ii) subjekti nuk ka paraqitur kontratën për fitimin e bashkëpronësisë të tokës arë me sip. 2.225 m², në ***, Librazhd.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

22. Në lidhje me origjinën, mënyrën e përfitimit të pasurisë, deklaratimet e subjektit, gjendjen juridike, u verifikuan aktet e ILDKPKI-së dhe dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ¹, si vijon.

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie me datë 26.12.2001 në emër të shtetasit V. D. B. (xhaxhai i subjektit²), figuron e regjistruar në pronësi pasuria e llojit “arë”, me nr. ***, me sip. 2225 m², ***, Librazhd, përfituar me AMTP;

- me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.11.2004, blerësit T. D. B. (babai i subjektit), L. B., Sh. B., Saimir Bahiti dhe J. B. kanë blerë nga shitësit V. B, etj., pasurinë me nr. ***, me çmim 100.000 lekë;

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie të lëshuar në datën 1.12.2004, shtetasi Saimir Bahiti ka të regjistruar bashkëpronësinë në 1/5 pjesë takuese mbi pasurinë me nr. ***, vërtetuar edhe me kartelën e pasurisë me datë printimi 20.10.2021³.

23. Të pyetur pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2016, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar se kjo pronë është përfituar me anë të kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 7.1.2002⁴. Gjatë procesit të saj të rivlerësimit, znj. B.⁵ ka dhënë sqarime e dokumente shkresore në lidhje me shkaqet e ekzistencës së dy kontratave të shitjes, të cilat u vlerësuan bindëse, sikurse është pasqyruar në mënyrë më të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, dërguar

¹Shihni aktet në aneksin 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së ;shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.9.2021, nga ASHK-ja Librazhd në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.02.2020, nga ASHK-ja Librazhd në dosjen e Komisionit, si dhe procesverbalin e datës 25.3.2016, i mbajtur pranë ILDKPKI-së dhe dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021, nga ILDKPKI-ja në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

²Shihni certifikatat familjare që provojnë marrëdhënien familjare, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

³Shihni dokumentin në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

⁴Shihni kontratën bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021, nga ILDKPKI-ja në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

⁵Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 20.9.2021, në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

subjektit Saimir Bahiti. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni e konsideroi pasurinë të blerë në vitin 2004, duke e përfshirë si shpenzim gjatë këtij viti. Po kështu, mbi këtë pasuri nuk rezultoi të jenë kryer investime, vërtetuar me imazhet satelitore dhe ortofoto të pasurisë “arë”, ndodhur në ***, Librazhd, nga të cilat nuk vërehen ndërtime mbi sipërfaqen e tokës, si dhe me vërtetimin datë 14.10.2021, lëshuar nga Bashkia Librazhd, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi T. B. nuk ka detyrime të papaguara në këtë njësi.

24. Bazuar në shpjegimet dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti⁶, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të babait të subjektit për blerjen e tokës arë, në shumën 100.000 lekë më 26.11.2004 dhe nga analiza financiare rezultoi se është justifikuar blerja e saj me të ardhura të ligjshme.

25. Pasuria me nr. ***, nr. ***, zona kadastrale. Lloji i pasurisë “apartament” me sip. 87.3 m² dhe 73.5 m² verandë. Adresa: rruga “***”, ish-kompleksi “***”, Tiranë. Kontrata e shitblerjes me nr. ***, datë 27.7.2012. Vlera: 104.000 euro. Pjesa takuese: 50%.

Burimi i krijimit:

a. Depozita bankare në “Raiffeisen Bank”, me nr. *** llogarie, në emër të z. Saimir Bahiti, datë 4.7.2012, në vlerën 3.000.000 lekë, ku janë depozituar të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes. Dokumentet bankare.

b. Huaja e marrë nga shtetasi P. G., me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 50.000 euro. Kontrata e huas me nr. ***, datë 4.7.2012.

c. Huaja e marrë nga shtetasi I. H., me qëllimin e blerjes së apartamentit në vlerën 3.000.000 lekë. Shkresa e thjeshtë lëshuar me shkrim dore nga shtetasi I. H. datë 1.7.2012. Deklarata noteriale me nr. ***, datë 24.10.2012. Shkresa e thjeshtë e lëshuar me shkrim dore nga shtetasi I. H. datë 20.12.2014. Shkresa e thjeshtë e lëshuar me shkrim dore nga shtetasi I. H. datë 20.12.2015. Huaja ndaj këtij shtetasi është shlyer. Deklarata noteriale me nr. ***, datë 23.12.2016. Si burime kanë shërbyer të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, si dhe vlera prej 10.000 euro dhuruar nga vjehrra N. B., deklarata noteriale me nr. ***, datë 6.9.2012.

d. Huaja e marrë nga shtetasi S. A., me qëllimin e blerjes së apartamentit, në vlerën 1.200.000 lekë. Shkresa e thjeshtë lëshuar me shkrim dore nga shtetasi S. A. datë 1.7.2012. Deklarata noteriale me nr. ***, datë 21.12.2016.

26. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar:

- Deklarim i rremë nga ana e subjektit Saimir Bahiti lidhur me pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, pasi të dhënat nga dokumentacioni i administruar, lidhur me shumën e paguara dhe datat e pagesës janë kontradiktore; sipas kontratës së shitjes, në datën 27.7.2012, çmimi prej 104.000 euro është likuiduar, ndërsa një pagesë prej 7.000 euro bëhet në datën 29.7.2012, si këst i fundit.

- Pagesat e kryera ndaj shoqërisë “***” sh.p.k., sipas DPPPP-së, për blerje apartamenti të kryera në periudhën nëntor-dhjetor 2012, si dhe derdhja në BKT për likuidim këst apartamenti në shumën 21.493 euro, nuk përkojnë me deklarinimin e kryer nga subjekti, rrjedhimisht subjekti ka deklarim të rremë lidhur me vlerën e paguar për apartamentin në rrugën “***”, dhe/ose ka fshehje të pagesave gjatë periudhës së konfirmuar dhe qëllimit të tyre gjithashtu.

⁶Vërtetime nga Njësia Administrative Librazhd lidhur me përfitimet nga statusi i të verbrit, si dhe përfitimet nga statusi i invalidit për z. T. B.; vërtetim nga ISSH-ja lidhur me të ardhurat e përfituara nga z. T. B. për periudhën 1.1.1994 – 31.1.2001, në dosjen e Komisionit.

- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit P. G., por ka paraqitur ekstraktin historik të QKR-së, për aktivitetin e regjistruar në emër të tij, si dhe tërheqjen e shumave monetare nga llogaria e shoqërisë.
- Deklarim i rremë lidhur me burimin financiar të huadhënësit P. G., të pretenduar nga subjekti Saimir Bahiti, pasi palët deklarojnë burime të ndryshme. Marrja e shumës 50.000 euro nuk është nëpërmjet sistemit bankar.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit S. A., por ka paraqitur nxjerrje llogarie të tij, në të cilat evidentohen kreditimet nga paga. Vërehet dypunësim i tij për periudhën 2012 – 2013.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar të huadhënësit I. H. për shumën 3.000.000 lekë, por ka paraqitur nxjerrje llogarie të tij, në të cilat evidentohen kreditimet nga paga apo përfaqësimet e këtij shtetasi për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., të cilat nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar aftësinë e tij financiare për të dhënë hua. Gjithashtu, ka paraqitur ekstraktin historik për regjistrimin e huadhënësit I. H., për aktivitet si person fizik, i cili mban datën 18.4.2013, periudhë jo e vlefshme për justifikimin e burimit të shumës së huas prej 3.000.000 lekësh, dhënë në vitin 2012. Huamarrja dhe kthimi i saj janë jashtë sistemit bankar.
- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për blerjen e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, i cili është financiar 3.000.000 lekë nga kursime të subjektit dhe bashkëshortit, ndërsa pjesa tjetër me huamarrje në shumat 50.000 euro, 3.000.000 lekë dhe 1.200.000 lekë, të cilat mbeten të dyshimta dhe të paargumentuara.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

27. Në lidhje me mënyrën e përfitimit, deklaratimet e subjektit dhe statusin aktual juridik të pasurisë, nga aktet në dosje⁷ rezultoi se:

- Sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 4.7.2012, porositi Saimir Bahiti ka porositur nga sipërmarrësi shoqëria “****” sh.p.k., ndërtimin e një apartamentit me nr. ***, me sipërfaqe të përgjithshme 99.20 m², nga të cilat sipërfaqe banimi 87.3 m², 73.50 m² verandë dhe sipërfaqe e përbashkët 11.9 m², me çmim 104.000 euro.
- Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të datës 21.7.2012, në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. figuron pasuria me nr. ***, e cila i është shitur subjektit me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.7.2012, me vlerë 104.000 euro.
- Kjo pasuri u regjistrua në emër të subjektit sipas vërtetimit të datës 13.8.2012 dhe është deklaruar në DPV/2012 me të njëjtat të dhëna si në deklaratën *Vetting*.
- FSHU-ja⁸ ka konfirmuar në emër të shtetasit Saimir T. Bahiti kontratën e furnizimit me energji nr. ***. UKT-ja⁹ ka konfirmuar në emër të shtetasit Saimir Bahiti kontratën me nr. ***.
- Referuar kartelës së pasurisë të paraqitur nga ASHK, Tirana Jug¹⁰, rezultoi e regjistruar në pronësi të subjektit Saimir Bahiti pasuri e llojit “apartament” me sip. 87.30 m², me nr. pasurie ***. Gjatë procesit të rivlerësimit, pas aplikimit në portalin *e-albania*, subjekti paraqiti përgjigjen e ASHK Tirana Jug të datës 7.6.2022, në të cilën konfirmohet e regjistruar në pronësi të tij pasuria apartament nr. ***, me nr. ***, z.k. ***, me sip. 87.3 m² dhe sipërfaqe verande 73.5 m².

⁷Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, nga FSHU-ja në dosjen e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.02.2020, nga UKT-ja në dosjen e subjektit Saimir Bahiti.

¹⁰Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.2.2020, nga ASHK Tirana Jug, në dosjen e Komisionit.

28. Në lidhje me mënyrën e pagesës së çmimit të shitjes 104.000 euro, rezultoi se:

28.1. Nga aktet e administruara¹¹ u vërtetua se:

- Në nenin 13 të kontratës së sipërmarrjes të datës 4.7.2012, përcaktohet se pagesa e çmimit prej 104.000 euro, do të bëhet në këtë mënyrë: (i) 97.000 euro do të paguhen me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes; (ii) 7.000 euro do të paguhen me dorëzimin e hipotekës dhe likuidimi do të kryhej në rrugë bankare.

- Në kontratën e shitjes së datës 27.7.2012, në nenin 2.2 të saj, përcaktohet se çmimi prej 104.000 euro është paguar totalisht nga blerësi përpara lidhjes së kësaj kontrate dhe shitësi nuk ka më pretendime për të.

- Bashkëngjitur deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur: (i) mandatarkëtimin nr. ***, datë 4.7.2012, sipas të cilit Saimir Bahiti ka paguar *cash* në arkën e shoqërisë shumë 97.000 euro, me përshkrimin "*pagesë për ap. ****"; (ii) shkresë e titulluar "arkëtim" (me shkrim dore), në të cilën pasqyrohet: "*Saimir Bahiti, ap. ***, depozitoi sot në datën 29.7.2012 shumë 7.000 euro, për këstin e fundit të ZVRPP-së. Nesër në datën 30.7.2012 jemi gati për kontratën e shitjes*". Shkresa është nënshkruar nga shtetasja J. N. me vulë të S. M. A.

28.2. Sikurse vërehet, ka një paqartësi në lidhje me datën e likuidimit të plotë të çmimit të shitjes, pasi në kontratën e shitjes me datë 27.7.2012 përcaktohet shprehimisht se pagesa e çmimit prej 104.000 euro është likuiduar plotësisht përpara lidhjes së saj, ndërkohë që sipas shkresës së titulluar "Arkëtim", shuma prej 7.000 euro është likuiduar nga subjekti në datën 29.7.2012.

28.3. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me paqartësinë mbi datën e likuidimit të çmimit të shitjes. Në parashtrimet e tij, ashtu sikurse gjatë procesit, subjekti vijoi të deklarojë se e gjithë vlera e apartamentit është paguar *cash* sipas dy mandatarkëtimeve përkatësisht në datat 4.7.2012 dhe 29.7.2012, pagesa që sipas tij përputhen me përshkrimin e bërë në kontratën e sipërmarrjes. Ndërsa deklaroi se shënimi në kontratën e shitblerjes është gabim material ose *lajthim*, shpjeguar nga ana e noterit në dokumentin "Vërtetim për aktin e realizuar nga zyra noteriale" lëshuar nga noterja L. P. Sipas këtij dokumenti, palët e kanë nënshkruar kontratën e shitjes nr. ***, në datat si vijojnë: pala shitëse ditën e premte datë 27.7.2012 dhe pala blerëse ditën e hënë datë 30.7.2012, pasi ka realizuar pagesën e këstit të fundit të çmimit të shitjes. Noterja deklaroi gjithashtu se ka konsideruar si datë të aktit datën 27.7.2012, por konfirmon se nënshkrimi i aktit nga të dyja palët ka përfunduar në datën 30.7.2012.

28.4. Referuar legjislacionit mbi noterinë¹², akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve, rregull që në rastin konkret nuk është zbatuar nga noterja L. P. Referuar deklaratimeve të noteres e cila pranoi parregullsinë dhe rrethanave tërësore në lidhje me likuidimin e çmimit prej 104.000 euro, në përfundim të procesit u vlerësua që rregjistrimi i aktit në datën 27.7.2012 është bërë pa u nënshkruar akti edhe nga pala blerëse, si dhe, u vlerësua i besueshëm fakti që kjo palë ka nënshkruar në datën 30.7.2012, pasi kësti prej 7000 eurosh ishte likuiduar një ditë më parë, sipas shkresës së titulluar "arkëtim".

29. Nga informacioni i administruar nga DPPPP-ja¹³, rezultoi se: (i) ka raportime të transaksioneve bankare ku identifikohet se në datën 3.12.2012 (pra, pas lidhjes së kontratës së shitjes) z. Saimir Bahiti ka derdhur në BKT shumë prej 21.493,55 euro me përshkrimin "*Saimir Bahiti derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. ****"; (ii) ka 7 raportime nga shoqëria "****" sh.p.k. për pagesa kësti gjatë muajve nëntor – dhjetor 2012 (pra, pas lidhjes së kontratës së shitjes) në shumë totale 88.609 euro nga shtetasi Saimir Bahiti me përshkrimin

¹¹Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹²Në nenin 49 të ligjit nr. ***, datë 1.6.1994, "Për noterinë", i ndryshuar, përcaktohet se: "*Akti noterial hartohet nga noteri në prani të palëve*".

¹³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.01.2020, nga DPPPP-ja në dosjen e Komisionit.

“pagesë kësti për blerje apartamenti”. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga BKT-ja¹⁴ dhe “Credins Bank”¹⁵.

30. Për të qartësuar situatën në lidhje me pagesat e kryera për blerjen e pasurisë objekt verifikimi pasi ishte kryer kalimi i pronësisë me akt noterial në datën 27.7.2012, duke marrë shkas nga informacioni bankar dhe ai i paraqitur prej DPPPP-së, janë administruar informacionet si vijojnë:

30.1. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, mbi kohën dhe mënyrën e pagesës së shumës prej 104.000 euro, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë informuar se¹⁶ transaksioni është kryer *cash* në zyrat e kompanisë ndërtuese sipas mandatpagesave me nr. ***, në datat 4.7.2012 dhe 29.7.2012, cituar në paragrafin 28/1 më sipër.

30.2. Shoqëria “***” sh.p.k. në përgjigjen e saj të datës 16.6.2021¹⁷, informoi fillimisht se “...pagesa për këtë apartament është kryer me këste në llogarinë bankare të subjektit ‘***’ sh.p.k. dhe asnjë këst nuk është paguar *cash* (me para në dorë) në arkën e subjektit”. Bashkëngjitur përgjigjes së saj, ndër të tjera, shoqëria ka depozituar dokumentet shkresore:

- Kartelë llogarie ku evidentohen pagesat e kryera nga blerësi i pasurisë/klienti Saimir Bahiti për apartamentin nr. **, sipas të cilës në “Credins Bank” është depozituar shuma në total 82.566 euro dhe në BKT shuma 21.493,55 euro (gjithsej 104.059.55 euro sa është çmimi i blerjes sipas kontratës së shitjes), pasqyruar në tabelën si më poshtë.

| Data | Banka | Vlera e paguar (në euro) |
|---------------|--------------|--------------------------|
| 30.7.2012 | Credins Bank | 7.000,00 |
| 31.10.2012 | Credins Bank | 4.450,00 |
| 6.11.2012 | Credins Bank | 5.500,00 |
| 7.11.2012 | Credins Bank | 10.000,00 |
| 15.11.2012 | Credins Bank | 4.000,00 |
| 19.11.2012 | Credins Bank | 10.000,00 |
| 26.11.2012 | Credins Bank | 10.000,00 |
| 3.12.2012 | BKT | 21.493.55 |
| 11.12.2012 | Credins Bank | 27.000,00 |
| 12.12.2012 | Credins Bank | 4.616,00 |
| Totali | | 104 059.55 euro |

- Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2012 “Deklaratë për marrjen në dorëzim të njësisë ***” në të cilën blerësi Saimir Bahiti deklaroi se ka kryer pagesën e shumës 97.000 euro dhe diferencën prej 7.000 euro do ta paguajë pasi të pajiset me dokumentin nga ZVRPP-ja. Përmes kësaj deklarate, bashkëshorti i subjektit ka marrë në dorëzim apartamentin e porositur.

30.3. Duke qenë se përgjigjja e shoqërisë “***” sh.p.k. ishte në mospërputhje me mënyrën e likuidimit të deklaruar nga subjekti, i cili ka deklaruar në mënyrë vijuese likuidimin *cash* të çmimit në arkën e shoqërisë, trupa gjyquese që ka rivlerësuar znj. B. ka kërkuar nga shoqëria

¹⁴Shihni në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B. dokumentet si vijojnë: shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2021, drejtuar BKT-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 22.6.2021, nga BKT-ja.

¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 22.6.2021, drejtuar “Credins Bank”; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021, e “Credins Bank”.

¹⁶Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.4.2020, në dosjen e subjektit dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.4.2021, nga ILDKPKI-ja në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

¹⁷Shihni dokumentet si vijojnë në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.: shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2021, drejtuar shoqërisë “***” sh.p.k.; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, e shoqërisë “***” sh.p.k.

sqarime të mëtejshme. Shoqëria “****” sh.p.k. në përgjigjen e saj të dytë të datës 23.6.2021¹⁸, konfirmoi sërish se “nga verifikimi i dokumentacionit përkatës të kësaj praktike shitjeje, rezulton se pagesat në llogarinë bankare të shoqërisë janë kryer nga vetë z. Bahiti”.

30.4. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit të saj, znj. B. ka vijuar të konfirmojë se pagesat janë kryer *cash* në dy këste¹⁹, dhe se, bashkëshorti i saj nuk ka kryer asnjë pagesë në bankë për llogari të shoqërisë, pasi këto pagesa janë kryer nga punonjës të saj.

Hetimi i Komisionit në lidhje me pagesat e kryera pranë “Credins Bank”

31. Në lidhje me kreditimet në “Credins Bank”, Komisioni iu referua deklarimeve dhe provave shkresore që znj. B. ka vënë në dispozicion si vijojnë:

Së pari, sipas shkresës nr. *** prot., datë 1.10.2021, të “Credins Bank”, nga periudha korrik 2012 dhe deri në dhjetor 2012, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. janë kryer tetë derdhje me përshkrimin me datat dhe vlerat si vijojnë: mandati datë 30.7.2012 derdhje 7.000 euro me përshkrimin “Saimir Bahiti këst hipoteke ap. ***”, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. O. (mbiemri i palexueshëm) dhe mandatet e datave 31.10.2012, 6.11.2012, 7.11.2012, 19.11.2012, 26.11.2012, 11.12.2012 dhe 12.12.2012, me përshkrimin “*derdhje Saimir Bahiti këst apartamenti 454*”, me depozituese dhe nënshkruar nga znj. S. A. Në total vlera e depozituar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. në “Credins Bank” është 82.566 euro. Siç vërehet, ndonëse në përshkrimin e veprimeve bankare të kryerjes së këtyre pagesave është emri i subjektit, depozitimet rezultojnë të jenë bërë jo nga z. Bahiti, por nga shtetas të tjerë.

Së dyti, sipas shkresës kthim përgjigjeje me datë 1.10.2021 të shoqërisë “****” sh.p.k.: (i) në datën 29.7.2012 është dorëzuar nga subjekti vlera e arkëtuar *cash* prej 7.000 euro, shumë e cila është pranuar nga subjekti tregtar “****”, duke u nënshkruar një dokument nga shtetasja J.N., punonjëse e kësaj shoqërie, që sipas saj, është edhe konsulente e jashtme e shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo ka ndodhur meqenëse zyrat e shoqërisë “****” sh.p.k. kanë qenë të mbyllura atë ditë, dhe ditën e nesërme në datën 30.7.2012, shuma 7.000 euro është derdhur në arkën e shoqërisë “****” sh.p.k.; (ii) vlera e arkëtuar 97.000 euro sipas mandatarëkëtimit nr. ***, datë 4.7.2012, nga subjekti Bahiti, është depozituar pjesë-pjesë në banka (BKT dhe “Credins Bank”) në ditë të ndryshme, nëpërmjet punonjësve të shoqërisë dhe në përshkrimin e depozitimeve janë vendosur të dhënat e kontratës për apartamentin e blerë nga z. Bahiti, si dhe emri i z. Bahiti, për të bërë verifikimin e klientit dhe rakordimin e klientit nga vetë shoqëria.

32. Nga përmbajtja e shkresës së datës 1.10.2021 të shoqërisë “****” sh.p.k., konstatohet se në ndryshim nga dy përgjigjet e mëparshme, përkatësisht shkresave me data 16.6.2021 dhe 23.6.2021, përshkruar në paragrafët 30.2 dhe 30.3 më sipër, shoqëria konfirmon se pagesat për likuidimin e çmimit të shijes janë likuiduar *cash* nga z. Bahiti, dhe se, derdhjet në banka janë kryer nga punonjësit e shoqërisë.

33. Me qëllim qartësimin e situatës në lidhje me mospërputhjen e informacionit u thirr në cilësinë e dëshmitarit shoqëria “****” sh.p.k. Në dëshminë e dhënë²⁰, znj. A. P. si përfaqësuese e firmës kontabël që mban dhe përgatit bilancet e shoqërisë “****” sh.p.k., e pyetur mbi kontradiktat e përgjigjeve të dhëna nga shoqëria, informoi se dy përgjigjet e para të shoqërisë ishin përgatitur nga persona që nuk ishin në dijeni të historikut të shoqërisë, pasi personi përgjegjës për të mbajtur veprimet kontabël kishte dalë në pension, pak muaj përpara kthimit të përgjigjes. Më tej ajo deklaroi se z. Bahti ka derdhur *cash* në arkën e shoqërisë shumë e çmimit të shitjes, të cilat pasqyrohen edhe në librat e arkës, dhe më tej konfirmoi se, pagesat në bankë, të cilat vërtet janë në emër të z. Bahiti, nuk janë kryer prej tij, por nga personeli i

¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2021, drejtuar shoqërisë “****” sh.p.k.; kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.6.2021, e shoqërisë “****” sh.p.k. në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

¹⁹Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 20.9.2021, në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

²⁰Shihni procesverbalin e datës 7.7.2022 për marrjen e deklarimeve të përfaqësueses së shoqërisë “****” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

shoqërisë. Në këto kushte, sipas saj, ka pasur pakujdesi në kthimin e përgjigjeve të para nga ana e shoqërisë. Gjithashtu, znj. P. deklaroi se ka qenë praktikë e ndjekur nga shoqëria, që në interes të shitjeve të sa më shumë pasurive, çmimi i blerjes është likuiduar *cash* nga klientët blerës, dhe më pas, shumat derdreshin në bankë nga punonjës të shoqërisë.

34. Për të mbështetur pretendimet e saj, znj. P. ka paraqitur dokumentet e poshtëshënuara:

- autorizim të datës 6.7.2022 të lëshuar nga administratori i shoqërisë F. B., përmes të cilit autorizohet znj. A. P. për të dhënë deklarime e përfaqësuar shoqërinë “****” sh.p.k. përpara Komisionit;
- deklaratë për marrje në dorëzim të njësisë nr. ***, nr. *** prot., datë 5.7.2012, në të cilën deklaruesi Saimir Bahiti deklaroi se ka paguar shumën 97.000 euro, kurse shumën prej 7.000 euro do ta paguajë kur të pajiset me dokumentin nga ZVRPP-ja;
- vërtetim nga dokumentet hipotekore, të datës 21.7.2012, sipas të cilave apartamenti me sip. 87.3 m² figuron i regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.;
- vendim i asamblesë së ortakut të vetëm të shoqërisë “****” sh.p.k., nr. *** prot., datë 20.7.2012, sipas të cilës është miratuar nga ana e ortakut të vetëm F. B., firmosja nga ana e administratorit të shoqërisë të dy kontratave të shitblerjes, një nga të cilat i përket subjektit Saimir Bahiti dhe në këtë dokument përshkruhet apartamenti me sip. 73 m², me vlerë 104.000 euro;
- ekstrakte të lëvizjes së llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k., në “Credins Bank” dhe BKT të vitit 2012, në të cilat evidentohen të gjitha derdhjet *cash* të pasqyruara në tabelën paraqitur më sipër në paragrafin 30.2, në total në shumën 104.059,55 euro, ku secila mban përshkrimin “derdhje *cash*, Saimir Bahiti këst apartamenti nr. ****”²¹;
- deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.6.2022, të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k. z. F. B., në pikën 6 të së cilës ai ka deklaruar se: “...për kontratën e shitjes me z. Saimir Bahiti, shoqëria ‘***’ sh.p.k. ka deklaruar në organet tatimore faturën e shitjes për vlerën totale të apartamentit të shitur, 104.000 euro ekuivalente me 14.301.040 lekë sipas faturës nr. ***, datë 27.7.2012. Bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni edhe librin e shitjes të muajit korrik, të gjeneruar nga sistemi tatimor, ku për arsye konfidencialiteti janë fshirë emrat e klientëve të tjerë për të cilët është faturuar atë muaj”;
- një faqe nga libri i shitjeve të shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilën janë pasqyruar të dhëna për 18 veprime shitjeje të shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 23 korrik deri më 31.7.2012, midis të cilave evidentohet se në datën 27.7.2012, është regjistruar arkëtimi nga shtetasi Saimir Bahiti në shumën 14.301.040 lekë ose 104.000 euro²²;
- tetë kontrata porosie/sipërmarrjeje të vitit 2011 të lidhura nga shoqëria “****” sh.p.k.

35. Duke qenë se nga dëshmia e znj. P., nuk rezultoi e qartë nëse ka pasur raste të tjera të ngjashme kur pagesat e çmimit të shitjes janë kryer si në rastin e subjektit Bahiti nga punonjës të shoqërisë, nga ana e Komisionit iu kërkua asaj që shoqëria të vërë në dispozicion raste të tilla të ngjashme. Për shkak se shoqëria “****” sh.p.k., nuk e vuri në dispozicion një informacion të tillë, nga ana e Komisionit me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime e të dokumentojë raste të tjera të kësaj natyre.

36. Në parashtrimet e tij subjekti ka informuar se lidhur me këtë çështje i është drejtuar përmes postës elektronike përfaqësueses së shoqërisë “****” sh.p.k. që administron dokumentacionin e shoqërisë “****” sh.p.k., znj. A. P., dhe se, ende nuk ka një përgjigje prej saj. Më tej, ai informoi se pas shumë përpjekjeve ka mundur të sigurojnë dy praktika të ngjashme të banorëve të kompleksit si vijojnë: (i) praktika e kontratës së porosisë së z. B. R. me shoqërinë “****” sh.p.k.; (ii) praktika e kontratës së sipërmarrjes së z. B. L. Sipas subjektit, referuar këtyre praktikave rezultoi se një pjesë e vlerës së apartamentit është paguar *cash* nga blerësit, në zyrat e shoqërisë

²¹Në disa veprime derdhjeje nuk pasqyrohet numri i apartamentit.

²²Kursi i këmbimit euro: lekë të përdorur nga shoqëria “****” sh.p.k. është 137.51, për afërsisht ndërsa kursi mesatar i muajit korrik 2012 sipas Bankës së Shqipërisë.

“***” sh.p.k. sipas mandatarkëtimeve përkatëse. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore²³, nga analiza e të cilave u konstatua se çmimi i shitjes është paguar nga vetë blerësit pjesërisht në bankë (në pjesën më të madhe) dhe pjesërisht në arkën e shoqërisë me mandatarkëtim.

Hetimi i Komisionit në lidhje me pagesën e kryer pranë BKT-së në datën 3.12.2012

37. Në lidhje me veprimin pranë BKT-së të datës 3.12.2012, me përshkrim “*Saimir Bahiti derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21.500 euro – komisioni 0,03 %, në vlerën 21,493.55 euro*”, bashkëshortja e subjektit ka informuar se²⁴ pas kërkesës së tyre në BKT është administruar praktika e këtij veprimi, konkretisht dokument “*depozitim cash jo titullare*” datë 3.12.2012 të shumës *neto* 21.493.55 euro, me përshkrimin “*derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. ****” dhe mandatarkëtimi datë 3.12.2012 në shumën 21.493.55 euro, si këst apartamenti nr. ***. Pas njohjes me këto dokumente të cilat kishin urdhërues z.Saimir Bahiti, ajo dhe bashkëshorti konstatuan se shkrimi emër mbiemër Saimir Bahiti, si dhe nënshkrimi, nuk ishin shkrimi dhe nënshkrimi i bashkëshortit të saj. Të ndodhur në këto kushte, i është kërkuar një ekspert privat që të kryejë ekspertimin grafik të tyre, dhe sipas aktekspertimit grafik me datë 30.9.2021, ka rezultuar se dy nënshkrimet e plota emër mbiemër firmë, të shkruara në emër të Saimir Bahitit, në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, nuk janë shkruar dhe nënshkruar nga shtetasi Saimir Bahiti. Dy nënshkrimet e plota emër mbiemër firmë, të shkruara në fund të dy dokumenteve bankare objekt ekspertimi, janë shkruar nga i njëjti person. Firmat në këto dy nënshkrime, janë të sajuara grafiksht.

38. Në parashtrimet e saj znj. B. duke paraqitur disa dokumente shkresore ka informuar se depozitimi i shumës prej 21,493.55 euro në BKT, sipas praktikës së bankës, rezulton të jetë kryer në orën 09:44 të datës 3.12.2012, ndërkohë që bashkëshorti në orën 09.00-09.10 të kësaj date ka qenë në një gjyq në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më pas, në orën 10:30 ka qenë në një gjyq tjetër dhe në orën 13:00 deri në orën 13:25, ka qenë në një gjyq tjetër përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këto kushte, sipas saj, bashkëshorti e ka pasur të pamundur të ishte njëkohësisht edhe në Shkodër ku ka kryer me intensitet punën e tij, edhe në Tiranë që të kryente veprime në BKT. Kjo provë e re sipas saj, në unitet edhe me të gjitha provat e tjera të administruara gjatë hetimit provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm se bashkëshorti nuk e ka kryer këtë depozitim. Gjithashtu, bashkëshortja e subjektit solli në vëmendje se ka paraqitur edhe një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre” ku është kërkuar sekuestrimi i dokumenteve origjinale që kanë të bëjnë me veprimin bankar të datës 3.12.2012 dhe kryerja e ekspertimit grafik të dokumenteve origjinale. Më tej, ajo ka sqaruar se shuma prej 104.000 euro e depozituar *cash* nga bashkëshorti përputhet plotësisht me shumatoren aritmetike të 10 depozitimeve në bankë (përfshirë edhe depozitimën e shumës 21.493,55 euro) dhe përbën vlerën e plotë të çmimit të paguar sipas kontratës.

²³Shihni kërkesë e subjektit dërguar me *email* të datës 21.12.2022 znj. A. P.; kopje e njehsuar me origjinalin e praktikës kontratë porosie nr. *** prot., datë 2.4.2011, të lidhur mes shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit B. R.; kopje e njehsuar me origjinalin e praktikës kontratë sipërmarrjeje nr. *** prot., datë 29.10.2010, të lidhur mes shoqërisë “***” sh.p.k. dhe shtetasit B. L.

²⁴Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 20.9.2021, në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B. dhe dokumentet bashkëngjitur: dokumentacionin e plotë të blerjes së apartamentit nga shoqëria “***” sh.p.k., ku përfshihet edhe kartela e klientit sipas kontabilitetit të shoqërisë me arkëtimet e kryera nga z. Bahiti dhe pagesat e depozituara në llogarinë bankare të shoqërisë për këtë klient; shkresë kthim përgjigjeje datë 1.10.2021, e shoqërisë “***” sh.p.k.; vërtetim për aktin e realizuar nga zyra noteriale e noteres L. P.; vërtetim nga ISSH-ja lidhur me pagesat e kontributeve të znj. J. N. mbi bazën e pagës që ajo ka marrë si e punësuar pranë subjektit “***” sh.p.k.; shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2021, e “Credins Bank”, lidhur me veprimet bankare në llogaritë e shoqërisë “***” sh.p.k.; shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021, e BKT-së lidhur me veprimin e kryer në datën 3.12.2012 në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k.; aktekspertimi grafik, përgatitur nga eksperti kriminalist V. H.

39. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkua të japë sqarime mbi ecurinë kallëzimit penal për veprën penale “falsifikim të dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre” dhe fazën aktuale të tij duke paraqitur dokumente zyrtare. Në parashtrimet e tij subjekti ka paraqitur kopje të akteve të marra nga fashikulli i procedimit penal nr. ***, viti 2022, duke informuar bazuar në akte shkresore se janë kryer disa veprime hetimore, të cilat i ka përshkruar në mënyrë të hollësishme.

40. Në analizë të provave të paraqitura në parashtrime vërehet se: (i) mbi bazën e kallëzimit të bashkëshortes së subjektivit E. B., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar në datën 4.5.2022 procedimin penal për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe “falsifikim të dokumentit”; (ii) në datën 1.12.2022 është regjistruar emri i personit nën hetim për shtetasen E. H.; (iii) me vendime të organit procedues, Prokurorisë së Rrethit Elbasan, përkatësisht të datave 15.6.2022 dhe 3.10.2022, është vendosur kryerja e ekspertimit të dokumenteve “depozitim *cash* jo titullarë” me datë 3.12.2012 në BKT dhe “mandatarkëtim” me datë 3.12.2012 në BKT, të cilat pretendohen të falsifikuara, duke caktuar si ekspert një nga ekspertët e IPSH-së Tiranë. Gjithashtu janë administruar dy aktekspertime grafike përkatësisht me nr. ***, datë 24.6.2022 dhe nr. ***, datë 19.10.2022, të kryera nga eksperti kriminalist i Institutit të Policisë Shkencore, V. I. Sipas këtyre akteve, nuk konstatohet që shkrimi apo nënshkrimi në dy dokumentet bankare për depozitimin e shumës 21.493,55 euro të jenë të subjektivit apo bashkëshortes së tij.

Hetime të tjera në lidhje me pasurinë apartament me çmim 104.000 euro

41. Me qëllim verifikimin e trajtimit në mënyrë preferenciale të subjektivit dhe heqjen e çdo dyshimi që ai mund të ketë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. një pasuri tjetër përveç apartamentit objekt verifikimi, u kryen verifikimet si vijojnë:

41.1. Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2011”, për zonën *** në qytetin e Tiranës, ku ndodhet apartamenti, çmimi në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2012, është 91.900 lekë/m². Kështu, sipas çmimit të referencës vlera e apartamentit me sip. 87.3 m² rezulton në shumën 91.900 lekë/m² x 87.3 m² = 8.022.870 lekë + sipërfaqe e përbashkët 11.9 m² x 91.900 = 1.093.610 lekë + veranda 73.5 m² x 45.950 lekë/m²²⁵ = 3.377.325, pra në total 12.493.805 lekë. Ndërkohë, çmimi i blerjes është 104.000 euro/14.301.040 lekë²⁶. Siç vërehet, subjekti e ka blerë pasurinë me një çmim rreth 13% më të lartë se ai i referencës, fakt që ka rezultuar edhe në raste të kontratave të ngjashme, trajtuar në vijim.

41.2. Pas kërkesës së Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k. paraqiti tetë kontrata porosie/sipërmarrje, të anonimizuara²⁷, përmbajtja e të cilave është përshkruar në mënyrë më të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Nga analiza e çmimit të këtyre kontratave që i përkasin vitit 2011, në raport me çmimin e kontratës së subjektivit (e vitit 2012), vërehet se çmimi për metër katror i paguar nga subjekti është 668 euro/m² ose më i lartë se njëra prej kontratave (për një apartament mbi atë të subjektivit, një kat më sipër) dhe rreth 10% më i ulët krahasuar me çmimin mesatar të shtatë kontratave të tjera. Sidoqoftë, Komisioni çmon se negociimi i çmimit me dhe nga çdo blerës varet nga disa faktorë siç është planimetria dhe pozicioni i apartamentit, koha e blerjes etj. Për rrjedhojë, bazuar në informacionet e kontratave të ngjashme, nuk mund të arrihet në konkluzionin se subjekti e ka blerë pasurinë në një vlerë ndjeshëm më të ulët nga blerësit e tjerë.

²⁵Veranda dhe sipërfaqet e përbashkëta janë përllogaritet me ½ e çmimit të apartamentit.

²⁶Kjo është vlera me të cilën subjekti e ka regjistruar shitjen në librat e shoqërisë “****” sh.p.k., duke përdorur kursin e këmbimit 1 euro = 137.51 lekë.

²⁷Shihni dokumentet e depozituara nga përfaqësuesja e shoqërisë “****” sh.p.k., në datën 7.7.2022, gjatë dhënies së dëshmisë, në dosjen e Komisionit.

41.3. Komisioni kreu verifikime në lidhje me konflikt të mundshëm interesi, me qëllim evidentimin e ndonjë favorizimi të bashkëshortëve Bahiti, duke kërkuar të dhëna nga Prokuroritë e Shkodrës, Kurbinit, Kavajës dhe Tiranës ku subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë ushtruar detyrën, për procedime penale në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj F. B. Nga përgjigjet²⁸ e këtyre prokurorive nuk rezultuan të dhëna për procedime penale. Ndërkohë Prokuroria e Rrethit Tiranë informoi se²⁹ në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 27.8.2014, të shtetasit F. B. ndaj shtetasve B. T. dhe F. T., prokurorja E. B. ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këta shtetas, pasi nuk plotësohen elementet e figurës së veprës penale dhe se mosmarrëveshja midis kallëzuesit dhe personave të kallëzuar ka natyrë juridiko - civile që zgjidhet nëpërmjet gjykatës. Nisur nga fakti se marrëdhënia kontraktore mes bashkëshortes së subjektit dhe shoqërisë “****” sh.p.k., është finalizuar në vitin 2012, ndërsa kallëzimi i shtetasit F. B. është bërë në vitin 2014, por edhe në faktin se në këtë procedim nuk duket të ketë ndonjë favorizim për shtetasin F. B. (përkundrazi, pasi çështja e nisur me kallëzim të tij është pushuar), është vlerësuar se hetimi i kësaj çështjeje nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nuk ka sjellë problematika në drejtim të konfliktit të interesit.

42. I pyetur nga Komisioni, mbi marrëveshje apo kontrata të tjera të lidhura mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe familjarëve të tij, subjekti deklaroi se nuk ka asnjë marrëveshje apo kontratë të lidhur mes familjarëve të tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Një fakt i tillë dëshmohet edhe nga informacioni i marrë pranë regjistrimit noterial, nga ku nuk rezultuan³⁰ akte apo veprime noteriale në emër të familjarëve të subjektit. Po kështu, noterja L. P. informoi³¹ se përveç kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 4.7.2012 dhe kontratës së shitjes nr. ***, datë 27.7.2012, të lidhura mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit Saimir Bahiti, as ai dhe as personat e tjerë të lidhur (prindër, vëllezër, motra të subjektit dhe bashkëshortes së tij) nuk kanë realizuar asnjë akt tjetër me shoqërinë “****” sh.p.k. pranë zyrës së saj.

Në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave për pagimin e çmimit 104.000 euro

43. Në deklaratën *Vetting*, por edhe në DVP/2012 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: tërheqjen e shumës 3.000.000 lekë nga depozita e tij në “Raiffeisen Bank” dhe huamarrje në shumat respektive prej 50.000 euro, 3.000.000 lekë dhe 1.200.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka analizuar secilin prej tyre, si vijon.

Analizë e burimit “depozitë bankare në ‘Raiffeisen Bank’, në vlerën 3.000.000 lekë, me të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes”

44. U verifikua historiku i krijimit të kësaj depozite dhe nga lëvizjet e llogarive bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank”³², rezultoi se:

- Në datën 22.2.2005 subjekti ka depozituar *cash* shumën 350.000 lekë duke e investuar atë në depozitë me afat 1-vjeçar, të cilën e ka tërhequr me maturimin e saj në datën 23.3.2006. Në datën 18.4.2006 (pra, pas 3 javësh nga tërheqja e shumës 350.000 lekë) subjekti ka depozituar shumën 400.000 lekë, të cilën e ka investuar në depozitë me afat me maturim 3-mujor dhe në datën 18.7.2006 e ka tërhequr atë. Nga tërheqja e shumës së mësipërme, në datën 26.7.2006,

²⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbinit; dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

²⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.9.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

³⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2022, nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

³¹Shihni komunikimin elektronik të datës 23.11.2022, të noterës L. P., në dosjen e Komisionit.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2020, e “Raiffeisen Bank” në dosjen e bashkëshortes së subjektit E. B.

subjekti ka depozituar 300.000 lekë, të cilën e ka investuar në depozitë me afat. Nga ky moment e deri në korrik të vitit 2012, subjekti ka depozituar shuma të ndryshme në mënyrë periodike.

- Të gjitha depozitat së bashku me interesat e përfituara janë maturuar dhe në datën 3.7.2012 kanë arritur në vlerën 3.014.483, 65 lekë.

- Në datën 4.7.2012 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën 3.000.000 lekë.

45. Nga deklaratimet e bashkëshortes së subjektit konstatohet se: (i) Në DPDFD të dorëzuar në nëntor të vitit 2006, ajo ka deklaruar depozitë të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank” në shumën 300.000 lekë; (ii) Në DPV/2006 në rubrikën “Të dhëna që nuk publikohen” subjekti E. B. ka deklaruar shtesën e kësaj depozite nga deklarimi i mëparshëm në shumën 252.097 lekë.

46. Nga deklaratimet e subjektit konstatohet se në DPDFD/2007, subjekti ka deklaruar një depozitë në të holla në “Raiffeisen Bank” në vlerën 700.000 lekë, me pjesë takuese 700.000 lekë. Në DPV/2008 është deklaruar shtesë e kësaj depozite me 500 000 lekë. Në DPV/2009 është deklaruar Llogaria bankare në “Raiffeisen Bank”, vlera 469.400 lekë, pa përcaktuar nëse është gjendje apo shtesë. Në DPV/2010 është deklaruar shtesë e kësaj depozitë në shumën 567.123 lekë. Në DPV/2011 është deklaruar shtesë e kësaj depozite në shumën 350.000 lekë. Në DPV/2012 është deklaruar tërheqja e depozitës bankare në Raiffeisen Bank, datë 4.7.2012, në vlerën 3.000.000 lekë.

47. Për të verifikuar mundësinë e subjektit për krijimin e shumave të depozituara, është kryer analiza financiare e cila fillon në vitin 2003, kur subjekti dhe bashkëshortja e tij janë martuar³³ dhe kanë filluar të krijojnë *kursimet familjare*, deri në datën 22.02.2012 kur është depozituar në *cash* shuma e fundit prej 300.000 lekësh. Kjo analizë financiare përfshin periudhën para dhe pas detyrës, sikurse vjen origjina e depozitës, dhe sipas përlogaritjeve si në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumat e depozituara ndër vite deri në korrik 2012.

| PËRSHKRIMI | 2003-2005 ³⁴ | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 22.2.2012 |
|--|-------------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Pasuria | 428 455 | 74 870 | 309 500 | 401 987 | 480 317 | 675 796 | 462 227 | 211 198 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | 428 455 | 74 870 | 309 500 | 401 987 | 480 317 | 675 796 | 462 227 | 211 198 |
| Likuiditete gjendje | 428 455 | 503 325 | 812 825 | 1 214 | 1 695 | 2 370 | 2 833 | 3 044 |
| Të ardhura | 1 591 323 | 1 039 | 1 321 | 1 681 | 1 716 | 1 873 | 2 106 | 366 980 |
| Të subjektit | 116 325 | 476 280 | 485 276 | 941 490 | 848 610 | 1 076 | 1 166 | 180 599 |
| Bashkëshortja në Greqi 01/2003-04/2004 | 1 358 673 | 556 771 | 836 208 | 711 823 | 832 999 | 746 721 | 887 816 | 157 523 |
| Bashkëshortja nga Shkolla e Magjistraturës | 116 325 | | | | | | | |
| Nga interesa bankare | | 6 679 | | 28 633 | 34 563 | 49 526 | 51 776 | 28 858 |
| Shpenzime | 1 106 418 | 591 426 | 564 695 | 752 684 | 1 026 | 923 263 | 907 777 | 122 789 |
| Shpenzime jetese familjare në Shqipëri ³⁵ | 467 101 | 219 114 | 273 240 | 341 550 | 409 860 | 409 860 | 409 860 | 60 789 |
| Shpenzime jetese të bashkëshortes në Greqi ³⁶ | 459 908 | | | | | | | |
| TIMS | 29 410 | 132 312 | 33 855 | 39 134 | 213 985 | 93 003 | 136 917 | |

³³Data e martesës 18.3.2003.

³⁴Meqenëse kjo depozitë është krijuar në datën 22.2.2005, është kryer analiza financiare për periudhën 2003 – 22.2.2005, në mënyrë kumulative, sipas së cilës ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur një mungesë fondesh në masën -34.015 lekë, e cila është një balancë jo vetëm e pakonsiderueshme, por edhe që i takon një periudhe para detyrës e të dy bashkëshortëve.

³⁵Përbërja familjare e subjektit për këtë periudhë është: subjekti nga 2003 - 2005; bashkëshortja e tij nga maji i vitit 2004 e në vijim; 3 persona nga data 20.6.2008 kur lind djali.

³⁶Meqenëse bashkëshortja ka paraqitur të ardhura të dokumentuara nga Greqia për periudhën janar 2003 deri në fund prill 2004, të cilat janë përfshirë në këtë analizë financiare, edhe shpenzimet e jetesës janë përlogaritur për të njëjtën periudhë bazuar në të dhënat e Institutit të Statistika të Greqisë <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

| | | | | | | | | |
|--|---------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|---------------|
| Shpenzime për qira 2006 – 2012 | 150 000 | 240 000 | 240 000 | 240 000 | 240 000 | 240 000 | 240 000 | 40 000 |
| Udhëtim për në vendin e punës subjekti | | | 17 600 | 99 000 | 110 000 | 121 000 | 121 000 | 22 000 |
| Udhëtim për në vendin e punës BSH | | | | 33 000 | 52 800 | 59 400 | | 0 |
| Mundësia për kursime | 56 450 | 373 435 | 447 289 | 527 275 | 209 210 | 274 092 | 736 212 | 32 993 |

Analize e burimit “hua e marrë nga shtetasi P. G., në vlerën 50 000 euro”

48. Në lidhje me marrëdhënien e huas mes subjektit dhe shtetasit P. G. nga verifikimi i dokumentacionit të administruar³⁷ rezultoi se:

- sipas kontratës së huas nr. ***, datë 4.7.2012, z. Saimir Bahiti në cilësinë e huamarrësit, ka marrë një hua pa interes në shumën 50.000 euro (jashtë zyrës noteriale) nga huadhënësi P. G., për arsye të blerjes së apartamentit të banimit nga ana e huamarrësit, për një afat deri në marrjen e një kredie, apo dhe për një afat tjetër 10 vjet;
- në DPV-të 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 është deklaruar huaja e marrë me të njëjtat kushte, me gjendje detyrimi e mbetur në shumën 30.000 euro;
- në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar huan, nga e cila janë shlyer 20.000 euro me burim kredi bankare me vlerë 20.000 euro. Mbetur pa u shlyer nga huaja 30.000 euro.

49. Në lidhje me mënyrën e marrjes së shumës prej 50.000 euro, ka rezultuar se kjo shumë është dhënë jashtë sistemit bankar *cash*, konfirmuar me deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, si dhe me deklaratimet e bashkëshortes gjatë hetimit administrativ,³⁸ sipas të cilave huaja është marrë *cash* nga bashkëshorti i saj, për shkak se huadhënësi e dispononte këtë shumë *cash* dhe edhe për shkak të marrëdhënies së miqësisë midis tyre.

50. Nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se: (i) sipas aktit bankar të “Alpha Bank”, shtetasi P. G. ka tërhequr nga llogaria “***” sh.a. shumën 5.300.000 lekë në datën 11.5.2012. Ndërsa në datën 5.4.2012 ka tërhequr shumën 4.000.000 lekë; (ii) huaja është dhënë në datën 4.7.2012 sipas kontratës me këtë datë dhe nga të dhënat e administruara nga DPPPP-ja³⁹ rezulton se ka pasur një raportim për transaksion nga noteri të datës 16.8.2012, sipas të cilit huadhënësi P. G. ka dhënë hua në shumën 50.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti.

51. Në lidhje me burimin e ligjshëm të huadhënësit për dhënien e huas prej 50.000 euro, në shpjegimet e tij në ILDKPKI⁴⁰, në lidhje me këtë huamarrje subjekti ka deklaruar: “P. G. është një miku im nga Shkodra. Mundësitë e tij financiare janë nga kompania ‘***’ sh.a. (ose e njohur ndryshe ***)”. Ndërsa i pyetur po nga ILDKPKI-ja⁴¹ në lidhje me këtë huadhënie, si dhe në lidhje me bilancin e shoqërisë dhe shumës së dividendit të tërhequr prej tij ndër vite, vetë huadhënësi P. G. ka deklaruar: “Marrëdhënia me z. Bahiti është një marrëdhënie shoqërore e miqësie prej shumë vitesh. Sa i përket mundësive të mia financiare lidhur me këtë huadhënie, sqaroj se kjo vlerë nuk është tërhequr nga llogaritë e shoqërisë ‘***’ sh.a., pasi në këtë shoqëri nuk kam tërhequr dividend me qëllim rritjen e kapitalit të shoqërisë. Këtë vlerë të hollash e kam fituar gjatë viteve pasi ushtror prej vitit 1993 aktivitetin e shitblerjes së hidrokarbureve, të vërtetueshme nëpërmjet deklaratimeve mujore e vjetore, si dhe shitblerjes së pronave personale të luajtshme e të paluajtshme, të regjistruara në emrin tim personal”.

³⁷Shihni aktet në aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

³⁸Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

³⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.1.2020, nga DPPPP-ja dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

⁴⁰Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.4.2020, nga ILDKPKI-ja në dosjen e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

⁴¹Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka bashkëlidhur shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 30.6.2017, drejtuar z. G. dhe kthim përgjigjen e tij datë 4.7.2017.

52. Siç vërehet deklarimi i subjektit pranë ILDKPKI-së lidhur me burimin e fondeve të huadhënësit, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas, nuk përputhet me deklaratimet e z. P. G. pranë këtij institucioni. E pyetur mbi këtë mospërputhje, bashkëshortja e subjektit ka sqaruar se kur janë dhënë shpjegimet në ILDKPKI kanë menduar se shuma e dhënë hua, vjen nga të ardhurat që ai ka krijuar nga aktiviteti tregtar i shoqërisë “****” sh.p.k. Por burimi i saktë i shumës së marrë hua është ai i deklaruar nga shtetasi P. G.

53. Komisioni ka verifikuar aftësinë financiare të z. P. G. për dhënien e huas, bazuar në dokumentet shkresore të administruara si gjatë procesit të znj. B. ashtu edhe gjatë procesit të subjektit Bahiti, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

54. Në përfundim të hetimit administrativ, është kryer analiza financiare duke përdorur metodologjinë kumulative, për shkak se huadhënësi nuk është subjekt deklarues. Periudha e analizuar është tetor 2007, kur subjekti ka paraqitur dokumente për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huas, deri në datën e dhënies së saj 4.7.2012. Sipas kësaj analize, treguar në tabelën më poshtë, rezultoi se huadhënësi P. G. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 50.000 euro.

| Përshkrimi | <i>Periudha</i> 5.10.2007 - 4.7.2012 |
|---|--|
| Pasuri | 215 864 |
| Ndryshim likuiditeti (Shtesa/Pakësime) | 215 864 |
| Të ardhura | 230 561 206 |
| Të ardhura nga paga sipas llogarisë së “Alpha Bank” | 2 555 173 |
| Të ardhura nga shitja e pasurisë pyll | 228 006 033 |
| Shpenzime | 131 764 357 |
| Shpenzime jetese për 1 person | 752 874 |
| Shpenzime për ndërtim Pike Karburanti në Shkodër 2007 | 2 817 283 |
| Kapitali i shoqërisë ***/*** themeluar më 6/2007 | 2 500 000 |
| Paguar tatimi për kalimin e pronësisë | 4 784 200 |
| Hua dhënë R. T. | 120 910 000 |
| Mundësia për kursime | 98 580 984 |

Në këtë analizë janë përfshirë:

- Të ardhurat e z. P. G. nga shitja e pasurisë “pyll” me sip. 44,000 m² në vlerën 1.900.000 euro, e kredituar në llogarinë e tij në “Tirana Bank” në datën 4.10.2007, për të cilën është paguar tatimi në burim.

- Të ardhurat nga paga, për periudhën gusht 2010 deri qershor 2012, sikurse janë evidentuar nga lëvizja e llogarisë së pagës së z. G. në “Alpha Bank”.

Janë përfshirë tek shpenzimet:

- vlera e investuar për ndërtimin e objektit “Pikë karburanti dhe ambiente shërbimi”, në vlerën 12.677.755 lekë⁴². Periudha e ndërtimit është 9 muaj, ndërkohë që në analizë janë konsideruar shpenzimet e dy muajve të fundit, nëntor-dhjetor 2007, në vlerën 2.817.283 lekë⁴³;

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2021 kthim përgjigje nga ASHK-ja Shkodër, e cila përmban dosjen e plotë për pikën e karburantit të z. P. G.; faqe 19 ndodhet shkresa “Certifikatë e marrjes në dorëzim të punimeve për pikë karburanti dhe ambiente shërbimi”, në të cilën është pasqyruar vlera e investimit dhe koha e punimeve nga 15.3.2007 deri më 20.12.2007.

⁴³Në mungesë të një informacioni mbi këtë investim, është konsideruar që ai është kryer në mënyrë të njëtrajtshme dhe çdo ditë është shpenzuar një sasi e barabartë parash.

- vlera e paguar për tatimin mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë “pyll” me sip. 44.000 m², në vlerën 4.784.200 lekë, sipas dy mandatarëtimeve datë 5.10.2007;

- vlera 2.500.000 lekë e investuar në kapitalin e shoqërisë “****” sh.p.k. nga aksionari i vetëm P. G., shoqëri e themeluar në datën 15.6.2007⁴⁴;

- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për një person;

- huaja dhënë në favor të z. R. T. në shumën 1.000.000 euro, në tetor 2007 sikurse evidentuar në llogarinë e z. P. G. në “Tirana Bank”.

Nuk janë përfshirë në analizën financiare investimet e kryera nga z. P. G. përpara datës 5.10.2007.

55. Në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje, rezultoi se:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se ka marrë kredi bankare pranë “Raiffeisen Bank” me vlerë 20.000 euro, për të shlyer një pjesë të detyrimit ndaj shtetasit P. G. Mbetur pa u shlyer nga kredia vlera 17.515,57 euro. Marrja e kësaj kredie, shuma e shlyer dhe detyrimi i mbetur është deklaruar nga subjekti në DPV 2012 – 2016. I pyetur më tej gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi se⁴⁵ huaja e marrë këtij shtetasi është shlyer si vijon: (a) menjëherë me disbursimin e kredisë nga “Raiffeisen Bank”, me vlerë 20.000 euro, kjo shumë ka kaluar në llogarinë e z. P. G.; (b) në datën 27.12.2019 është shlyer kësti prej 17.000 euro duke u kredituar në llogarinë e tij në OTP Bank; (c) në datën 28.5.2021 është shlyer kësti i fundit në shumën 13.000 euro, kredituar në llogarinë e z. P. G. pranë OTP Bank. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti ka paraqitur dokumente mbi veprimet bankare. Pra, siç vërehet shlyerja e huas ndaj shtetasit P. G. është kryer me tre këste dhe ka përfunduar në datën 28.5.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratën e huas.

- Nga dokumentet e administruara pranë ILDKPKI-së⁴⁶ rezultoi se sipas kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës nr. ***, datë 19.10.2012, shtetasit Saimir Bahiti dhe E. B. kanë marrë në “Raiffeisen Bank”, një kredi në vlerën 20.000 euro me afat 240 muaj me qëllim financimi “blerje shtëpie”. Sipas nenit 1 të kësaj kontrate një pjesë e fondeve do të transferohen në llogari të shoqërisë “****” sh.a. për pagesën e primit të sigurimit⁴⁷, ndërsa pjesa tjetër e tyre do të transferohen në llogari të huadhënësit P. G. sipas deklaratës së huas nr. ***, datë 4.7.2012. Si garanci⁴⁸ për këtë kredi është vendosur apartamenti i blerë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij me nr. pasurie ***.

- Nga nxjerrja e llogarisë në euro, të subjektit në “Raiffeisen Bank”, evidentohet se në datën 2.11.2012 është disbursuar kredia në shumën 20.000 euro. Këtë shumë bashkëshorti i subjektit, në datën 5.11.2012 e ka transferuar në llogarinë e z. P. G. me përshkrimin “*Kthim borxhi sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.7.2012*”. Kështu që, shlyerja e një pjesë të huas në tetor të vitit 2012, është kryer nëpërmjet kredisë bankare, pra me të ardhura të ligjshme.

56. Në lidhje me gjendje të mundshme të konfliktit të interesit të subjektit apo bashkëshortes së tij me huadhënësin P. G., bashkëshorten e tij D. G., dhe shoqërinë “****” sh.p.k. (“****”), me NUIS ***, sipas informacionit të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴⁹ rezultoi se nuk është regjistruar kallëzim apo procedim penal në emër/në ngarkim të shtetasës D./D. G. Ndërkohë, për shtetasin P. G. dhe subjektin “****”, rezulton të jenë regjistruar

⁴⁴Shihni ekstraktin historik të QKB-së, kapitullin “Historiku i regjistrimit” sipas së cilën evidentohet data e regjistrimit 28.6.2007 dhe kapitali është 2.500.000 lekë.

⁴⁵Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 13.6.2022, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶Shihni dokumentet në aneksin 4/8 dhe 7 në dosjen e ILDKPKI-së të subjektit Saimir Bahiti.

⁴⁷Sipas policës së sigurimit të jetës nga shoqëria “Sigal” sh.a., vlera e primit të sigurimit rezulton të jetë 57.14 euro.

⁴⁸Vërtetim nga regjistri i inskriptimeve datë 24.10.2012.

⁴⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dokumentacioni bashkëngjitur, në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.; shihni shkresën kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 30.9.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit.

procedimi penal nr. ***, viti 2015, i pushuar me datë 12.11.2019 dhe procedimi penal nr. ***, viti 2019, i cili është pushuar në datën 12 .11.2019, dhe nga verifikimi i akteve, rezultoi se: (i) sa i takon procedimit penal nr. ***, viti 2015, pushuar me datë 12.11.2019, që lidhet me subjektin juridik “****” sh.a., me administrator shtetasin P. G., subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga rasti për shkak të njohjes me shtetasin P. G., duke u trajtuar në vijim nga një tjetër prokuror; (ii) sa i takon procedimit penal nr. ***, viti 2019, që lidhet po me shoqërinë “****”, me ortak të vetëm P. G., nga verifikimi i akteve nuk rezultoi që ky procedim penal të ishte trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

57. Komisioni ka kryer verifikime në lidhje me pretendimin e ngritur në denoncimin e shoqatës Antikorrupsion për konflikt interesi të subjektit me shtetasin P. G. administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., gjatë trajtimit të procedimit penal nr. *** (trajtuar në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale, paragrafi 127 i vendimit).

Analizë e burimit “hua e marrë nga shtetasi I. H., në vlerën 3.000.000 lekë”

58. Në lidhje me marrëdhënien e huas, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë hua⁵⁰, rezultoi se:

- nëpërmjet deklaratës “për dhënie huaje”, me shkrim dore, të datës 1.7.2012, shtetasi I. Q. H. deklaroi me vullnetin e tij të lirë se i ka dhënë shtetasit Saimir Bahiti një hua pa interes, në shumën 3.000.000 lekë të reja, për ta ndihmuar për blerjen e një shtëpie banimi, me një afat shlyerje prej 15 vitesh, sipas mundësisë së tij me këste ose të gjithë shumën;
- me deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.10.2012, z. Saimir Bahiti ka deklaruar se në datën 1.7.2012 ka marrë shumën 3.000.000 lekësh jashtë zyrës noteriale nga shtetasi I. H., të cilën do t’ia kthejë me këste pas 15 vjetësh deri në datën 1.7.2027;
- në DPV-të 2012 – 2016 subjekti ka deklaruar huan e marrë, shumën e shlyer dhe detyrimin e mbetur;
- në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar huan dhe shlyerjen e saj pa interesa me burim të ardhurat nga pagat, si dhe vlera prej 10.000 euro dhuruar nga vjehrra N. B.

59. Në lidhje me mënyrën e marrjes së huas në shumën 3.000.000 lekë, gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së⁵¹ subjekti ka deklaruar se ky transaksion është bërë *cash*, fakt i konfirmuar edhe nga bashkëshortja e subjektit gjatë hetimit të saj administrativ⁵² sipas deklarimeve të së cilës, kjo ka qenë për shkak se huadhënësi e dispononte këtë shumë *cash* dhe për shkak të marrëdhënies së miqësisë mes tyre.

60. Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit për dhënien e huas prej 3.000.000 lekë, në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2016, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar se kjo shumë ka ardhur nga ushtrimi i aktivitetit privat të shoqërisë “****” sh.p.k. Gjatë hetimit administrativ janë administruar disa dokumente⁵³ mbi të ardhurat e huadhënësit I. H., pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ.

61. Nga analiza e dokumenteve shkresore rezultoi se: (i) është provuar të ketë pasur një marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë “****” sh.p.k., sipas së cilës z. I. H. ka punuar me NIPT sekondar nga shtatori 2010 deri në qershor 2013; (ii) z. I. H. ka tërhequr me çek nga llogaria bankare e shoqërisë “****” sh.p.k. pranë “Tirana Bank”, shumën totale në vlerën 6.539.000 lekë, për periudhën 2010 – 2012; (iii) është provuar që shoqëria “****” sh.p.k. ka

⁵⁰Shihni aktet në aneksin 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵¹Shihni procesverbalin e pyetjes pranë ILDKPKI-së të datës 25.3.2016, në dosjen e subjektit.

⁵²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

⁵³Shihni aktet në aneksin 35, 36 dhe 37 në dosjen e ILDKPKI të subjektit Saimir Bahiti; dokumentacionin bashkëngjitur pyetësorëve standardë, si dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të subjektit të rivlerësimit E. B. në dosjen e saj.

paguar të gjitha detyrimet tatimore për vitin 2012⁵⁴. Në këto kushte, të ardhurat e përfituara nga z. Hoxha përmes tërheqjeve të kryera me çek nga llogaria e shoqërisë “***” sh.p.k., janë konsideruar të ligjshme për sa kohë detyrimet tatimore janë paguar nga kjo shoqëri.

62. Në përfundim të hetimit administrativ, është kryer analiza financiare mbi mundësinë e z. I. H. për të dhënë hua në shumën 3.000.000 lekë në datën 1.7.2012, duke përdorur metodologjinë kumulative për shkak se huadhënësi nuk është subjekt deklarues. Periudha e analizuar është nga viti 2010 deri në datën e dhënies së huas. Sipas kësaj analize, treguar në tabelën më poshtë, rezultoi se huadhënësi I. H. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 lekë.

| Përshkrimi | Periudha 2010 – 1.7.2012 |
|--|--------------------------|
| Pasuri | 14 582 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | 14 582 |
| Të ardhura | 9 117 133 |
| Paga I. H. *** sh.p.k. | 414 020 |
| Paga D. H. | 937 478 |
| Paga A. H. | 1 226 635 |
| Tërheqje me <i>check payment</i> nga llogaria e ***-së | 6 539 000 |
| Shpenzime | 4 249 704 |
| Shpenzime jetese për 3 persona | 1 029 042 |
| Dërgesa me Money Gram | 220 662 |
| Dhënë hua tek subjekti | 3 000 000 |
| Mundësi për kursime | 4 857 377 |

Në këtë analizë janë përfshirë: të ardhura nga punësimi i z. I. H.⁵⁵, nga punësimi i bashkëshortes dhe djalit të tij⁵⁶; të ardhurat e përfituara sipas tërheqjeve me çeqe bankare nga llogaria e shoqërisë *** sh.p.k.; shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së për 3 persona⁵⁷; janë përfshirë si shpenzim 2 dërgesa të z. I. H. nëpërmjet shërbimit të transfertës së parave MoneyGram⁵⁸.

63. Në lidhje me shlyerjen e huas, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se subjekti ka deklaruar: (i) në DPV 2013 shlyerjen e shumës prej 1 500 000 lekë dhe detyrimin e mbetur prej 1 500 000 lekë; (ii) në DPV 2014 shlyerjen e shumës prej 600 000 lekë dhe shumën e mbetur prej 900 000 lekë; (iii) në DPV 2015 ka deklaruar shlyerjen e shumës prej 500 000 lekësh dhe detyrimin e mbetur prej 400 000 lekë; (iv) në DPV 2016 ka deklaruar shlyerjen totale të huas, duke deklaruar shlyerjen e shumës së mbetur në shumën 400 000 lekë; (v) në deklaratën *Vetting* është deklaruar shlyerja totale e huas. Këto deklarime vërtetohen me tri deklaratat me shkrim dore të shtetasit I. H., përkatësisht me data 22.3.2013, 20.12.2014, 20.12.2015, si dhe me deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.12.2016, ku deklaruesit I. H. dhe Saimir Bahiti deklarojnë se janë likuiduar plotësisht në lidhje me huan, duke konfirmuar edhe pagimin e këstit të fundit të huas në datën 3.11.2016 të shumës 400 000 lekë, nëpërmjet llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit, znj. E. B., në llogarinë e shtetasit I. H. në Tirana Bank.

⁵⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2021, të DRT-së Tiranë, paraqitur nga bashkëshortja e subjektit me pyetësorin e datës 20.9.2021.

⁵⁵Në vërtetimet e ISSH-së janë pasqyruar pagat *bruto*, ndërsa paga *neto* është përlllogaritur sipas legjislacionit tatimor të publikuar nga Ministria e Financave për vitet përkatëse.

⁵⁶Shihni dokumentet në faqet 507-510, bashkëlidhur pyetësorit standard të subjektit.

⁵⁷Bazuar në të ardhurat e paraqitura, përbërja familjare e z. I. H. është: ai, bashkëshortja dhe djali i tyre.

⁵⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nga AK Invest, nr. *** prot., datë 16.6.2021, administruar në dosjen e bashkëshortes E. F.

64. Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e huas, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi: (i) të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes; (ii) vlera prej 10.000 euro dhuruar nga vjehrra N. B., analizuar si vijon:

64.1. Sa i takon të ardhurave nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, këto të ardhura janë pjesë e analizës financiare për të gjitha vitet e periudhës së analizuar. Sa i takon dhuratës prej 10.000 euro nga vjehrra N. B., u vërtetua se me deklaratën noteriale me nr. ***, datë 6.9.2012⁵⁹, deklaruesja N. B. (nëna e bashkëshortes) deklaroi se i dhuron vajzës së saj E. B. shumën prej 10 000 euro, si dhuratë për shtëpinë e saj të re, dhuratë e cila pranohet nga vajza e saj pa u shprehur mbi mënyrën e kalimit të kësaj shume. Në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së⁶⁰, në vitin 2016 zonja B. ka deklaruar se: “*Ky transaksion është kryer cash kur na ka lindur djali... nëna e ka dërguar shumën në dy pjesë, shuma 5,000 euro nëpërmjet motrës sime A. B. e cila ka ardhur nga Greqia dhe pjesa tjetër është sjellë nga nëna ime, e cila bëri edhe kontratën e dhurimit*”. Për të vërtetuar hyrjen e shtetas A. B. në shtetin shqiptar, ajo ka paraqitur kopje të fletës së printuar nga sistemi TIMS lidhur me hyrjet dhe daljet në/nga territori shqiptar për këtë shtetase, sipas së cilës rezultoi se A. B. ka hyrë në Shqipëri në datën 3.8.2012.

64.2. Ky dhurim është deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në për vitin 2012. Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të saj gjatë hetimit administrativ⁶¹, bashkëshortja e subjektit ka paraqitur dokumentacion mbi të ardhurat në shtetin grek të shtetasve Th. dhe N. B., si: (i) dokumente identifikimi të shtetit grek për këta shtetas; (ii) deklaratat vjetore të të ardhurave personale (DVAP)⁶² të depozituara në Zyrën e Tatimeve të Greqisë për vitet 2002 - 2012. Në këto deklarata janë pasqyruar të ardhurat për familjen B., numri i anëtarëve të familjes⁶³, si dhe shpenzimet e qirasë së paguar prej tyre.

64.3. Bazuar në dokumentacionin e administruar si më sipër, është kryer analiza financiare mbi mundësinë e dhurimit të shumës 10.000 euro nga nëna e subjektit, z. N. B., në datën 6.9.2012, duke përdorur metodologjinë kumulative, për shkak se prindërit e bashkëshortes nuk janë subjekte deklaruese. Periudha e analizuar është viti 2002, pasi në këtë vit subjekti ka paraqitur të ardhura për të vërtetuar burimin për krijimin e shumës së dhuruar, deri në datën e dhurimit/hartimit e deklaratës noteriale nga N. B. Sipas kësaj analize, treguar në tabelën më poshtë, rezultoi se prindërit e bashkëshortes kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhurimin e shumës 10.000 euro.

| Përshkrimi në euro | <i>Periudha 2002 – 6.9.2012</i> |
|--------------------------------|--|
| Të ardhura | 190 263 |
| Të ardhurat e babait | 84 079 |
| Të ardhurat e nënës | 104 395 |
| Kthim i tatimeve | 1 788 |
| Shpenzime | 162 473 |
| Shpenzime jetike për 4 persona | 132 530 |
| Qira banese | 32 944 |
| Mundësia për kursime | € 27 789 |

Analiza është mbajtur në euro, pasi çdo element i saj është në këtë monedhë. Në të janë përfshirë të gjitha të ardhurat e dokumentuara të prindërve të bashkëshortes në Greqi;

⁵⁹Shihni aktin në aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁰Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 27.4.2020, nga ILDKPKI-ja në dosjen e subjektit Saimir Bahiti.

⁶¹Shihni përgjigjet e pyetësorit standard.

⁶²DVAP është analoge me deklaratën “DIVA”; ajo është detyrim të dorëzohet në Zyrën e Tatimeve DOY për çdo shtetas dhe rezident në shtetin grek, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe përfiton çdo lloj të ardhure në këtë shtet (<http://www.odigostoupoliti.eu/forologiki-dilosi/>)

⁶³Sipas këtyre deklaratave, në përbërjen familjare janë zotërinjtë Th. dhe N. B., si dhe 2 fëmijë.

shpenzimet e jetesës për 4 persona, sikurse është evidentuar në deklaratën e taksave në Greqi, duke përdorur minimumin jetik sipas Zyrës së Statistikave të Greqisë për vitet e analizuar⁶⁴.

65. Në lidhje me mundësinë financiare për shlyerjen e huas në vlerën 3 000 000 lekë shtetasit I. H., u konstatua se:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se vlera prej 10 000 euro e dhuruar nga vjehrra N. B. ka shërbyer për shlyerjen e një pjese të huas ndaj shtetasit I. H.

- Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit dhe bashkëshortes së tij lidhur me shumën e dhuruar rezultoi se: (i) në DPV 2012, në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale, dhurata dhe trajtime preferenciale*”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar dhurimin e shumës 10,000 euro nga nëna e bashkëshortes përmes deklaratës noteriale të datës 6.9.2012, nr.***. Ndërsa në rubrikën “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*”, subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash* në fund të vitit; (ii) në DPV 2013, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash* në rubrikën “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*”, por ka deklaruar shlyerjen e shumës 1.500.000 lekë në favor të huadhënësit I. H. pa specifikuar burim; (iii) në sqarimet e dhëna pranë ILDKPKI-së⁶⁵, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar se si burim për shlyerjen e huas prej 1.500.000 lekë kanë qenë dhurimi i shumës 10.000 euro nga vjehrra dhe të ardhurat nga pagat.

Siç vërehet, nuk rezulton që shuma 10.000 euro të jetë deklaruar si shtesë dhe më pas si pakësim në deklaratat periodike.

- E pyetur mbi këto fakte gjatë hetimit administrativ, bashkëshortja e subjektit sqaroi⁶⁶ se: “*Kjo shumë nuk është deklaruar si shtesë cash në DVP, pasi, duke qenë se e kemi deklaruar në rubrikën dhurata dhe trajtime preferenciale, në pakujdesi nuk e kemi deklaruar gjendje cash, duke menduar se rezultonte e deklaruar në rubrikën e dhuratave. Në vitin pasardhës, duke qenë se nuk e kishin deklaruar shtesë në cash, rrjedhimisht nuk mund ta deklaranim pakësim. Në DVP 2013 nuk kemi deklaruar se kjo shumë ka shërbyer si burim për shlyerjen pjesore të huas së z. I. H., pasi deklarata në formatin e saj nuk parashikon rubrikë për burimin e krijimit për shlyerjen e huas, por parashikon gjendjen e detyrimit të shlyer dhe gjendjen e detyrimit të mbetur pa shlyer*”.

- Më tej në parashtrimet e saj, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: “*Unë në momentin e plotësimit të deklaratës periodike të pasurisë të vitit 2012, të cilën e kam plotësuar në datën 28.3.2013, i kisha kthyer z. H. shumën prej 1.500.000 lekë në datën 22.3.2013. Në këto kushte, kam menduar që për sa kohë unë këtë shumë nuk e kisha në gjendje, nuk kisha arsye ta deklaroj. Për rrjedhojë të mosdeklarimit shtim në deklarimin e vitit 2012, nuk kam deklaruar as pakësimin në vitin 2013. Unë pranoj që nuk kam kryer deklarim të saktë në deklaratat periodike në lidhje me shumën 10.000 euro, pavarësisht se e kam deklaruar dhuratë nga mamaja, por këtë pasaktësi unë e kam rregulluar në vitin 2016, ku kam deklaruar se si burim për kthimin e huas z. I. H. ka shërbyer shuma prej 10.000 euro. Unë kam qenë e saktë në deklaratën *Vetting*, pasi kam deklaruar se shuma 10.000 euro ka shërbyer si burim për kthimin e pjesshëm të huas z. I. H., si dhe kam qenë e saktë dhe gjatë hetimit administrativ, ku i kam qëndruar deklarimeve të mia si në deklaratën *Vetting*. Në DVP-në e vitit 2012 kemi vlerësuar se deklarimi në rubrikën ‘*Dhurata dhe trajtime preferenciale*’ të kësaj shume të dhuruar, nënkuptonte njëkohësisht edhe deklarimin si *cash* të kësaj gjendjeje. Pranojmë këtë pakujdesi, por theksojmë se kjo shumë është ruajtur *cash* në fund të vitit. Znj. B. ka sjellë në vëmendje të Komisionit edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimet nr. 9/2020; vendimi 16/2020; vendimi 31/2020, në lidhje me peshën e pasaktësive në deklaratat periodike lidhur me mosdeklarimin e *cash*-it.*”

⁶⁴Sipas të dhënave të shërbimit statistikor grek <https://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>

⁶⁵Shihni procesverbalin e sqarimeve të datës 25.3.2016 pranë ILDKPKI-së në dosjen e subjektit E. B.

⁶⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

66. Në përfundim të hetimit administrativ për z. Bahiti, referuar deklarimeve të znj. B. në parashtrime si dhe deklarimeve në DPV 2012, vërehet se ajo dhe bashkëshorti i saj e kanë plotësuar këtë DPV përkatësisht në datë 28.3.2013 dhe 27.3.2013 dhe e kanë kthyer huan në datën 22.3.2013. Në këto kushte, duke mbajtur në konsideratë që shuma prej 10 000 euro është deklaruar në vazhdimësi si burim për shlyerjen e huas së z. I. H., si dhe ne kushtet kur u vërtetua burimi i ligjshëm i të ardhurave për krijimin e kësaj shume, vlera prej 10.000 euro është përfshirë si gjendje *cash* në analizën financiare të vitit 2012 dhe si burim për shlyerjen e pjeshme të huas në vitin 2013.

67. Nga analiza financiare mbi shlyerjen e huas ndaj shtetasit I. H. rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të shlyer këtë hua, sikurse treguar në tabelën më poshtë.

| Përshkrimi | 22.3.2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|-------------------|------------------|------------------|------------------|
| Pasuria | -1 378 624 | 183 995 | -13 992 | 86 431 |
| Automjeti tip "Peugeot 206" | | 170 000 | | |
| Ndryshim likuiditeti | -1 378 624 | 13 995 | -13 992 | 86 431 |
| Gjendja e likuiditeteve | 1 403 252 | 33 438 | 19 446 | 105 877 |
| Detyrime | -1 561 485 | -841 548 | -733 635 | -725 935 |
| Pagesë e huas nga I. H. | -1 500 000 | -600 000 | -500 000 | -400 000 |
| Pagesë e huas nga S. A. | | | | -100 000 |
| Pagesa të kredisë bankare | -61 485 | -241 548 | -233 635 | -225 935 |
| Pasuria neto | 182 862 | 1 025 544 | 719 643 | 812 366 |
| Të ardhura | 482 281 | 2 277 116 | 2 251 404 | 2 632 615 |
| Të ardhurat e subjektit E. B. | 194 085 | 1 154 393 | 1 171 446 | 1 529 674 |
| Të ardhurat e bashkëshortes B. | 288 197 | 1 122 723 | 1 079 958 | 1 102 941 |
| Shpenzime | 158 183 | 1 231 962 | 1 422 647 | 1 371 995 |
| Shpenzime jetike | 125 183 | 879 992 | 897 104 | 940 368 |
| TIMS | | 152 720 | 240 543 | 151 502 |
| Shpenzime udhëtimi për në vendin e punës subjekti | 33 000 | 121 000 | 121 000 | 121 000 |
| Shpenzime H. shkolla "***" | | 78 250 | 164 000 | 159 125 |
| Mundësia për kursime | 141 237 | 19 611 | 109 115 | 448 254 |

68. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni ka kryer verifikime mbi gjendje konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij me huadhënësin I. H., konkretisht u kërkuan të dhëna për procedime penale në emër të huadhënësit I. H. nga prokuroritë e Shkodrës, Kurbinit, Durrësit dhe Kavajës, ku subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë ushtruar detyrën, nga përgjigjet⁶⁷ e të cilave nuk rezultuan të dhëna për procedime penale.

Analiza e burimit të huas nga shtetasi S. A. në shumën 1.200.000 lekë

69. Në lidhje me marrëdhënien e huas mes subjektit dhe shtetasit S. A., nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë hua⁶⁸ rezultoi se:

- sipas deklaratës për dhënie borxhi, me shkrim dore, të datës 1.7.2012, shtetasi S. A. deklaroi se në datën 1.7.2012 i ka dhënë shtetasit Saimir Bahiti hua në shumën prej 1.200.000 lekësh të rinj për ta ndihmuar që të blejë shtëpi banimi, për një afat 10-vjeçar dhe pa interes.

⁶⁷Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., data 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., data 16.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbinit; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., data 8.7.2021 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., data 7.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në dosjen e subjektit.

⁶⁸Shihni aktet në aneksin 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së.

- me deklaratën noteriale nr. ***, data 21.12.2016, konfirmohet vullneti i shtetasit S. F. A. për dhënien e huas. Ai deklaroi gjithashtu se në datën 21.12.2016 Saimir Bahiti i ka dhënë 100 000 lekë si këst të parë të shumë s të dhënë hua dhe se për këtë shumë ka lëshuar një deklaratë me shkrim dore.
- huaja është deklaruar nga subjekti në DPV 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, duke deklaruar detyrimin e shlyer dhe atë të palikuiduar.
- në deklaratën *Vetting* në lidhje me këtë hua ka deklaruar: “*Hua e marrë nga shtetasi S. A., me qëllimin e blerjes së apartamentit, me vlerë 1.200.000 lekë. Është shlyer 100.000 lekë nga huaja. Mbetur pa u shlyer nga huaja 1.100.000 lekë*”.
- Në shpjegimet e tij në ILDKPKI⁶⁹, në lidhje me këtë huamarrje subjekti ka deklaruar se: “*S.A. është shoku im i fëmijërisë. Mundësitë e tij financiare kanë qenë punësimi i tij, ku ka pasur një pagë afërsisht 70.000 lekë dhe një punësim tjetër me një rrogë në 400 euro në muaj. Për këtë paraqes edhe statement bankar të tij në Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Gjendja e detyrimit ka qenë po aq sa është deklaruar, në shumën 1.200.000 lekë.*”
- Në lidhje me mënyrën e marrjes së shumë prej 1.200.000 lekësh, në shpjegimet e tij në ILDKPKI⁷⁰ subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar se ky transaksion është kryer *cash*. Ndërsa e pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mënyrën dhe kohën e marrjes së huas, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar⁷¹ se kjo hua është marrë në datën 1.7.2012 dhe i është dhënë *cash* bashkëshortit të saj.

70. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit S. A., përveç dokumentacionit të paraqitur bashkëngjitur deklaratës *Vetting*⁷² dhe përgjigjeve të pyetësorit të datës 20.9.2021 drejtuar subjektit, u administruan parashtrimet e bashkëshortes së subjektit gjatë procesit të saj, ku ka deklaruar se shuma e dhënë hua ka si burim të ardhurat e huadhënësit nga paga. Ndërkohë, ka informuar se S. A. gjatë vitit 2011 ka hapur dy llogari bankare në shkurt të vitit 2011: një në lek në vlerën 2.750.000 lekë dhe një në euro në vlerën 5.200 euro. Këto llogari e kanë burimin nga kursimet e anëtarëve të tij të familjes, të siguruar nga emigracioni i vëllait B. A., të ardhura nga aktiviteti tregtar restorant nga viti 1991 i babait të tij F. A. dhe të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme. Në mbështetje të pretendimeve të saj, bashkëshortja e subjektit ka depozituar dokumentacionin, si vijon:

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.3.2022, me deklarues S. A., i cili deklaroi në lidhje me administrimin e kursimeve të vëllait dhe babait të tij në dy llogaritë bankare në BKT, të hapura në vitin 2011;
- Shkresë nr. *** prot., datë 23.3.2022, e DRT-së Elbasan, ku konfirmohet se F. A. ka qenë i regjistruar pranë ish-Degës së Tatimeve Librazhd, me aktivitet “Restorant”;
- Kontratë shitblerjeje pasurie nr. ***, datë 22.11.2002, me palë shitëse F. e B. A. e palë blerëse L. B., së bashku me mandatarkëtimin e datës 16.12.2002 për pagesën e tatimit në ZVRPP. Vlera e shitjes së pasurisë rezultoi 600.000 lekë;

⁶⁹Kërkesë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2021.

⁷⁰Kërkesë nr. *** prot., datë 20.4.2021, drejtuar ILDKPKI-së; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2021.

⁷¹Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 20.9.2021 në dosjen e subjektit të rivlerësimit E. B.

⁷²Instituti i Sigurimeve Shoqërore përmes shkresës nr. *** prot., datë 11.6.2021, informon lidhur me të ardhurat nga paga të përfituara nga z. A. nga janari 2012 e në vijim; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përmes shkresës nr. ***, datë 21.6.2021, informon se shtetasi S. A. nuk rezultoi i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat; DPSHTRR përmes shkresës nr.*** prot., datë 4.6.2021 informon se z. A. nuk ka mjet të regjistruar në këtë institucion; Qendra Kombëtare e Biznesit, përmes shkresës nr. *** prot., datë 10.6.2021, informon se shtetasi S.A. nuk figuron i regjistruar në regjistrin tregtar; ASHK⁷² informon se S. A. ka në pronësi Apartament nr. pasurie *** me sip. 80.3 m² dhe garazh nr. pasurie *** me sip.13.1m², të përfituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.9.2020.

- Kontratë shitblerjeje pasurie nr. ***, datë 26.10.2000, me palë shitëse F. A. e palë blerëse B. K., së bashku me mandatarkëtimin e datës 26.10.2000 për pagesën e tatimit në ZVRPP. Vlera e shitjes së pasurisë rezulton 2.500.000 lekë.

71. Pavarësisht sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, në konsideratë të fakteve: (i) periudhës së largët të përfitimit të shumës 3.100.000 lekë nga babai i huadhënësit (10 dhe 12 vite më parë se dhënia e huas) nga shitja e dy pasurive të paluajtshme; (ii) është e paqartë nëse huadhënësi ka përfituar të ardhura nga dy pasuri të shitura nga babai i tij, Komisioni vlerësoi që huadhënësi S. A. të analizohet i vetëm. Periudha e analizuar është nga janari 2007⁷³ deri në datën 1.7.2012 kur ai ka dhënë huan, pasqyruar në tabelën më poshtë. Nga kjo analizë ku u përfshinë të ardhurat e dokumentuara nga puna të z. S. A. dhe shpenzimet e tij të jetesës, por nuk u përfshinë huaja e dhënë në shumën 1.200.000 lekë subjektit dhe as shuma 3.100.000 lekë si e ardhur nga shitja e dy pasurive të paluajtshme nga babai i huadhënësit, rezultoi se huadhënësi nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të dhënë huan prej 1.200.000 lekësh, për shkak të një balance negative 506.896 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

| Pershkrimi | <i>Kumulative 2007-01.07.2012</i> |
|---|-----------------------------------|
| Pasuri | 3 704 677 |
| <i>Ndryshim Likuiditeti</i> | <i>3 704 677</i> |
| Gjendje likuiditeti | |
| Te ardhura | 3 950 656 |
| Shtator 2006- korrik 2007 Punesuar ne *** Sipas Vertetimeve te ISSH | 104 760 |
| 07.12.2007-31.12.2007 (paga ne BKT) | 102 000 |
| 06.06.2008-07.11.2008 *** | 173 957 |
| Nentor 2009 - dhejtor 2012 punesuar ne *** | 1 445 260 |
| Tetor 2009- dhjetor 2011 punesuar ne *** | 1 960 731 |
| Te ardhura nga Interesat bankare | 163 947 |
| Shpenzime | 752 874 |
| Shpenzime jetese per nje person | 752 874 |
| | 0 |
| Mundesi per kursime | -506 896 |

72. Në parashtrimet e tij, subjekti risjell në vëmendje provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ në lidhje me të ardhurat e shtetasit S. A. Duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjtit, ai pretendon që analiza financiare e shtetasit S. A. për të verifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua, duhet të përfshijë vetëm këtë shumë e cila është objekt huaje, pa përfshirë shtesën e likuiditetit e cila nuk është pasuri e shtetasit S. A., por e familjarëve të tij. Po kështu, duke deklaruar se pa të drejtë nuk është përfshirë në analizën financiare shuma prej 3.100.000 lekësh si e ardhur nga shitja e dy pasurive të paluajtshme nga babai i huadhënësit, subjekti pretendon që Komisioni duhet të kryejë analizë, duke përfshirë në këtë analizë të gjitha burimet financiare familjare, ose nuk duhet të përfshijë në analizë pasurinë likuiditet të ndodhur në bankë, likuiditet për të cilin z. A. ka shpjeguar me prova bindëse se ka burim kursimet e vëllait edhe të prindërve të tij. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare,

⁷³Subjekti ka paraqitur si burim të ardhura nga shtatori 2006, por meqenëse shpenzimet e jetesës janë më të larta se paga për këtë vit/periudhë, ky vit është konsideruar si 0, për shkak të moslogjikës financiare (një person nuk mund të shpenzojë më shumë nga sa nxjerr të ardhura).

sipas së cilës shtetasi S. A. ka pasur mundësi të kursejë me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua.

Përveç sa më sipër, subjekti ka sjellë në vëmendje se, pavarësisht se në jurisprudencën e Kolegjit është mbajtur qëndrimi se secili nga bashkëshortët do t'i nënshtrohet një hetimi të pavarur nga ana e trupave të rivlerësimit, Komisioni në rastin konkret duhet të vlerësojë si provë edhe konkluzionet e arritura në vendimin nr. ***, datë 8.4.2022, për bashkëshorten e tij E. B. në lidhje me huan e marrë z. S. A. Për më tepër, sipas tij, Komisioneri Publik nuk ka ngritur shkaqe ankimore për këtë pikë të vendimit dhe një vendimmarrje e kundërt e Komisionit për këtë pikë do të cenonte parimin e sigurisë juridike. Subjekti ka paraqitur të njëjtat dokumente që ka paraqitur edhe gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit S. A.

73. Në procesin e vendimmarrjes, Komisioni vlerëson se është e vërtetë që Kolegji⁷⁴ orienton Komisionin që analiza financiare e huadhënësit të shtrihet vetëm për shumën e dhënë hua pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Por, nga ana tjetër, Kolegji orienton se vlerësimi duhet të behet referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre. Në rastin konkret, Komisioni vlerësoi të mos i marrë në konsideratë pretendimet e subjektit referuar faktit se likuiditetet kanë ekzistuar në bankë në emër të huadhënësit në momentin e dhënies së huas. Për këtë shkak ato u vlerësuan të jenë pjesë e analizës së tij financiare, e cila pasqyron mundësinë financiare të huadhënësit në momentin e dhënies së huas. Sa i takon shumës prej 3.100.000 lekë përfituar nga babai i huadhënësit 12 vite më parë se dhënia e huas, referuar periudhës së largët të përfitimit të kësaj shume, nuk është e besueshme e, për rrjedhojë, nuk mund të çmohet që kjo shumë është përdorur për dhënien e huas. Për më tepër, nuk u vërtetua që këto të ardhura i përfitoi tërësisht huadhënësi. Për pasojë, në përfundim të procesit, u vlerësua që huadhënësi nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të dhënë huan në vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2012, sipas parashikimit të pikës 3 të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

74. Në lidhje me shlyerjen e kësaj huaje, meqenëse nuk është marrë në konsideratë marrja e huas, shlyerja e saj nuk është përfshirë si shpenzim në analizën financiare.

75. Gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit janë kryer verifikime mbi gjendje konflikti të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortes së tij me huadhënësin S. A. Konkretisht u kërkuan të dhëna për procedime penale në emër të huadhënësit nga prokuroritë e Shkodrës, Kurbinit, Durrësit dhe Kavajës, ku subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë ushtruar detyrën, nga përgjigjet⁷⁵ e të cilave nuk rezultuan të dhëna për procedime penale.

Analiza financiare për blerjen e apartamentit

76. Në përfundim të hetimit administrativ, është kryer analiza financiare për blerjen e pasurisë apartament pasqyruar në tabelën më poshtë: (i) duke konsideruar shumën 21.243 3 euro si shpenzim të subjektit; (ii) duke mos konsideruar me të ardhura të ligjshme huan 1.200.000 leke të dhënë prej huadhënësit S. A.

| Përshkrimi | deri 27.7.2012 | nga 1/8 deri 31.12.2012 | Totali i të dyjave V. 2012 |
|-------------------|-----------------------|--------------------------------|-----------------------------------|
| | 104.000 euro | 21.493,55 euro | 125 494 euro |
| PASURIA | 11 802 282 | 4 301 988 | 16 104 270 |

⁷⁴Shih vendimin nr. 15, datë 17.7.2019 dhe vendimin nr. 20, datë 31.7.2019.

⁷⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbinit; shkresë kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 8.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në dosjen e subjektit.

| | | | |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| Apartament sip. 87.3 m ² + verandë sip. 73.5 m ² | 14 530 880 | 3 003 079 | 17 533 959 |
| <i>Ndryshim likuiditeti</i> | -2 728 598 | 1 298 909 | -1 429 689 |
| Gjendje likuiditeti | 104 554 | 1 403 463 | 1 403 463 |
| DETYRIME | 9 986 000 | -20 210 | 9 965 790 |
| Huaja nga P. G. 50,000 euro, afat 10 vjet | 6 986 000 | 0 | 6 986 000 |
| Pagesë e huas nga P. G. | | -2 794 400 | -2 794 400 |
| Huaja nga I. H. 3 mil | 3 000 000 | | 3 000 000 |
| Huaja nga S. A. 1.2 milionë | | | 0 |
| Kredia bankare 20.000 euro, disb. 2.11.2012 | | 2 794 400 | 2 794 400 |
| Pagesa të kredisë bankare, disb. 2.11.2012 | | -20 210 | -20 210 |
| PASURIA NETO | 1 816 282 | 4 322 198 | 6 138 480 |
| TË ARDHURA | 1 238 144 | 2 242 504 | 3 480 648 |
| Të ardhurat e subjektit | 632 097 | 451 498 | 1 083 595 |
| Të ardhurat e bashkëshortes E. B. | 551 329 | 393 806 | 945 135 |
| Dhuratë nga nëna N. B. më 6.9.2012 | 0 | 1 397 200 | 1 397 200 |
| Të ardhura nga interesa bankarë nga depozita | 54 718 | | 54 718 |
| SHPENZIME | 484 626 | 597 279 | 1 081 906 |
| Shpenzime jetike | 267 626 | 197 534 | 465 160 |
| TIMS | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime qira 2006 - tetor 2012 | 140 000 | 60 000 | 200 000 |
| Shpenzime udhëtimi për në vendin e punës subjekti | 77 000 | 44 000 | 121 000 |
| Shpenzime komisione disbursimi kredie | | 45 746 | 45 746 |
| Shpenzime mobilimi | | 250 000 | 250 000 |
| | | | 0 |
| Mundësia për kursime | -1 062 764 | -2 676 974 | -3 739 738 |

77. Subjektit i ka kaluar barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duket se, referuar fakteve: (i) nga të dhënat bankare, shuma 21.493,55 euro rezulton e derdhur nga subjekti Saimir Bahiti; (ii) nuk janë vërtetuar raste të tjera të ngjashme të likuidimit të çmimit të shitjes nga blerësit në arkën e shoqërisë, e më pas likuidimet në llogaritë bankare të shoqërisë të jenë kryer nga punonjës të shoqërisë; (iii) nuk ka të dhëna në lidhje me ecurinë e kallëzimit penal të subjektit sa i takon nënshkrimin të tij në dokumentin bankar, shuma prej 21.493,55 euro, paguar pranë BKT në datën 3.12.2012, është konsideruar si vlerë e paguar nga subjekti mbi çmimin 104.000 euro, duke u përfshirë si shpenzim i tij në analizën financiare. Sipas kësaj analize⁷⁶, në të cilën nuk është përfshirë si burim me të ardhura të ligjshme edhe huaja prej 1.200.000 lekësh e dhënë nga shtetasi S. A., subjekti ka një balancë negative prej 3.739.738 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

78. Në parashtrimet e veta, subjekti ka paraqitur qëndrimin e tij bazuar në dokumente shkresore, të cilat janë trajtuar dhe analizuar në mënyrë të hollësishme në këtë vendim. Konkretisht, në paragrafin 36 të këtij vendimi janë trajtuar pretendimet e subjektit në lidhje me raste të tjera të ngjashme të likuidimit të çmimit të shitjes nga blerësit në arkën e shoqërisë. Në paragrafët 39,40 të këtij vendimi janë trajtuar pretendimet e subjektit në lidhje me ecurinë e kallëzimit penal të subjektit sa i takon nënshkrimin të tij në dokumentin bankar të datës 3.12.2012. Ndërsa në paragrafët 37, 38 dhe 80 të këtij vendimi janë trajtuar pretendimet e

⁷⁶E cila mund të ndryshonte në varësi të provave dhe parashtrimeve të subjektit.

subjektit në lidhje me pagesën në emër të tij të shumës 21.493,55 euro pranë BKT-së dhe në lidhje me huan 1.200.000 lekë, marrë shtetasit S. A.

Vlerësimi i Komisionit

79. Në përfundim të procesit, pavarësisht informacionit kontradiktor të shoqërisë “****” sh.p.k. nëpërmjet tri shkresave të administruara, Komisioni e vlerësoi të besueshëm informacionin e shkresës së tretë të kësaj shoqërie në datën 1.10.2021, mbështetur nga deklaratimet e administratorit të shoqërisë, F. B., me deklaratën noteriale nr. ***, e datës 10.6.2022, si dhe ato të përfaqësueses së shoqërisë, znj. A. P., pyetur nga Komisioni në cilësinë e dëshmitares në datën 7.7.2022. Në dëshminë e saj, duke deklaruar se dy përgjigjet e para të shoqërisë ishin përgatitur nga persona që nuk ishin në dijeni të historikut të shoqërisë, zonja P. konfirmoi se zoti Bahiti ka derdhur *cash* në arkën e shoqërisë shumë e çmimit të shitjes, të cilat pasqyrohen edhe në librat e arkës, duke vënë në dispozicion një faqe nga libri i shitjeve të shoqërisë “****” sh.p.k., në të cilën, midis të dhënave për klientë të tjerë, evidentohet se në datën 27.7.2012 është regjistruar arkëtimi nga shtetasi Saimir Bahiti në shumën 14.301.040 lekë ose 104.000 euro. Më tej konfirmoi se ka qenë praktikë e ndjekur nga shoqëria që, në interes të shitjeve të sa më shumë pasurive, çmimi i blerjes është likuiduar *cash* nga klientët blerës, ndërsa derdhjet në bankë bëheshin nga punonjës të shoqërisë. Në rastin konkret u vërtetua që derdhjet në Credins Bank dhe BKT nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, për Komisionin nuk ka më dyshime në lidhje me faktin që për efekt të pagimit të çmimit të blerjes së pasurisë, subjekti ka paguar *cash* shumë 104.000 euro, sipas përcaktimit në kontratën e shitjes së pasurisë dhe dokumenteve shkresore që ai ka paraqitur.

80. Sa i takon shumës 21.493,55 euro, paguar pranë BKT në datën 3.12.2012 me përshkrimin “*Saimir Bahiti derdhje për likuidim kësti blerje apartamenti nr. *** (vlera totale 21,500 euro – komisioni 0,03 %, në vlerën 21,493.55 euro)*”, bazuar në provat shkresore të administruara, Komisioni krijoi bindjen se kjo shumë nuk është paguar fizikisht pranë sportelit të BKT-së nga ana e subjektit. Nga ana tjetër, ndonëse nuk ka të dhëna të vërtetuara nga kush është kryer dhe nënshkruar kjo pagesë, për sa kohë në praktikë pagesat në bankë kryheshin nga persona të tretë (ashtu sikurse ka ndodhur për shumë 104.000 euro), nuk përjashtohet mundësia që kjo shumë të jetë likuiduar *cash* nga ana e subjektit e, për këtë shkak, në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, kjo shumë ishte konsideruar si shpenzim i subjektit. Por, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi që përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk mund të arrihet në përfundimin që 21,500 euro kanë dalë nga buxheti familjar i subjektit, pasi: (i) nuk rezultuan të dhëna që subjekti të ketë blerë pasurinë objekt verifikimi më shumë se çmimi 104.000 euro, i cili nuk u vërtetua të jetë një çmim preferencial; (ii) nuk u vërtetua që subjekti të ketë përfituar/lidhur marrëveshje apo kontrata të çdo lloji për pasuri të tjera, përveç apartamentit objekt verifikimi, si dhe nuk ka pasur informacione nga çdo lloj burimi për një pasuri tjetër të mundshme të fshehur nga ana e subjektit.

Në këto kushte, në analizën financiare të rishikuar në përfundim të procesit, trajtuar në paragrafin 87 të këtij vendimi, shuma prej 21.000 euro nuk u përfshi si shpenzim i subjektit në vitin 2012. Ndërsa, sa i takon huas prej 1.200.000 lekësh, marrë nga shtetasi S. A., për sa kohë nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme të tij në momentin e dhënies së huas, arsyetuar në paragrafin 73 më sipër, kjo shumë nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme.

81. “*Automjeti i markës ‘Peugeot’, tip autoveturë 206, me numër **** shasie, viti i prodhimit 2002, me benzinë, me ngjyrë jeshile, me targa ***, regjistruar në emrin e Saimir Bahitit. Kontrata e shitjes së pasurisë së luajtshme me nr. ***, datë 2.5.2014, vlera 170 000 lekë. Burimi i krijimit janë të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes. Pjesa takuese 50%*”. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar se automjeti është shitur minimalisht 100.000 lekë më pak sesa është blerë një vit më parë.

81.1. Gjatë hetimit administrativ, DPSHTRR-ja⁷⁷ ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të subjektit Saimir Bahiti automjetin me targa ***. Ky automjet është blerë nga subjekti me kontratën e shitjes nr. ***, datë 2.5.2014, në shumën 170.000 lekë prej shtetasit O. A., i cili e kishte blerë nga shtetasi Sh. K. në datën 10.7.2013 në çmimin 2.000 euro. Blerja e këtij automjeti është deklaruar në DPV-në 2014. Nuk rezultuan të dhëna⁷⁸ në drejtim të ndonjë konflikti interesi për shkak të detyrës së subjektit me O. A. apo përfshirje të tij në veprimtari kriminale. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka justifikuar blerjen e mjetit me të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

81.2. Nisur nga informacione konfidenciale për vënien e sekuestros mbi një automjet në pronësi të subjektit, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse është vënë sekuestro mbi këtë automjet apo çdo lloj automjeti në pronësi apo përdorim të tij. Nëse po, të deklarojë arsyet e sekuestrimit dhe vijimësinë, duke vërtetuar deklaratimet me dokumente shkresore. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se në pronësi ka pasur vetëm një automjet dhe asnjë automjet tjetër në përdorim. Sipas tij, referuar vërtetimit të datës 12.6.2020, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, deri në datën 12.06.2020, kohë që është shitur automjeti, ai nuk është debitor për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, gjyba të kontrollit teknik, gjyba të kontrollit në rrugë ose nuk është bllokuar nga organet kompetente të përcaktuara në ligj. Për të mbështetur pretendimin e tij, subjekti ka paraqitur dokumentin me rubrikë “Vërtetim” të datës 12.6.2020, printuar nga faqja zyrtare e-albania, nga përmbajtja e të cilit nuk rezulton që automjeti i tij me targë *** të jetë bllokuar.

82. “Gjendje në llogarinë bankare me nr. *** në ‘Raiffeisen Bank’ në emër të Saimir Bahiti në shumën 21578,76 lekë. Pjesa takuese 50%”. Deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

83. Gjendja në llogarinë bankare me nr. *** në ‘Credins Bank’ në emër të bashkëshortes E.B., në vlerën 0.23 lekë. Pjesa takuese 50%”. Deklarimet e subjektit përputhen me të dhënat bankare.

84. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *Cash në lekë në shtëpi: 200.000 lekë. Pjesa takuese 50%*”. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për krijimin e këtij likuiditeti.

Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë

85. Në këtë rubrikë, subjekti ka kryer deklarime të detajuara dhe të sakta në lidhje me huan e marrë nga shtetasi P. G.; kredi bankare marrë tek “Raiffeisen Bank”, me vlerë 20 000 euro; Hua e marrë nga shtetasi S. A., trajtuar hollësisht më sipër në këtë vendim.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur E. B. (bashkëshortja e subjektit – subjekt rivlerësimi)

86. Znj. E. B. ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruara në emrin e saj.

Analizë financiare për gjithë periudhën e vlerësimit

87. Në përfundim të hetimit administrativ, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit dhe familjes së tij për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet gjatë periudhës së detyrës si prokuror, Komisioni kreu analizën financiare, sipas së cilës ka rezultuar se pamundësia totale e subjektit për të krijuar pasuritë dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara është -3.739.738 lekë. Kjo balancë i përkiste vetëm vitit 2012 kur është bërë pasuria apartament. Në përfundim të

⁷⁷Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.1.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

⁷⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin; dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.7.2022 nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

procesit, pas rishikimit të analizës financiare, kjo balancë bëhet -736.659 lekë, pasi ashtu sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim: (i) shuma 21.493,55 euro paguar pranë BKT në datën 3.12.2012 nuk u konsiderua si shpenzim i subjektit mbi shumën 104.000 euro; (ii) huaja prej shtetasit S. A. në vlerën 1.200.000 lekësh marrë në vitin 2012, nuk u konsiderua si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament. Kjo balancë nuk konsiderohet penalizuese në vlerësimin e kriterit pasuror.

Kontrolli i figurës

88. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 6.2.2020, të KDZH-së, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit grupi i punës pranë DSIK-së ka arritur në konkluzionin për përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës.

Hetimi i Komisionit në lidhje me figurën

89. Në funksion të një hetimi të pavarur, nisur edhe nga informacionet konfidenciale të organeve ligjzbatuese, Komisioni ka kërkuar përditësimin e informacionit nga DSIK-ja. Në përgjigje të kërkesës, ky institucion ka përcjellë raportin nr. *** prot., datë 10.10.2022, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr.***, datë 25.10.2022, të KDZH-së. Në përmbajtje të këtij raporti referohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit, si veprime korruptive shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, me qëllim dhënien e vendimeve për pushimin e hetimeve në favor të një pale, si dhe kontakte të papërshtatshme, jorastësore, me persona të përfshirë në afëra korruptive, pjesë e të cilave është edhe vetë subjekti si përfitues i shumave monetare, kundrejt pushimit të hetimeve në shkelje të ligjit. Në përfundim, grupi i punës ka ndryshuar konstatimin fillestar, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Saimir T. Bahiti.

90. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me raportin e DSIK-së dhe në parashtrimet e tij, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka deklaruar se sipas tij nuk gjendet asnjë shpjegim mbi arsyet që DSIK-ja ka ndryshuar konkluzionin nga i përshtatshëm në i papërshtatshëm, dhe se ai nuk është njohur me dokumentet ku mbështetet ky konkluzion. Po kështu, sipas tij, raporti i parë i DSIK-së është përcjellë në Komision shumë kohë pasi subjekti është transferuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ai deklaroi se raporti i dytë i DSIK-së është joserioz, i pabazuar dhe jo i drejtë, për më tepër që raporti i dytë u referohet të “dhënave” për kohën përpara se të dilte raporti i parë i të njëjtit institucion. Më tej, ai deklaroi se në kushtet e mungesës së provave ku mbështetet konkluzioni i këtij raporti, e bën të pamundur mbrojtjen e tij dhe kjo cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas tij, i vetmi shpjegim që mund të japë përpara Komisionit në këtë moment, është se gjatë karrierës së tij si prokuror ka ushtruar detyrën me përkushtim dhe korrektësi, duke zbatuar vetëm ligjin. Në konkluzion të sqarimeve të tij, subjekti deklaroi se ai ka plotësuar në mënyrë të saktë formularin e kontrollit të figurës, nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe nuk është përpjekur të fshehtë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar e, në këto kushte, ai i plotëson të gjitha kriteret e parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 34-39 të ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

91. Trupi gjykues verifikoi çdo informacion pranë organeve ligjzbatuese dhe kreu hetime në lidhje me çdo të dhënë që kishte lidhje apo ishte përmendur emri i subjektit, duke administruar

dosjet penale të trajtimit të disa çështjeve penale nga ana e subjektit të rivlerësimit, të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale.

92. U kryen verifikime për kontakte të papërshtatshme të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Konkretisht, nga hyrje-daljet e sistemit TIMS, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë udhëtuar me automjetet me targa, si vijojnë: ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***; ***. Subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pronarët e këtyre automjeteve, marrëdhënien me ta dhe qëllimin e udhëtimit, i cili në përgjigjet e tij ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.6.2022, mbi pronësinë e këtyre automjeteve dhe ka dhënë sqarime⁷⁹ specifike për marrëdhënien me ta dhe qëllimin e udhëtimit. Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, rezultuan të njëjtat të dhëna të deklaruara nga subjekti. Nuk rezultuan të dhëna për procedime penale të shtetasve me të cilët kishte udhëtuar subjekti apo huadhënësit⁸⁰.

93. Janë kryer verifikime në lidhje me ndryshimin e gjeneraliteteve emër/mbiemër të vëllait të subjektit në vitin 2011, nga shtetasi J. T. B., i datëlindjes 28.7.1984, në A. T. L., i datëlindjes 28.7.1984, duke u vërtetuar se ky ndryshim është bërë në rrugë ligjore, sikurse ka konfirmuar zyra e gjendjes civile Librazhd⁸¹ dhe, për arsye objektive të parashtruara nga subjekti në përgjigjet e tij të datës 8.7.2022, të cilat u vlerësuan të logjikshme dhe bindëse nga ana e Komisionit. Nga verifikimet e kryera⁸² nuk rezultuan të dhëna për përfshirje të këtij shtetasi në veprimtari të krimit të organizuar.

94. Në raportin e deklasifikuar të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E. B., referohet se në datën 26.1.2017 subjektit të rivlerësimit E. Th. B. i është revokuar viza amerikane. Lidhur me revokimin e vizës amerikane nga Ambasada e SHBA-së:

- U verifikuan pasaportat e subjektit dhe bashkëshortes së tij, nga ku rezulton se ata janë pajisur me vizë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për një periudhë 3-vjeçare 29.6.2016 - 26.6.2019. Kjo vizë rezulton e revokuar, por nuk evidentohet data e revokimit.

- U verifikua formulari i vetëdeklarimit për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se: (i) formulari mban datën 23.1.2017; (ii) Në përgjigje të pyetjes “g”, pjesa 5, “të dhëna për sigurinë”, nuk është deklaruar revokimi i vizës amerikane;

- Pas kërkesës së Komisionit, DSIK-ja informoi se ai e ka dorëzuar formularin e kontrollit të figurës në datën 25.1.2017. Siç vërehet, referuar këtij informacioni, revokimi i vizës ka ndodhur pas plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës;

- Në përfundim të hetimit administrativ, pasi janë shqyrtuar edhe deklaratimet e zonjës B. gjatë procesit të saj, referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe Komisionit⁸³, në rastin e revokimit të vizave të lëshuara nga Ambasada e SHBA-së në favor të subjekteve të rivlerësimit, ku është vlerësuar vetëm pasaktësia në lidhje me “mosdeklarimin e revokimit të vizës amerikane”, Komisioni vlerësoi që për sa kohë që revokimi i vizës amerikane ka ndodhur pas plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës, një fakt i tillë nuk mund të përbëjë shkak për penalizim të subjektit.

95. Në vlerësimin përfundimtar, bazuar në standardet e kontrollit të figurës të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti është i papërshtatshëm. Por, duke qenë se nga analiza e

⁷⁹Shihni sqarimet e subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁸⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot. A.N., datë 28.6.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini; Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.7.2022 dhe nr. *** prot., datë 19.7.2022, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁸¹Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

⁸²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.9.2022, nga SPAK-u dhe dokumentacioni bashkëngjitur; Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

⁸³Shihni vendimet e Kolegjit nr. 2/2019; nr. 4/2021 dhe vendimet e Komisionit nr. ***/2019, nr. ***/2020.

trajtimit e disa çështjeve penale për të cilat ka pasur informacione konfidenciale, janë evidentuar disa problematika gjatë ushtrimit të detyrës nga subjekti, mangësitë e konstatuara janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes gjatë procesit të vendimmarrjes.

Vlerësimi i aftësive profesionale

96. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. *** prot., datë 11.6.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.06.2021; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti për analizimin e aftësive profesionale nga KLP-ja

97. Analiza e kryer nga KLP-ja është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit; (ii) tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjet penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore. Në përfundim, KLP-ja, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar në mënyrë të përmbledhur subjektin e rivlerësimit, si vijon:

97.1. Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore: Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin e ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Nga vlerësimet për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton të jetë vlerësuar “mirë” për vitin 2014, ndërsa për vitet 2015, 2016 është vlerësuar “shumë mirë”.

Arsyetimi ligjor: Subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor.

97.2. Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë: Qëndrimi i subjektit ka qenë në përgjithësi brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim. Ai ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të administruara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit prokurori Saimir Bahiti është eficient dhe efektiv.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore: Subjekti i rivlerësimit ka treguar profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Aftësia për të administruar dosjet: Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës.

97.3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë: Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Për të nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Integriteti: Nuk konstatohen të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia: Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

97.4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit: Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar: Nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Gatishmëria për t'u angazhuar: Prokurori Saimir Bahiti ka qenë pjesëmarrës në trajnime të tjera të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës jashtë periudhës së rivlerësimit dhe në trajnime të kryera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

98. Tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti rezultuan të njëjtat konstatime si ato të KLP-së dhe nuk u evidentuan problematika. Nga analiza e pesë dosjeve të shortuara, sikurse është referuar edhe në raportin e KLP-së, në katër prej tyre janë evidentuar konstatimet e mëposhtme, për të cilat Komisioni, me njoftimin e rezultateve të hetimit, i kërkoi subjektit sqarime e dokumenta.

Informacion i marrë nga dosja nr. 1

99. Kjo dosje i përket kallëzimit penal nr. ***, datë regjistrimi 15.7.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor - Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 20.7.2015, për kallëzimin penal nr. ***, datë 15.7.2015, për veprën penale të “mashttrimin në kredi”, parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal.

100. Nga analiza e materialeve të dosjes nga KLP-ja vërehet se:

- Në datën 15.7.2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka paraqitur kallëzim penal shtetasi Gj. N. Nga shqyrtimi i kallëzimit penal ka rezultuar se dhe më parë ky shtetas për të njëjtin fakt ka paraqitur kallëzim penal. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale të “mashttrimin në kredi”, që parashikohet nga neni 146 i Kodit Penal.

- Në lidhje me të dhënat e administruara për verifikimin e kallëzimit penal, për faktin e kallëzuar nuk duhet të regjistrohet procedim penal, pasi çështja është hetuar dhe/ose po hetohet nga organi i akuzës. Në mbështetje të nenit 290, pika 1, germa “e” dhe neni 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 20.7.2015, subjekti i rivlerësimit, prokurori Saimir Bahiti, ka vendosur: “1. Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 15.7.2015; 2. Të njohë me këtë vendim kallëzuesin; 3. Kundër këtij vendimi kallëzuesi ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër brenda pesë ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim”. Në këtë vendim, konkluzioni i prokurorit, në aspektin arsyetues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e përgjithshëm të pasqyruar në një paragraf. Prokurori i kushton më shumë rëndësi paraqitjes së hollësishme të provave duke cituar deklaratimet e personave të pyetur dhe përmbajtjen e akteve të administruara në fashikull, duke vështirësuar kuptimin e rrethanave të faktit. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë brenda afatit 30-ditor, i parashikuar në udhëzimin nr. 3, datë 19.6.2012, i ndryshuar”, i Prokurorit të Përgjithshëm.

- Fashikullit të kallëzimit penal nr. *** të vitit 2015 i është bashkëlidhur vendimi i datës 20.7.2015 për mosfillimin e procedimit penal dhe kallëzimi i shtetasit Gj. N., datë 15.7.2015.

Sikurse është konstatuar nga KLP-ja, për të mbështetur argumentet e dhëna në vendimin e mosfillimit, fashikullit të kallëzimit penal duhet t'i bashkëlidheshin, pasi të administroheshin nga procedimi penal nr. *** i vitit 2015 aktet e nevojshme, si kallëzimi penal, vendimmarrja për ndarjen e çështjes, vendimi për marrjen si të pandehur dhe çdo akt tjetër që mbështet argumentimin e vendimit të mosfillimit. Në fazën që ndodhet procedimi penal nr. *** i vitit 2015, ku sipas argumentimit në vendimin e mosfillimit nuk ka një vendim përfundimtar të prokurorisë apo gjykatës për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2015, referuar dispozitave procedurale penale (nenet 79, 92, 93, 290 të Kodit të Procedurës Penale), duket se nuk duhet të ishte vendosur mosfillimi i procedimit, por kallëzimi penal duhet t'u bashkohej akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015.

101. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumentacion në lidhje me konstatimin e mësipërm, si dhe informacion nëse ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal është paraqitur ankim, si dhe i është kërkuar informacion në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës.

102. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se:

- Procedimi penal nr. ***, viti 2015, është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi Gj. N. për veprën penale “mastrim në kredi”, që parashikohet nga neni 146 i Kodit Penal dhe për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, që parashikohet nga neni 186/2 i Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve është ngritur akuzë për veprën penale të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit A. N. Në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse është regjistruar vepra penale e parashikuar nga neni 186/3 në ngarkim të noterit që ka përpiluar kontratën e hipotekës me nr. ***, datë 13.5.2011. Sipas tij, në kushtet kur hetimi për të pandehurin A. N. ka qenë i plotë në përputhje me nenin 93, pika 1, germa “ç” të Kodit të Procedurës Penale, çështja penale është ndarë dhe çështja në ngarkim të këtij të pandehuri është dërguar për gjykim në datën 1.7.2015, ndërsa çështja në ngarkim te noterit i ka kaluar për kompetencë njësisë së përbashkët hetimore Task Force, në të njëjtën prokurori. Çështja penale në ngarkim të të pandehurit A. N. është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2015 pasi ka kaluar kontrollin dhe është miratuar nga titullari i institucionit. Më tej, ai ka sqaruar se në datën 15.7.2015 për të njëjtin fakt të hetuar në kuadër të procedimit penal nr. ***, shtetasi Gj. N. ka përsëritur kallëzimin penal. Në krye të kallëzimit titullari në atë kohë ka lënë një shënim, duke urdhëruar sekretaren e institucionit ta regjistrojë kallëzimin penal, pra t'i japë vulë kallëzimi penal dhe të regjistrohet si i tillë në regjistrin e kallëzimeve penale. Në këtë regjistër ky kallëzim ka marrë numrin rendor ***, datë 15.7.2015 dhe i ka kaluar për trajtim të mëtejshëm subjektit.

- Në konkluzion të prapësimeve të tij, subjekti deklaron se konstatimi i KLP-së nuk qëndron, pasi: (i) kallëzimi penal i përsëritur për të njëjtin fakt nga shtetasi Gj. N. nuk duhet të merrte numërtim dhe të regjistrohet në regjistrin e kallëzimit të veprave penale, pasi më parë ishte regjistruar një kallëzim i tillë. Në këtë rast, drejtuesi ose çdo prokuror i deleguar prej tij duhet të jepte një përgjigje me shkresë, ku kallëzuesit t'i bëhej me dije se çështja e kallëzuar prej tij kishte shkuar për gjykim dhe prokuroria nuk mund të bënte një hetim të dytë për rastin apo të përsëriste hetimin; (ii) në kushtet kur këtij kallëzimi të përsëritur i ishte dhënë numërtim, e vetmja zgjidhje ka qenë mosfillimi i procedimit penal të tij. Kjo për faktin se, edhe nëse do të regjistrohej si procedim sipas logjikës së përdorur nga grupi i vlerësimit në KLP, prokuroria duhet të kryente të njëjtat veprime që kishte kryer në kuadër të procedimit penal nr. *** dhe në përfundim do të ishte e njëjta vendimmarrje. Pra, në Gjykatë do të dërgohej e njëjta çështje për gjykim dy herë; (iii) kallëzimi penal i numërtuar *** edhe nëse do të merrte numër procedimi, pra edhe nëse do të regjistrohej, ai nuk mund të bashkohej me procedimin penal nr.***, pasi të dyja këto procedime nuk do të ndodheshin në të njëjtën fazë. Njëri do të ndodhej në fazën e hetimit, ndërsa tjetri *** ndodhej në fazën e gjyqimit, sepse tashmë ky i fundit përpara se të

ishite paraqitur kallëzimi i përsëritur, ndodhej në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

- Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) shkresë me nr. *** prot., datë 20.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës informohet se kallëzuesi Gj. N. ka paraqitur ankim në këtë gjykatë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal lidhur me kallëzimin nr.*** të vitit 2015 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 23.10.2015, ka vendosur pushimin e gjykimit me shkaku ligjor të parashikuar nga neni 112/1 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 2.11.2015; (ii) dokumente nga dosja penale nr. ***, viti 2015; (iii) dokumente nga dosja penale nr. ***, viti 2015.

103. Nga të gjitha dokumentet e administruara dhe sqarimet e dhëna nga subjekti, evidentohet qartësisht se dy çështjet objekti shqyrtimi, pra kallëzimi penal i shtetasit Gj. N. i datës 15.7.2015 dhe kallëzimi i mëparshëm i tij, nuk janë në të njëjtën gjendje, pasi i pari ka qenë në gjykim, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 8.7.2015, të Prokurorisë Shkodër, ndërsa i dyti tashmë kishte marrë numërtim dhe ishte regjistruar në regjistrin e kallëzimit të veprave penale, sikurse evidentohet nga shënimi me shkrim dore mbi kallëzimin penal për urdhërimin e regjistrimit të tij dhe trajtimin e mëtejshëm nga subjekti Bahiti. Në këto kushte, sqarimet e dhëna nga subjekti se nuk mund të vendoste bashkimin e çështjeve, parë në raport me nenin 92 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohen rastet e bashkimit të çështjeve⁸⁴ dhe kushti kryesor për bashkimin e tyre është gjendja e njëjtë e çështjeve në të njëjtën gjykatë, vlerësohen bindëse dhe nuk evidentohen problematika të mëtejshme. Përpos kësaj, vendimi i mosfillimit të procedimit penal i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit, pasi ankuesi kishte hequr dorë nga vazhdimi i gjykimit.

Informacion i marrë nga dosja nr. 2

104. Kjo dosje i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 30.7.2015 për veprat penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike” dhe “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga nenet 283/2 dhe 284/2 të Kodit Penal, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Dokumenti ligjor – Vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”, datë 3.12.2015, hartuar nga prokurori Saimir Bahiti.

105. Nga analiza e materialeve të dosjes nga KLP-ja, pasi evidentohen veprimet hetimore të kryera nga subjekti, vërehet se me vendimin datë 3.12.2015, në bazë të nenit 328, pika 1, germa “a” të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: “1. Pushimin e procedimit penal nr.***, të vitit 2015; 2. Të njohë me këtë vendim të interesuarit; 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ose tek Prokurori më i lartë”.

106. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse ndaj vendimit të pushimit është paraqitur ankim, e nëse po, të japë informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës duke paraqitur dokumente shkresore. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me verifikimet në sistemin ICMIS, nga ku nuk rezultojnë çështje të regjistruara për shtetasit F. F. dhe M. R. e, si pasojë, ata nuk kanë paraqitur ankim në gjykatë.

Informacion i marrë nga dosja nr. 3

107. Kjo dosje i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 5.6.2014, për kryerjen e veprës penale “dhënie e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/1

⁸⁴1. Bashkimi i çështjeve që qëndrojnë në të njëjtën gjendje dhe shkallë para të njëjtës gjykatë mund të vendoset, kur nuk dëmtohet shpejtësia e zgjidhjes së tyre: a) në rastet e parashikuara nga neni 79; b) në rastet e veprave penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit; c) në rastet, kur prova e një vepre penale ose e një rrethane të saj ndikon mbi provën e një vepre penale tjetër ose të një rrethane të saj.

i Kodit Penal. Dokumenti ligjor – vendim “Për pushimin e çështjes penale”, datë 18.7.2014, përgatitur nga prokurori Saimir Bahiti, subjekt rivlerësimi.

108. Nga ana e KLP-së, në analizë të materialeve të dosjes, është konstatuar se:

- Me mbërritjen e materialit referues të policisë gjyqësore, prokurori i ngarkuar me hetimin e çështjes Saimir Bahiti, në datën 5.6.2014, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “dhënies së ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/1 i Kodit Penal. Prokurori ka disponuar me “Urdhër për delegimin e veprimeve hetimore”, datë 8.6.2014, në mbështetje të nenit 300/2 të Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore D. H. që të kryejë disa veprime hetimore me afat të përcaktuar.

- Në datën 18.7.2014, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar “Vendimin për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, në mbështetje të nenit 328, pika 1, germa “b”, të Kodit të Procedurës Penale, ku ka vendosur: “1. Pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014. 2. Me këtë vendim të njohë të interesuarit. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ose tek prokurori më i lartë”. Me shkresën nr. ***, datë 29.7.2014, vendimi i është dërguar për njoftim shtetasit Xh. R.

- Në datën 18.7.2014, subjekti ka urdhëruar kthimin e pasaportës biometrike dhe lejes së qëndrimit italiane, pronarit të saj të ligjshëm shtetasit A. R. dhe këtë veprim ia ka deleguar oficerit të policisë gjyqësore D. H. Nuk është administruar në dosje procesverbali për kthimin e provave materiale.

109. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mosadministrimin në dosje të procesverbalit për kthimin e provave materiale, si dhe të japë informacion nëse ndaj vendimit të pushimit është ushtruar ankim e, nëse po, të japë informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës duke paraqitur dokumente shkruese.

110. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se kthimi i provës materiale nuk e kushtëzon pushimin e çështjes. Sipas tij, kthimi i sendit kur ai nuk shërben më si provë materiale për hetimin/gjykimin mund të bëhet në çdo kohë, qoftë dhe me vendim përfundimtar sipas nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa procesverbali që dokumenton kthimin e sendit në çdo kohë mund të administrohet në dosjen hetimore. Më tej, subjekti ka informuar se procedimi është pushuar me vendimin e pushimit datë 18.7.2014 dhe në lidhje me këtë procedim penal nuk ka shënime në regjistër për shfuqizim vendimi apo vendim për rifillimin e çështjes. Ndërkohë që sipas shkresës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 28.12.2022, nga verifikimet e kryera në sistemin ICMIS, nuk rezulton çështje penale në të cilën shtetasi Xh. R. te jetë palë ndërgjyqëse. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur: shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.12.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.12.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

111. Sqarimet e dhëna si më sipër vlerësohen jo tërësisht bindëse, pasi subjekti nuk është shprehur në lidhje me mungesën e administrimit në dosje të procesverbalit për kthimin e provës materiale, duke u shprehur vetëm në lidhje me faktin që kjo nuk e kushtëzon hetimin dhe mund të administrohet në çdo kohë. Procesverbali për kthimin e provës materiale duhet të jetë pjesë e dosjes penale dhe mungesa e tij konsiderohet si një mangësi në drejtim të administrimit të dokumenteve në dosjen penale. Ndërkohë, ndaj vendimit të pushimit nuk ka pasur ankim.

Informacion i marrë nga dosja nr. 4

112. Kjo dosje i përket procedimit penal nr. ***, regjistruar në datën 15.7.2015, me të pandehur Gj. L., i akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 3.8.2015. Dokumenti ligjor - Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015”, datë 3.8.2015, përgatitur nga prokurori Saimir Bahiti.

113. Pas shqyrtimit të akteve shkresore, vërehen veprimet si vijojnë:

- Pas mbërritjes së materialit referues të policisë gjyqësore, subjekti i rivlerësimit në mbështetje të nenit 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në datën 15.7.2015.

- Në datën 15.7.2015 ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale. Me këtë urdhër shtetasi Gj. L. ka marrë cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike apo impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, hetuar me masë sigurimi fillimisht “arrest në burg” me afat dhe më pas me masë sigurimi “arrest shtëpie”.

-Prokurori, në vlerësim të të dhënave të grumbulluara gjatë hetimit paraprak, në datën 22.7.2015, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale, ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”. Me këtë akt shtetasi Gj. L. është marrë i pandehur për veprën penale të “vjedhjes së energjisë elektrike apo impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal.

- Pasi është siguruar për pyetjen e shtetasit Gj. L. në cilësinë e të pandehurit dhe njohjen e tij me materialet e çështjes, në datën 3.8.2015 subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim. Vendimi është marrë konform nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, prokurori Saimir Bahiti, me “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2015”, ka paraqitur për gjykim procedimin penal në ngarkim të të pandehurit Gj. L., para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

114. Nga analiza e KLP-së konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti nuk është treguar kujdes në përpilimin e procesverbalit të pyetjes së të pandehurit si dhe atë të njohjes me aktet, ku mungojnë data, pyetjet e përgjigjet e të pandehurit, si dhe emri i avokatit mbrojtës. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, si dhe të japë informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës për kërkesën për gjykim, duke paraqitur dokumente shkresore.

115. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se akti i pyetjes së të pandehurit në dosje nuk ka ndonjë vlerë juridike, pasi një veprim i tillë nuk është kryer. Sipas tij, i pandehuri nuk është pyetur sepse ai ka përfitur nga e drejta e tij për të mos dhënë deklaratime dhe se formati i pyetjes së të pandehurit të gjetur në dosjen hetimore është pasqyruar në procesverbale tip. Ndërsa për sa i përket konstatimit se mungon emri i avokatit në vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq, subjekti ka sqaruar se në këtë vendim është nënshkrimi i pandehurit, ndërsa në aktin për marrjen e tij të pandehur ka vënë vetëm nënshkrimin pa shkruar emër-mbiemër. Më tej, subjekti ka informuar se me vendimin nr. *** (***), datë 9.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pandehuri Gj. L. është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër nga i pandehuri Gj. L., e cila me vendimin nr. ***, datë 23.2.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit. Subjekti ka paraqitur shkresën me nr. *** prot., datë 20.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

116. Nisur nga sqarimet e dhëna nga subjekti dhe nga verifikimi i akteve të dosjes penale, pavarësisht se i pandehuri nuk është pyetur, pasi ka ushtruar të drejtën për të mos dhënë deklaratime, vlerësohet se në dosje nuk ka pse të administrohen formalisht dokumente tip që nuk kanë përmbajtje. Ndërkohë, subjekti nuk ka dhënë sqarime në lidhje me mungesën e datës apo mungesën e emrit dhe të mbiemrit të të pandehurit në aktin “Për njohjen e të pandehurit me aktet” apo vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur”. Çështja i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe shtetasi Gj. L. është deklaruar fajtor, ndërsa nga gjykata nuk janë evidentuar problematika procedurale. Në konkluzion të analizës së kësaj çështjeje në përfundim të procesit, vlerësohet se subjekti duhet të ishte treguar i kujdesshëm në hartimin e

akteve procedurale sipas rregullave mbi nënshkrimin dhe datën e tyre, të parashikuara në nenet 99 dhe 100 të Kodit të Procedurës Penale.

Informacioni i marrë nga burimet arkivore

117. Nga verifikimi i të dhënave arkivore rezultoi se për subjektin Saimir Bahiti: (i) Nuk ka pasur masa disiplinore; (ii) Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta; (iii) Ndaj subjektit të rivlerësimit nuk ka materiale hetimore të regjistruara në prokuroritë pranë gjykatave të Shkallës së Parë; (iv) Për subjektin e rivlerësimit z. Saimir Bahiti ka pasur dy ankesa dhe dy kallëzime penale, trajtuar si më poshtë.

Praktika nr. * prot., datë 20.9.2017**

118. Kjo praktikë ka të bëjë me ankesën e shtetasit P. P. drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Pas trajtimit të ankesës nga Prokuroria e Përgjithshme, ankuesit P. P. i është kthyer përgjigje se për çdo pretendim lidhur me vendimmarrjen e prokurorëve duhet t'u drejtohet gjykatave pranë të cilave ata prokurorë ushtrojnë funksionet. Ndërsa, nëse ngrihen pretendime mbi kryerjen e ndonjë vepre penale, mund të bëjë kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor. Pas kallëzimit penal ndaj subjektit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e datës 6.9.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë është bërë ankim e, nëse po, të japë informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës duke paraqitur vendimin përkatës. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën me nr. *** prot., datë 20.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, sipas së cilës nuk rezulton të jetë ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit të datës 6.9.2018.

Praktika nr. * prot., datë 28.1.2020**

119. Kjo praktikë ka të bëjë me ankesën e shtetasit A. M., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Ankuesi A. M. në tetor të vitit 2018 ka bërë një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për Krime të Rënda Tiranë, pranë së cilës denoncoi korrupsionin e zyrtarëve që punojnë në institucione të ndryshme shtetërore në qytetin e Gjirokastrës. Në tetor të vitit 2018, titullarja e kësaj prokurorie D. P. e ka njoftuar ankuesin për përcjelljen e materialit kallëzues për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, dosje e cila mban numrin ***, ku prokuror i çështjes ishte Saimir Bahiti. Që nga muaji nëntor 2018 që kjo çështje ndodhet për shqyrtim në prokurori, ankuesi A. M. nuk është thirrur nga ana e prokurorit të çështjes dhe, me transferimin e tij, kjo çështje është e bllokuar për mungesë prokurorësh. Ankuesi kërkon që kjo çështje të shqyrtohet dhe të shkojë për gjykim. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila ia ka përcjellë për kompetencë dhe zgjidhje ligjore Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

120. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse nga ana e tij janë kryer të gjitha veprimet hetimore, si dhe informacion mbi ecurinë e hetimit të çështjes që prej paraqitjes së materialit kallëzues në tetor 2018 në Prokurorinë e Gjirokastrës, e përgjatë gjithë periudhës që ai ka ushtruar detyrën në këtë prokurori, duke paraqitur dokumente nga dosja penale.

121. Në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se procedimi penal nr. *** i vitit 2018 është regjistruar në datën 1.11.2018 për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, mbi bazën e materialit kallëzues me palë kallëzuese I. dhe A. M., të ardhura për kompetencë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë. Subjekti ka dhënë sqarime të

hollësisht mbi veprimet hetimore të kryera⁸⁵ në zbatim të urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore të datës 7.2.2019, të dokumentuara në dosjen e procedimit penal. Në datën 18.6.2019, OPGJ-ja ka përpiluar relacionin për përfundimin e hetimeve, ku ka sugjeruar të kërkohet pushimi i procedimit penal në gjykatë. Më tej, subjekti ka informuar se kjo çështje nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga ana e tij, pasi ai në shtator të vitit 2019 ka shkuar përsëri me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe hetimi i çështjes i është ngarkuar prokurores E. M., e cila pas kryerjes edhe të disa veprimeve të tjera hetimore ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 3.2.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë për pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2018. Në mbyllje, subjekti ka informuar gjithashtu se ankuesi ka paraqitur ankim edhe në ILD për të dhe prokuroren E. M., ankim i cili është gjetur i pabazuar dhe është arkivuar nga ky institucion. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dosjen e procedimit penal nr. *** të vitit 2018.

122. Nga verifikimi i akteve të dosjes së procedimit penal konstatohet, ndër të tjera, se: (i) shtetasit Ilir Miziri (kallëzues së bashku me shtetasin A. M.), ka paraqitur ankesa edhe pranë ILD-së në lidhje me prokurorët Saimir Bahiti dhe E. M. Ky institucion, në kuadër të verifikimeve të tij, ka kërkuar nga Prokuroria Gjirokastrë informacion të detajuar mbi ecurinë e hetimeve të procedimit penal, si dhe memot e kallëzuesve dhe përgjigjet e institucionit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtuesi i Prokurorisë Gjirokastrë me shkresën nr. ***, datë 27.4.2021, ka informuar ILD-në mbi ecurinë e hetimeve; (ii) sa u përket kërkesave apo memove të kallëzuesve I. M. dhe A. M., informohet se këta shtetas nuk kanë paraqitur memo apo kërkesa, por ato janë paraqitur nga shtetasja T. M., por pa u paraqitur ndonjë prokurë nga ana e saj. Në këtë informacion evidentohen 5 kërkesa nga kjo shtetase, përkatësisht të datave: 19.3.2020, përcjellë prokurorit të ri të çështjes në datën 7.7.2020 (nuk evidentohet nëse është kthyer përgjigje ose jo); kërkesë e datës 21.10.2020, për të cilën është kthyer përgjigje nga shërbimi për qytetarët pranë Prokurorisë; kërkesë e datës 3.2.2021, së cilës i është kthyer përgjigje me shkresën nr. ***, datë 10.2.2021; kërkesë e datës 15.4.2021, së cilës i është kthyer përgjigje me shkresën e datës 19.4.2021.

123. Në konkluzion, nga analiza e akteve të dosjes së procedimit penal dhe sqarimet e dhëna nga subjekti, vërehet se çështja ka qenë në hetim nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë disamujore nëntor 2018 – qershor 2020 dhe, pas largimit të tij në një tjetër prokurori, hetimet kanë vijuar nga një tjetër prokurore, e cila i ka dhënë dhe zgjidhjen përfundimtare çështjes. Gjatë gjithë hetimit të çështjes janë paraqitur gjithsej 5 kërkesa nga shtetasja T. M., nga të cilat vetëm kërkesa e datës 19.3.2020 ka qenë brenda periudhës që subjekti e ka pasur çështjen nën trajtim, për të cilën nuk evidentohet të jetë dhënë përgjigje sipas rregullave të parashikuara në nenin 110, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale⁸⁶.

Informacion i marrë nga kallëzimet për subjektin

124. Për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti ka pasur 2 kallëzime penale dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë: (i) kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018, mosfilluar më datë

⁸⁵Në datën 22.5.2019 është pyetur shtetasja E. H., nëpunëse në ASHK Gjirokastrë (f. 237-239); Në datën 23.5.2019 është marrë në ish-Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sot ASHK, praktika e regjistrimit të provave objekt material konflikti; Është administruar vendimi nr. ***, datë 25.5.2012, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (f. 240-242); Është administruar vendimi nr. ***, datë 8.5.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; Është administruar vendimi nr. ***, datë 21.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; Në datën 13.6.2019 është pyetur shtetasja T. M., palë kallëzuese (f. 249-250); Në datën 18.6.2019 është pyetur shtetasi M. H. (f. 254-255); Në datën 18.6.2019, me procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve, janë marrë dokumente nga shtetasi M. H.; Në datën 14.9.2019, OPGJ, pasi e ka pasur të pamundur gjetjen dhe marrjen në pyetje të shtetasës D. H., ka mbajtur procesverbalin për këqyrjen e të dhënave të administruara në sistemin e të dhënave TIMS.

⁸⁶“1. Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, të paraqesin memorie dhe kërkesa me shkrim. 2. Organi procedues shprehet me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve”.

6.9.2018; (ii) kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018, mosfilluar në datën 20.12.2018. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse ndaj vendimeve të mosfillimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka pasur ankim e, nëse po, të japë informacion mbi vendimmarrjen e gjykatës duke paraqitur vendimet përkatëse. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, sipas së cilës nga verifikimi i kryer nuk rezultoi të jetë ushtruar ankim ndaj të dyja vendimeve.

Informacioni i marrë nga denoncimet

125. Gjatë procesit të rivlerësimit janë administruar 8 denoncime nga publiku, disa prej të cilave nga i njëjti person. Nga analiza e tyre rezultoi se në tri prej tyre ngriheshin pretendime që zgjidhen nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit në gjykatë, ndërkohë që Komisioni kreu verifikime të mëtejshme në lidhje me pesë denoncime, të trajtuara si vijojnë:

Tri denoncime nga shoqata *⁸⁷**

126. Në këto tri denoncime ngrihen pretendimet si vijojnë:

- Së pari, pretendohet se referuar lajmeve në portalet *online*, subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti dhe bashkëshortes së tij E. B., në datën 2.2.2017 u janë hequr vizat nga Ambasada Amerikane, me arsyen se kanë prova të arsyeshme që janë përfshirë në korrupsion (trajtuar tek kontrolli i figurës).

- Së dyti, ngrihen pretendime për konflikt interesi në trajtimin e procedimit penal me nr. ***, në kuadër të të cilit subjekti ka kryer veprime hetimore në ngarkim të personit nën hetim P. G., administrator i subjektit “****” sh.a., duke kryer vetë marrjen e informacionit dhe administrimin e provave për shtetasin P. G. dhe shoqërinë, nga i cili ka marrë një hua në shumën 50.000 euro.

- Së treti, ngrihen pretendime për konflikt interesi të subjektit në trajtimin e procedimit penal me nr. *** në lidhje me shtetasin P. M., administrator i subjektit “****” sh.p.k., ku pas disa muajsh hetime, në datën 20.10.2011, ka pushuar akuzën ndaj këtij shtetasi. Ndërkohë në denoncime referohet se në datën 16.2.2013, ora 9:00, subjekti Saimir Bahiti, OPGJ S. P. dhe personi nën hetim P. M., kanë kaluar të tre së bashku në pikën kufitare H. H. me mjetin me targa *** dhe janë kthyer të tre së bashku në të njëjtën datë, 16.2.2013, ora 13:25, po me të njëjtin mjet.

127. Me qëllim verifikimin e pretendimit për konflikt interesi në trajtimin e procedimit penal nr. *, u kryen verifikimet si vijojnë:**

- U administruan deklaratimet e zonjës B. në procesin e saj, e cila ka deklaruar se pas administrimit të dosjes së procedimit penal nr. ***, e përbërë nga 8 volume, nuk i rezultoi që bashkëshorti i saj të ketë kryer veprime hetimore në ngarkim të shoqërisë “****” sh.p.k. apo përfaqësuesve të kësaj shoqërie. Më tej, ajo ka sqaruar se objekti i hetimeve të kësaj dosjeje ka qenë veprimtaria tregtare e shoqërisë “****” sh.p.k., e cila është kallëzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal. Kallëzimi është paraqitur nga DRT Tiranë ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. Sipas saj, ky institucion i specializuar në fushën fiskale ka kryer hetime administrative sipas legjislacionit tatimor dhe ka gjetur me shkelje veprimtarinë e subjektit të kallëzuar. Subjekti tregtar ka pasur marrëdhënie tregtare me shoqëritë “****” dhe “****”, të cilat kanë rezultuar furnizuese në këto marrëdhënie tregtare. Veprimtaria e këtyre subjekteve (“****” dhe “****”) nga autoritetet tatimore është gjetur e rregullt dhe e ligjshme dhe objekt i hetimit nuk ka qenë veprimtaria e shoqërisë “****” sh.p.k. Në përfundim, ajo ka deklaruar se bashkëshorti i saj në dosjen nr. *** nuk ka kryer veprime hetimore në ngarkim të subjektit tregtar “****” sh.p.k. apo përfaqësuesve të kësaj shoqërie.

⁸⁷Shihni tri denoncime nga Sh. Sh. A., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 14.4.2022; nr. *** prot., datë 4.5.2020; nr. *** prot., datë 13.5.2019, në dosjen e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

- U administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁸⁸ dosja e procedimit penal nr. ***, nga aktet e së cilës rezultoi se: (i) në datën 12.11.2009 prokurori Saimir Bahiti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “fshehje e të ardhurave” në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 26.10.2009, paraqitur nga DRT Tiranë lidhur me shoqërinë e *** sh.p.k., me seli në fshatin ***, Koplik; (ii) në datën 14.9.2010 prokurori Saimir Bahiti ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore, ndër të cilat edhe marrje informacioni nga QKR-ja, bankat dhe tatimet për subjektin “****” sh.a.⁸⁹, përgjigjet e të cilave janë administruar në dosjen hetimore; (iii) në datën 6.6.2011 prokurori Saimir Bahiti ka pushuar procedimin penal nr. *** të vitit 2009.

- U administruan shpjegimet e subjektit pranë ILDKPKI-së⁹⁰ në vitin 2016, mbi marrëdhënien me shtetasin P. G., ku subjekti ka deklaruar se ky shtetas është miku i tij nga Shkodra.

- Me qëllim verifikimin e faktit nëse subjekti gjatë trajtimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2009, gjendej në kushtet e ekzistencës së shkaqeve të njëanshmërisë të parashikuar nga nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale⁹¹, u pyet subjekti mbi marrëdhënien me shtetasin P. G. dhe periudhën e nisjes së saj, i cili informoi se⁹² me z. P. G. ka marrëdhënie shoqërore dhe miqësie prej disa vitesh dhe se e ka njohur atë rreth vitit 2011 nëpërmjet mikut të tij K. L. Më tej, ai informuar se nuk ka pasur udhëtime të përbashkëta jashtë shtetit me këtë shtetas, fakt i cili u vërtetua me të dhëna të sistemit TIMS.

Në analizë të të gjitha informacioneve si më sipër, rezultoi se: (i) nga prokurori Saimir Bahiti është regjistruar procedimi penal nr. *** me objekt hetimin e veprimtarisë tregtare të subjektit “****” sh.p.k., në kuadër të hetimit të të cilit është kërkuar informacion edhe për shoqërinë “****” sh.p.k. me administrator P. G.; (ii) në periudhën e trajtimit të këtij procedimi, në vitin 2009, nuk u provua njohja e subjektit me shtetasin P. G., por subjekti ka pranuar se kjo njohje ka nisur rreth vitit 2011, vit në të cilin është pushuar procedimi penal; (iii) në vitin 2012 subjekti ka marrë një hua në vlerën 50.000 euro nga shtetasi P. G.

Në opinionin e tij, vëzhguesi ndërkombëtar⁹³ ngre dyshime serioze për sa i përket respektimit të etikës profesionale nga ana e subjektit referuar veprimeve dhe mosveprimeve të tij në rastin në fjalë dhe i kërkon Komisionit të mbajë në konsideratë të tij këtë situatë.

128. Me qëllim verifikimin e pretendimit për konflikt interesi në trajtimin e procedimit penal nr. *, u kryen verifikimet si vijojnë:**

- Nga hyrje-hyrje daljet në sistemin TIMS të subjektit, rezultoi se subjekti ka udhëtuar me mjetin me targë *** në datën 16.2.2013, dalje në orën 9:00 dhe hyrje në orën 13:25. Po në këtë datë/orë ka udhëtuar me të njëjtin automjet edhe shtetasi P. M., i datëlindjes 10.4.1955, i biri i shtetasve T. dhe L. Nuk u evidentuan udhëtime të tjera para dhe pas vitit 2013.

- I pyetur gjatë hetimit administrativ mbi pronarin e automjetit me targë ***, subjekti ka deklaruar se referuar përgjigjes së DPSHTRR-së, është në pronësi të shtetasit N. L. Gj., por në atë periudhë ka qenë në pronësi të shtetasit S. P., prokuror në Kukës, pretendim i vërtetuar edhe në AMF. Sipas tij, qëllimi i udhëtimit ka qenë për pazare ushqimore për shtëpinë.

⁸⁸Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.7.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

⁸⁹Nga aktet e procedimit penal kjo shoqëri dhe shoqëria “****” sh.a. kanë qenë subjekte tregtare furnitore të subjektit “****” sh.p.k., të cilat kanë lëshuar fatura tatimore shitjeje. Me qëllim verifikimin e vërtetësisë së këtyre faturave janë kryer hetime edhe në lidhje me këto dy shoqëri.

⁹⁰Shihni procesverbalin e pyetjes së subjektit pranë ILDKPKI-së të datës 25.3.2016 në dosjen e subjektit.

⁹¹Neni 26 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanshësie, për rastet e parashikuara nga neni 17.

⁹²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 13.6.2022, në dosjen e Komisionit.

⁹³Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 7.12.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 9.12.2022, në dosjen e Komisionit.

- Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për subjektin “****” sh.p.k. me NIPT ***, në faqen zyrtare të QKB-së, rezultoi se administrator i kësaj shoqërie është shtetasi F. M., ndërsa ortak i saj është shtetasi P. M. Nga dokumentet e QKB-së vërehet se shtetasi P. M.⁹⁴ është autorizuar nga administratori i shoqërisë për të kryer veprime në emër të saj. Nga verifikimi në sistemin e GJC rezultoi se të tre këta shtetas janë vëllezër.

- U administrua nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër⁹⁵ dosja e procedimit penal nr. *** të vitit 2010, nga analiza e akteve të së cilës rezultoi se:

a. Me urdhrin e datës 28.1.2010, subjekti Saimir Bahiti ka regjistruar procedimin penal nr.*** të vitit 2010, për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ndërsa në datën 15.6.2010 ai ka urdhëruar regjistrimin e emrit të subjektit juridik “****” sh.p.k. dhe shtetasit P. M. në regjistrin e njoftimit të veprave penale, pasi nga materialet hetimore me këtë procedim janë konstatuar të dhëna të mjaftueshme për të ngritur dyshimin se shtetasi P.M., administrator i “****” sh.p.k., ka falsifikuar dhe përdorur dokumente të falsifikuara;

b. ka pesë urdhra për zgjatjen e afatit të hetimeve si vijojnë: (i) urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve datë 15.6.2010 me tre muaj, me argumentin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore (nuk përcaktohet pse dhe veprimet konkrete); (ii) urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve datë 15.9.2010 me tre muaj, me argumentin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore (nuk përcaktohet pse dhe veprimet konkrete); (iii) urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 15.12.2010, me tre muaj, me argumentin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore (nuk përcaktohet pse dhe veprimet konkrete); (iv) urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 15.3.2011, me tre muaj, me argumentin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore (nuk përcaktohet pse dhe veprimet konkrete); (v) urdhër për zgjatjen e afatit të hetimeve, datë 15.9.2011, me tre muaj, me argumentin se hetimi i këtij procedimi penal nuk u përfundua në afatin e caktuar dhe është e nevojshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore (nuk përcaktohet pse dhe veprimet konkrete);

c. në datën 13.7.2011 shtetasi P. M. (atësia T., mëmësia L.), i datëlindjes 10.4.1955, ka dhënë deklaratimet e tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pranë OPGJ S. P.;

d. në datën 20.10.2011 prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2010;

e. nuk ka të dhëna që të jetë ushtruar ankim ndaj këtij vendimi.

Nga aktet e mësipërme rezultoi se: (i) subjekti Saimir Bahiti ka trajtuar në vitin 2010 një çështje me shtetasin P. M., i cili është drejtues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., të cilën e ka pushuar në vitin 2011; (ii) ka urdhra për zgjatje të pajustificuara të afatit të hetimeve në raport me kushtet e parashikuara në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit zgjatja e afatit kushtëzohet me kompleksitetin e hetimeve dhe pamundësisë për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur dhe mungesë të veprimeve hetimore në periudhat e afateve të shtyra; (iv) në vitin 2013, subjekti ka udhëtuar së bashku me këtë shtetas me automjetin me targë ***.

Barra e provës që i ka kaluar subjektit në lidhje me konstatimet gjatë shqyrtimit të denoncimeve të shoqatës ***

129. Bazuar në sa është evidentuar në paragrafët 127 dhe 128, në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me çështjet objekt denoncimi, që u përkasin shtetasve P. M. dhe P. G., duket se: (i) subjekti ka treguar mangësi në drejtim të aftësive organizative dhe profesionale në trajtimin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit P. M., sipas nenit 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016; (ii) subjekti ka treguar mungesë të etikës profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr.

⁹⁴ Nga aktet e dosjes së procedimit penal nr.*** rezultoi se ky shtetas është drejtues ligjor i shoqërisë

⁹⁵Shihni dosjet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në dosjen e Komisionit.

96/2016, për shkak të marrëdhënieve me shtetasit P. M. dhe P. G.. Bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova e dokumente shkresore për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. * dhe udhëtimin me shtetasin P. M.**

130. Në lidhje me procedimin penal nr. ***, që i përket shtetasit P. M., subjekti ka informuar, ndër të tjera, se ky procedim penal është regjistruar në datën 28.1.2010, mbi bazën e një shkrese të Degës së Thesarit Malësi e Madhe, e cila në mënyrë të përgjithshme dhe jokonkrete ka kërkuar hetimin për dëmin financiar të shkaktuar nga institucione të ndryshme financiare, një nga të cilat dhe Komuna Qendër Malësia e Madhe. Për këtë institucion grupi i auditimit ka konkluduar se ka shkelje në zbatimin e kontratës së lidhur midis Komunës Qendër dhe subjektit tregtar “****” sh.p.k. me objekt “Sistemim-asfaltimin e rrugës ****”, si dhe zbatimin e kontratës së lidhur midis Komunës Qendër dhe subjektit tregtar “****” sh.p.k. me objekt “Rikonstruksionin e shkollës CU të fshatit ****”. Në datën 15.6.2010 me vendimet përkatëse, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në cilësinë e personave që i atribuohet kryerja e veprës penale, janë shënuar emrat e personave që në zbatimin e këtyre kontratave kanë pasur cilësitë e administratorit ose çdo përfaqësuesi tjetër të shoqërive etj. Subjekti ka përkujtuar në mënyrë të detajuar veprimet hetimore të kryera duke iu referuar akteve shkresore që vërtetojnë këto veprime dhe deklaracionin se marrja e 5 vendimeve për zgjatjen e hetimeve paraprake është diktuar nga kompleksiteti dhe dinamika e hetimit të çështjes. Sipas tij, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, hetimi i çështjes ka pasur një vazhdimësi dhe densitet në veprime hetimore, kjo diktuar nga natyra komplekse e çështjes, ku për hetimin e saj janë kryer rreth 40 veprime hetimore të shtrira në kohë sipas nevojave të hetimit dhe është administruar një volum i madh dokumentacioni, të përbërë nga praktika e shtatë tenderave, kontratave të lidhura për këto tendera dhe dokumentacioni që pasqyrojnë rezultatet e veprimeve hetimore.

131. Në lidhje me udhëtimin me shtetasin P. M. në datën 16.2.2013, ka sqaruar se udhëtimi në këtë datë, që i bie ditë e shtunë, ka qenë për të kryer pazare ushqimore në qytetin e Podgoricës, së bashku me shtetasin S. P. Ai informon se, pasi ka biseduar edhe me z. P., është kujtuar se ky i fundit (në atë kohë prokuror në Kukës) është takuar rastësisht me shtetasin P. M. në pikën kufitare H. H. Meqenëse udhëtimi do të ishte i shkurtër dhe do të ktheheshin për pak kohë, z.M. i kishte kërkuar S. P. të udhëtonte me makinën e tyre deri në ***, qytet 16 km afër kufirit. Më tej, subjekti ka deklaruar se nuk e kujton zotin M. dhe, pavarësisht këtij udhëtimi të rastësishëm me të, nuk e njeh këtë shtetas. Ai deklaracionin se nuk i kujtohet të kenë kryer biseda pune gjatë këtij udhëtimi të shkurtër dhe se në atë moment nuk ka pasur ndonjë procedim penal ndaj z. M. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.12.2022, të z. S. P., në të cilën ky shtetas deklaracionin rrethanat e udhëtimit me shtetasin P. M. me të njëjtën makinë në datë 16.2.2013, duke konfirmuar deklaratimet e subjektit. Në këtë akt noterial shtetasi S. P. ka deklaruar se me këtë shtetas ka pasur njohje për shkak se jeton në të njëjtën zonë, por edhe për shkak se ka kryer veprime hetimore në çështjen penale ***, çështje penale e cila kishte përfunduar me vendim pushimi, shumë kohë më parë se të ndodhte udhëtimi. Më tej, ai ka deklaruar se në atë moment nuk ka vlerësuar të kishte ndonjë konflikt interesi, për shkak se nuk kishte ndonjë çështje në hetim në ngarkim të tij apo shoqërisë së tij dhe në mënyrë të natyrshme e të arsyeshme, duke qenë se në automjetin e tij kishte vende të lira, kishte vlerësuar që ai mund të udhëtonte me të. Ai ka deklaruar gjithashtu që nuk i kujtohet të ketë pyetur z. Bahiti apo të ketë bërë ndonjë prezantim të detajuar, për shkak se nuk i ka dhënë rëndësi fare këtij fakti.

Vlerësimi i Komisionit

132. Sa u takon pretendimeve në lidhje me hetimet e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit P. M., për të cilën ish-in konstatuar zgjatje të afatit të hetimeve dhe mungesë kryerjesh veprimesh hetimore, Komisioni iu referua nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, ku

parashikohen shprehimisht rastet dhe kushtet e zgjatjes së afatit të hetimeve. Sipas kësaj dispozite, zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Gjatë hetimit të çështjes, ashtu sikurse është konfirmuar edhe nga subjekti, janë marrë pesë urdhra për zgjatjen e afatit të hetimeve me nga tre muaj, përkatësisht të datave 15.6.2010; 15.9.2010; 15.12.2010; 15.3.2011; 15.9.2011. Nga verifikimi i këtyre akteve vërehet se, pavarësisht se me urdhrin e datës 15.3.2011 afati është zgjatur me tre muaj dhe në krye të këtij afati do të duhet të ishte disponuar me një tjetër urdhër, një urdhër i tillë mungon dhe veprimet e kryera në periudhën 15.6.2011 – 15.9.2011, nuk do të mund të përdreshin (sikurse është vetë deklarimi i shtetasit P. M. në datën 13.7.2011), sikurse parashikohet në pikën 4 të nenit 324, sipas të cilit provat e marra pas mbarimit të afatit nuk mund të përdoren. Nga përmbajtja e këtyre urdhrave vërehet se në asnjë prej tyre nuk janë përcaktuar veprimet hetimore konkrete që do të kryhen dhe nuk është argumentuar pamundësia objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur, përkundrazi, ato janë të njëjta në formë e në përmbajtje.

133. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, është e vërtetë që lidhur me këtë çështje janë marrë disa të pandehur dhe janë kryer hetime në disa drejtime, por ajo që konstatohet, është që jo në të gjitha rastet veprimet hetimore të kryera justifikojnë afatin e zgjatur, ose këto veprime hetimore për të cilat vetë prokurori shprehet që nevojitet të kryhen, nuk janë kryer në afatin e shtyrë. Konkretisht, 26 veprime hetimore, nga 40 të tilla të kryera, të konstatuara nga aktet e dosjes së procedimit penal dhe të përmendura edhe nga vetë subjekti, janë kryer përpara urdhrin të parë për zgjatjen e afatit të hetimeve të datës 15.6.2010. Këto veprime janë kryer nga subjekti nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, datë 28.1.2010 deri në datën 15.6.2010, pra për një periudhë 5-mujore. Në afatin tremujor 15.6.2010 – 15.9.2010, janë kryer 11 veprime hetimore; në afatin tremujor 15.9.2010 – 15.12.2010, janë kryer tri veprime hetimore; në afatin tremujor 15.12.2010 – 15.3.2011, janë kryer tri veprime hetimore; në afatin e shtyrë me tre muaj 15.3.2011 – 15.6.2011, nuk evidentohen veprime; në periudhën 15.6.2011 - 15.9.2011, për të cilën nuk ka urdhër për zgjatje të afatit të hetimeve, evidentohet kryerja e një veprimi hetimor që është pyetja e shtetasit P. M.; në afatin e shtyrë pas datës 15.9.2011, nuk rezultojnë veprime të tjera dhe në datën 20.10.2011 është vendosur pushimi i procedimit penal.

134. Në përfundim të procesit, mangësitë procedurale të evidentuara në këtë çështje janë mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale, sidomos në kushtet kur subjekti ka udhëtuar me shtetasin nën hetim prej tij, P. M.

135. Në parashtrimet e veta, subjekti është ndalur gjatë në mungesën e një konflikti interesi me shtetasin P. M. gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, pretendim i cili ishte ngritur në denoncimin objekt verifikimi. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar mungesës së të dhënave për njohje të subjektit me këtë shtetas në vitet 2010 dhe 2011 kur është trajtuar çështja penale, Komisioni nuk kishte ngritur dyshime dhe as i ka kaluar barrë prove subjektit në lidhje me këtë fakt e, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësojë parashtrimet e subjektit, pavarësisht argumenteve që ai ka përdorur.

136. Ndërkohë, sa i takon cenimit të etikës për të cilën subjekti është shprehur shkurtimisht se nuk ka shkelur asnjë nga kriteret e nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, në përfundim të procesit, deklarimet e subjektit se ai nuk e kujton dhe nuk e ka njohur shtetasin P. M. dhe se takimi me të ka qenë një takim i rastësishëm së bashku me kolegun S. P. ditën e udhëtimit, vlerësohen të pabesueshme dhe përpjekje për të justifikuar udhëtimin me një person të proceduar penalisht prej tij, pasi:

i) në vitet 2010 dhe 2011 subjekti ka trajtuar çështjen penale në ngarkim të P. M. në një periudhë prej 1 viti e 9 muajsh;

ii) udhëtimi në 16.2.2013 me shtetasin P. M. ka qenë me mjetin në pronësi të shtetasit S. P., i cili në datën 13.7.2011 ka pyetur në cilësinë e OPGJ-së shtetasin P. M.;

iii) vetë shtetasi S. P. në deklaratën noteriale të paraqitur nga subjekti në parashtrime, ka deklaruar se me këtë shtetas ka pasur njohje për shkak se jeton në të njëjtën zonë, por edhe për shkak se ka kryer veprime hetimore në çështjen penale nr. ***, çështje penale e cila kishte përfunduar me vendim pushimi, shumë kohë më parë se të ndodhte udhëtimi.

Në këto kushte, bëhet i pabesueshëm deklarimi i subjektit që nuk e ka njohur shtetasin P. M. Edhe nëse do të konsiderohet i besueshëm ky deklarim, minimalisht subjekti duhet dhe e kishte të gjithë mundësinë të pyeste kolegun e tij në lidhje me bashkudhëtarin P. M., duke shmangur udhëtimin me këtë shtetas.

137. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, duke mbajtur në konsideratë parimet e Bangalorit⁹⁶, ashtu sikurse dhe vëzhguesi ndërkombëtar orienton, sipas të cilave etika nuk zbatohet vetëm në përmbushjen e detyrave të gjyqtarit apo prokurorit, por ajo përfshin edhe sjelljen në jetën private dhe aktivitetet jashtëgjyqësore, udhëtimi i subjektit me shtetasin P. M., i cili ishte marrë si i pandehur nga vetë subjekti rreth një vit e gjysmë më parë, shoqëruar me disa problematika procedurale, sikurse është evidentuar më sipër në këtë vendim, vlerësohet si cenim i etikës së prokurorit dhe besimit të publikut te subjekti si pjesë e sistemit të drejtësisë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me procedimin penal nr. * dhe marrjen e huas nga shtetasin P. G. dhe vlerësimi i Komisionit**

138. Në lidhje me shtetasin P. G., subjekti ka deklaruar se në kuadër të trajtimit të procedimit penal nr. ***, nuk janë kryer veprime hetimore në ngarkim të shoqërisë “****” sh.p.k., administrator i së cilës është ky shtetas. Sipas tij, objekt i hetimeve të këtij procedimi ka qenë veprimtaria tregtare e shoqërisë “****” sh.p.k., e kallëzuar nga DRT-ja Tiranë. Ky subjekt ka pasur marrëdhënie tregtare me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k. të cilat kanë rezultuar furnizuese në këto marrëdhënie tregtare dhe, me qëllim që hetimi të ishte i plotë dhe për verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në tatime të shoqërisë “****” sh.p.k., është urdhëruar prej tij marrja e informacionit edhe për këto dy shoqëri (“****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.). Ai deklaroi se në kohën e kryerjes së këtyre veprimeve nuk ka pasur asnjë njohje me administratorin e shoqërisë “****” sh.p.k., zotin P. G.. Sipas tij, pretendimi i shoqatës “****” për konflikt interesi është i pabazuar, pasi shoqëria “****” sh.p.k. dhe administratori i saj nuk kanë qenë subjekt i ndonjë procedimi penal që ai ka pasur nën hetim (person që i atribuohet kryerja e veprës penale, person nën hetim, i padënuar, viktimë, viktimë akuzuese, paditës, apo i paditur civil në procesin penal). Në konkluzion, duke iu referuar neneve 17 dhe 24 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe vendimit të Kolegjit nr. 16/2020, në lidhje me rastet e heqjes dorë nga hetimi i çështjes, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit dhe praktikës së GJEDNJ-së mbi interpretimin e gjykatës së paanshme, subjekti ka pretenduar se nuk ka qenë në asnjë rast në kushtet e konfliktit të interesit.

139. Pavarësisht këtyre pretendimeve, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni nuk kishte ngritur dyshime në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi, duke mos i kaluar barrë prove apo kërkuar sqarime subjektit të rivlerësimit. Në kalimin e barrës së provës, Komisioni është fokusuar vetëm në konstatimin se subjekti ka treguar mungesë të etikës profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, për shkak të marrëdhënies me shtetasin P. G., nga i cili kishte

⁹⁶ Parimet Bangalore të sjelljes gjyqësore, miratuar në vitin 2002 (në dispozicion në: www.unodc.org); opinioni nr. 3 i CCJE-së në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë, miratuar në vitin 2002 (e disponueshme në: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cje/texte_vis_en.asp); Grupi i Punës i ENCJ, Raporti i Etikës Gjyqësore 2009–2010 (i disponueshëm në www.encj.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf). Ato parime mund të zbatohen, *mutatis mutandis*, edhe për prokurorët.

marrë një hua pa interes në vlerën 50.000 euro. Në parashtrimet e veta, subjekti ka deklaruar në mënyrë të përgjithshme se nuk ka cenuar elemente të etikës profesionale, ndërkohë që është fokusuar me shumë në mungesën e një konflikti interesi me shtetasin P. G. apo shoqërinë që ai përfaqëson.

140. Për të arritur në një përfundim sa më objektiv nëse subjekti ka arritur të kundërshtojë konstatimin për cenimin e etikës, Komisioni risjell në vëmendje faktet e rrethanat, si vijojnë:

- Ndonëse nga subjekti nuk janë kryer veprime hetimore në ngarkim të shoqërisë “****” sh.p.k, në vitin 2009 subjekti ka kryer disa veprime verifikuese në kuadër të trajtimit të procedimit penal nr. ***, dhe në funksion të hetimit të plotë të çështjes, ka administruar një numër të konsiderueshëm dokumentesh shkresore që kanë pasur lidhje me këtë shoqëri, administrator i së cilës ishte zoti P. G.;

- Subjekti deklaroi se në vitin 2009 nuk ka pasur njohje me shtetasin P. G., të cilin e ka njohur rreth vitit 2011 përmes një mikut të tij OPGJ, K. L.

- Në vitin 2012 subjekti ka marrë një hua në një vlerë të konsiderueshme prej 50.000 euro dhe pa interes nga shtetasi P. G..

141. Në vlerësim tërësor të këtyre rrethanave, nga ana e Komisionit nuk çmohet i besueshëm fakti që subjekti ka marrë një hua prej 50.000 euro pa interes nga një shtetas, të cilin sipas deklaramëve të tij kishte vetëm një vit që e njihnte. Nga ana tjetër, edhe nëse merret i mirëqenë pretendimi se njohja me zotin G. ka filluar në vitin 2011, subjekti duhet të shmangte marrjen e kësaj huaje në vitin 2012 nga ky shtetas, i cili ishte administrator i shoqërisë “****” sh.p.k, për të cilën prej tij janë kryer verifikime në kuadër të një procedimi penal, ndonëse jo në ngarkim të kësaj shoqërie. Për më tepër, shoqëria “****” sh.p.k është një shoqëri me precedentë penalë, për shkak se në prokurorinë e Shkodrës janë trajtuar dy procedime penale në ngarkim të saj, përkatësisht në vitet 2015 dhe 2019 (pavarësisht se në një rast subjekti ka hequr dorë dhe në rastin tjetër çështja është pushuar nga një prokuror tjetër). Në këto kushte, marrja e huas në një vlerë të konsiderueshme dhe pa interes nga shtetasi P. G., vlerësohet si një pengesë potenciale e subjektit për të ushtruar detyrën e prokurorit me integritet dhe i pavarur ndaj çdo ndikimi dhe presioni të jashtëm, sikurse parashikohet nga pika 3 e nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, dhe, ashtu sikurse dhe orientohet në opinionin e ONM-së, marrja e huas në vlerën 50.000 euro nga ky shtetas konsiderohet si sjellje që vjen në kundërshtim me etikën e prokurorit dhe që cenon integritetin e tij.

Denoncim nga shtetasja H. K.⁹⁷

142. Në denoncimin e saj, kjo shtetase ngrinte pretendime për hetime jo të plota dhe të njëanshme nga prokurorët A. P. e Saimir Bahiti, që kanë trajtuar çështjen e vëllait të saj, për të cilin ajo pretendon që ka humbur jetën për shkak të mjekimit të gabuar. Nga dokumentacioni bashkëngjitur denoncimit konstatohet se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është regjistruar procedimi penal nr. *** për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

143. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncueses duke i shoqëruar sqarimet e tij me dokumente nga dosja penale. Në përgjigjet e tij të datës 14.9.2022, subjekti ka informuar se ky procedim penal është regjistruar në datën 15.12.2017 mbi bazën e kallëzimit të shtetasit E. A. (djali i viktimës) dhe se hetimet janë ndjekur nga prokurori A. P., i cili ka hequr dorë nga hetimi i çështjes. Pas rihedhjes së shortit, subjekti është ngarkuar për hetimin e kësaj çështjeje, duke ngarkuar OPGJ-në të kryejë veprimet hetimore përkatëse (shihni faqet 409-410, 318, 319-320, 324, 325, 326, 327-328, 364-369, 398-405 të dosjes). Subjekti informon se nuk ka qenë ai që i ka dhënë zgjidhjen përfundimtare çështjes pasi ka ndërprerë komandimin e përkohshëm në Gjirokastrë, dhe se

⁹⁷ Shihni denoncimin nga H. K., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.9.2021, në dosjen e subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti.

sipas vendimit nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, i formës së prerë, ky procedim penal është pushuar me shkakun ligjor se fakti nuk përbën veprë penale. Në mbështetje të sqarimeve të tij subjekti ka paraqitur dosjen e procedimit penal nr. ***.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga verifikimi i akteve të dosjes së këtij procedimi dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se pretendimet e denoncueses për hetime jo të plota dhe të njëanshme nga subjekti i rivlerësimit nuk qëndrojnë.

Denoncim nga shtetasi S. L. K.⁹⁸

144. Në denoncimin e tij ky shtetas ngrinte pretendime se prokurorët Saimir Bahiti dhe Sh. M. kanë mbyllur pa kryer hetime çështjen e kallëzuar prej tij, për të cilën vetëm pas disa ankimeve të tij tek Drejtuesi i Prokurorisë apo Prokurori i Përgjithshëm u bë e mundur kryerja e veprimeve hetimore. Bashkëngjitur denoncimit ka paraqitur vendimin e pushimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2016 të prokurores Sh. M. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit për moskryerje të veprimeve hetimore, duke paraqitur dokumente nga dosja penale mbi veprimet hetimore të kryera prej tij. Në përgjigjet e tij të datës 14.9.2022, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dosjen e procedimit penal nr. ***, nga aktet e së cilës rezultoi se:

- procedimi penal nr. *** është regjistruar në datën 24.4.2016, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi S. K., në të cilin ngrihen pretendime se harta bashkëlidhur një vendimi gjyqësor nga shtetasja Gj. D., me të cilën është në një proces civil gjyqësor, është e falsifikuar, dhe se ekspertët e thirrur nga gjykata në këtë proces kanë kryer ekspertim të rremë.

- me vendimin e datës 17.9.2015 prokurori Saimir Bahiti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.***, datë 30.6.2015, me argumentin se fakti objekt hetimi nuk parashikohet nga ligji si veprë penale. Sipas tij, ekspertët kanë shprehur mendimin e tyre bazuar në njohuritë e tyre profesionale, dhe nuk rezulton që mendimi i tyre të jetë produkt i veprës penale. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe gjykata, e cila ka verifikuar dhe vlerësuar aktin e ekspertimit dhe dokumentet e paraqitura nga palët;

- pas ankimit të këtij vendimi, nga ana e kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. ***, datë 17.12.2015, vendosi shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe dërgimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Shkodër për hetime të mëtejshme. Në pjesën arsyetuese në lidhje me mungesën e veprimeve hetimore të kryera nga organi i Prokurorisë, Gjykata, ndër të tjera, arsyeton se: *“...Nga organi i Prokurorisë nuk është marrë as procesi i gjyqimit civil të gjyqimit të çështjes me paditëse Gj. D. dhe të paditur S. K.”*. Sipas Gjykatës, Prokuroria ka detyrimin ligjor të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme që ndihmojnë në zbardhjen e së vërtetës, duke hetuar çështjen në tërësi dhe duke realizuar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, pasi të ketë shqyrtuar të gjitha provat, atëherë mund të konkludojë nëse ka apo jo elemente të ndonjë veprë penale dhe, nëse po, kush i ka kryer.

- me vendimin e datës 24.4.2016, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “ekspertimi i rremë” dhe më pas ai është zëvendësuar nga prokurorja Sh. M., e cila në datën 17.02.2017 ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale.

145. Pavarësisht sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, nisur nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kryerjen e hetimeve të mëtejshme, duket se subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pa kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

⁹⁸ Shihni denoncimin nga S. L. K., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 7.6.2018.

146. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pas shqyrtimit të kallëzimit dhe të të dhënave të materialit kallëzues, me shkakun ligjor se fakti nuk përmban elemente të veprës penale. Sipas tij, mosfillimi merret referuar shkaqeve ligjore të parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale. Kur fakti i kallëzuar prima face përmban një ose disa shkaqe ligjore të parashikuara nga kjo dispozitë, vendoset mosfillimi i procedimit penal. Në rastin konkret, aktet e pretenduara të falsifikuara nga kallëzuesi i janë nënshtruar hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor nga gjykata civile dhe kjo gjykatë, që ka mbështetur vendimin e saj edhe në këto akte, i ka gjetur ato të rregullta, pasi në të kundërt ajo do të kishte paraqitur kallëzim penal në prokurori. Pra, në disponimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal lidhur me kallëzimin e paraqitur nga shtetasi S. K. është marrë në konsideratë ky presumim ligjor.

147. Në analizë të parashtrimeve dhe akteve të dosjes së procedimit penal, konstatohet se vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë nga subjekti bazuar në nenin 290, pika 1, germa “ç”, “fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”. Në rastin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, referuar dhe afatit që vendos kodi në këtë rast, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit penal (aktualisht), nënkuptohet kryerja e një numri minimal verifikimesh, ku konkretisht është analizuar materiali kallëzues dhe dokumentet e paraqitura nga kallëzuesi (i cili ishte njëkohësisht i paditur në një proces civil gjyqësor), dhe ekspertimet e kryera nga ekspertët, që ai pretendonte se ishin të falsifikuara. Në këtë vendim është arsyetuar se “*ekspertët kanë shprehur mendimin e tyre bazuar në njohuritë e tyre profesionale dhe nuk rezultojnë që mendimi i tyre të jetë produkt i veprës penale*”. Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë nenin 25/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë⁹⁹, sipas të cilave prokurori në ushtrimin e funksioneve të tij është i pavarur, çka nënkupton që qëndrimi i tij mbi çështjet bazohet vetëm në bindjen e brendshme në përputhje me provat dhe ligjin, Komisioni referuar nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, vlerëson se del jashtë tagrit të tij të zëvendësojë logjikën e prokurorit e të japë vlerësime për një vendimmarrje të ndryshme të tij.

Sa i takon shfuqizimit të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga ana e gjykatës, vetë ligji ka parashikuar të drejtën e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin apo pushimin e procedimit penal në fazën e hetimeve paraprake, përcaktuar në nenin 291 dhe 329 të tij. Në lidhje me detyrimet e caktuara nga gjykata në vendimin e saj, konstatohet se në zbatim të vendimit të gjykatës subjekti ka regjistruar procedimin penal sipas urdhërimit të gjykatës, e më pas është zëvendësuar nga një tjetër prokuror, e cila, pasi ka kryer veprimet hetimore të caktuara, ka vendosur pushimin e procedimit penal. Në këto kushte nuk konstatohen problematika në drejtim të zbatimit të detyrave të caktuara nga gjykata.

Informacione të marra pranë agjencive ligjzbatuese dhe institucione të tjera

148. Informacion i marrë nga shkresa nr. * prot., datë 10.5.2017 e DPPPP,** ku referohen informacione për pushimin e çështjeve që i përkasin procedimit penal për rastin S. dhe rastin N.

Në lidhje me rastin S.

149. Pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰⁰ informoi se për procedimin penal nr. ***, datë 2.8.2014, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, është vendosur pushimi i çështjes në datën 24.11.2014 nga subjekti i rivlerësimit. Ky vendim është shfuqizuar më 4.3.2015 dhe është ndjekur nga

⁹⁹Shihni vendimet nr. ***, datë 12.1.2011 dhe nr. ***, datë 12.9.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁰⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.5.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe aktet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.7.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

prokuror tjetër, i cili e ka pezulluar në pritje të letërporosisë së autoriteteve të huaja. Procedimi penal është rifilluar në datën 31.10.2018 dhe aktualisht është nën hetim.

150. Nga aktet e këtij procedimi penal janë verifikuar të gjitha hapat proceduralë të ndërmarrë në lidhje me këtë procedim penal, si vijojnë:

- Mbi bazën e materialit kallëzues të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, sipas të cilave shtetasi G. S. dyshohet për kryerjen e veprimeve me qëllim pastrimin e produkteve të veprës penale nëpërmjet operacioneve bankare, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, prokurori A. Sh. në datën 2.8.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, viti 2014, për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Sipas kallëzimit “... *Dyshimi ka lindur nga transfertat bankare të kredituara në llogarinë e shtetasit G. S., si dhe nga verifikimet e para që janë kryer në lidhje me emërtesat e këtyre transfertave dhe urdhëruesve të tyre. Në datën 23.7.2014, në llogarinë e shtetasit G. S. tek BKT është kredituar shuma 199 972 euro. Urdhëruesi i kësaj transferte ka qenë subjekti ‘***’ me adresë Panama. Banka urdhëruese ka qenë ‘***, Geneva’ Zvicër. Përshkrimi i transaksionit është blerje vile Durrës, zona ***. Në datën 24.7.2014, në llogarinë e shtetasit G. S. tek BKT është kredituar shuma 242.972 euro nga i njëjti urdhërues dhe bankë urdhëruese dhe me të njëjtin përshkrim të transaksionit. Në datën 30.7.2014, shtetasi G. S. është paraqitur në bankën BKT dhe ka bërë kërkesë për transferimin e shumës prej 345 000 euro tek subjekti tregtar “***” sh.p.k për të realizuar këmbimin nga euro në lekë. Ndërsa pjesën e mbetur të shumave të kredituara në datat 23 dhe 24 korrik ka kërkuar ta tërheqë në dorë (cash)”.*

- Me vendimin nr. ***, datë 4.8.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën e prokurorit ka vendosur sekuestron preventive mbi llogarinë bankare të shtetasit G. S. tek BKT;

- Me vendimin e datës 12.11.2014, Drejtuesi i Prokurorisë Durrës, B. H., ka vendosur zëvendësimin e prokurorit A. Sh. me prokurorin Saimir Bahiti.

- Me vendimin e datës 24.11.2014, subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2014, si dhe urdhërimin për heqjen e sekuestron preventive mbi shumat e depozituara dhe të bllokuara në llogarinë bankare të shtetasit G. S. tek BKT, me argumentin se nuk u provua ekzistenca e faktit sipas materialit kallëzues. Në përmbajtje të këtij vendimi citohet se: “*Pavarësisht sa më sipër mbi pretendimet e ngritura në kallëzimin penal me letërporosi, u është kërkuar autoriteteve kompetente gjyqësore të shtetit italian kryerja e disa veprimeve hetimore, të cilat do të bënin të mundur administrimin e të dhënave hetimore të rëndësishme për evidentimin e fakteve e rrethanat që lidhen me burimin e vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe me vërtetimin e marrëdhënies civile të pasqyruara në referencat e këtyre transaksioneve”.*

- Me shkresën që mban datën 25.11.2014, pra një ditë pas vendimit të pushimit, u është dërguar letërporosi autoriteteve gjyqësore kompetente italiane;

- Pas ankimit të DPPP, Prokuroria e Përgjithshme, drejtoria Task Force, me vendimin e datës 4.3.2015 ka vendosur shfuqizimin e vendimit datë 24.11.2014 për pushimin e çështjes penale nr.*** të vitit 2014 dhe vazhdimin e ushtrimit të ndjekjes penale sipas ligjit, duke konstatuar, ndër të tjera, se: (i) nuk janë administruar provat e përfituara nga veprimet hetimore të kërkuara për t’u kryer nga autoritetit gjyqësor italian, që kanë të bëjnë me sqarimin e burimit /origjinës së vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe vërtetimin e marrëdhënies civile...” ; (ii) ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, nuk rezulton që vlerat e transaksioneve objekt hetimi, të kryera në dobi të shtetasit G. S., të jenë për blerje vile nga/për shtetasen italiane A. M. P., ashtu sikurse nuk rezulton që të jenë urdhëruar nga kjo shtetase apo që të jenë vlera financiare të saj; (iii) ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, se këto vlera nuk janë produkt i ndonjë vepre penale apo aktiviteti kriminal, nga të dhënat hetimore, marrëdhënia civile e shtetasit G. S. me shtetasen italiane jo vetëm nuk justifikohet me prova, por nuk është bindëse; (iii) ndryshe nga sa arsyetohet në vendim, nuk rezulton të jetë kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme me qëllim për të konkluduar drejt për

ekzistencën e elementeve të veprës penale; (iv) nuk rezulton të jetë sqaruar në mënyrë të plotë aktiviteti kriminal apo masat e dënimit të dhëna për shtetasin G. S.

- Në datën 18.3.2015, Drejtuesi i Prokurorisë ka urdhëruar për ndjekjen e kryerjes së hetimeve prokurorin G. V., e në vijim është caktuar prokurori A. Sh. Ky i fundit në datën 19.12.2016 ka vendosur pezullimin e hetimeve me qëllim administrimin e përgjigjeve të letërporosive ndërkombëtare.

151. Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal pa administruar provat e kërkuara nga autoritetet gjyqësore italiane, që kanë të bëjnë me sqarimin e burimit /origjinës së vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe vërtetimin e marrëdhënies civile. Në këto rrethana, duket se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme me qëllim për të konkluduar drejt për ekzistencën e elementeve të veprës penale. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

152. Në parashtrimet e tij subjekti ka deklaruar se pasi janë administruar të gjitha provat e mundshme nga autoritetet shqiptare dhe nga shtetasi G. S., me vendimin e datës 24.11.2014, ai ka vendosur pushimin e procedimit penal sipas nenit 328/1, germa “b” e Kodit të Procedurës Penale, duke parashtruar në mënyrë të detajuar disa fakte të marra në konsideratë nga ana e tij si: (i) vlera e dy transaksioneve nuk ka qenë nën minimumin ligjor, që detyron autoritetet përkatëse të përmbushin detyrimin për ta raportuar atë tek DPPP Tiranë. Pra transfera nuk është e copëtuar për t’iu shmangur kontrollit të saj nga autoritetet bankare dhe të DPPP Tiranë (ligji shqiptar e ka deri në 1.000.000 lekë, subjektet përkatëse nuk kanë detyrimin ligjor të raportojnë); (ii) lëvizja e parave është bërë nëpërmjet sistemit bankar dhe jo në rrugë të tjera, jo ligjore. Banka Zvicerane nuk ka dhënë ndonjë informacion për dyshime në lidhje me këtë transfertë, por e ka parë të rregullt atë, pasi në të kundërt nuk do e bënte ose do njoftonte autoritetet bankare shqiptare për çdo dyshim, kjo dalë nga praktika e hetimit të këtyre çështjeve; (iii) Shtetasi G. S., i cili nuk ka rezultuar i dënuar në Shqipëri (nuk ka pasur informacion për statusin e tij në Itali), zotëronte me vëllezërit e tij shoqëri tregtare si në Shqipëri dhe në vendin fqinj Itali me kapitale në vlera të konsiderueshme, të deklaruara në të dyja vendet (qindramijëra euro/miliona) dhe pasuri, çka tregonin për një besueshmëri të tij në marrëdhënie me shtetasen italiane.

Sipas tij, vendimi i pushimit është marrë në bazë të të dhënave hetimore të përfituara nga provat e administruara në dosje, si dhe në kushtet kur nga këto prova nuk ka dalë e kundërta për të çuar në konkluzionin se transfera nuk është shprehje apo formë e pastrimit të produkteve të veprës penale, por një marrëdhënie civile. Subjekti deklaroi gjithashtu se, pasi janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore në Shqipëri, me letërporosi i është kërkuar kryerja e disa veprimeve hetimore autoriteteve gjyqësore italiane, dhe se administrimi i këtyre të dhënave do të shërbente për të hedhur dritë mbi rastin dhe për zgjidhjen në themel të tij.

153. Në lidhje me pushimin e procedimit penal pa administruar provat e kërkuara nga autoritetet gjyqësore italiane, duke iu referuar shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.12.2022, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, të cilin e ka vënë në dispozicion, subjekti ka deklaruar se në raste të tilla në Prokurorinë shqiptare ishte pranuar praktika që prokurori nuk mund të mbajë të hapur hetimin, por të mbyllë atë, duke disponuar sipas rastit, me vendim pezullimi ose vendim pushimi, dhe me administrimin e letërporosive ta hapë përsëri atë për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare rastit. Subjekti argumenton se kjo praktikë është ndjekur edhe nga prokurori tjetër A. Sh., i cili me vendimin e datës 19.12.2016 ka vendosur pezullimin e hetimeve, me qëllim administrimin e përgjigjeve të letërporosive të dërguara autoriteteve gjyqësore italiane dhe zvicerane. Më tej, subjekti i

referohet faktit se hetimet në lidhje me çështjen nr. ***, viti 2014, edhe pse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, vazhdojnë ende.

Vlerësimi i Komisionit

154. Siç vërehet, subjekti ka pretenduar se vendimmarrja e tij për pushimin e çështjes është bazuar në administrimin e të gjitha provave të mundshme nga autoritetet shqiptare, ndërkohë që me letërporosi është kërkuar kryerja e disa veprimeve hetimore autoriteteve gjyqësore italiane. Nga njëra anë, vetë subjekti pranon se administrimi i këtyre të dhënave do të shërbente për të hedhur dritë mbi rastin dhe për zgjidhjen në themel të tij dhe, nga ana tjetër, ka pushuar çështjen dhe ka vendosur heqjen e sekuestros me vendimin e datës 24.11.2014 pa administruar nga autoritetet italiane provat që kanë të bëjnë me sqarimin e burimit/origjinës së vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe vërtetimin e marrëdhënies civile. Për më tepër, shkresa e prokurorisë, me të cilën i është dërguar letërporosi autoriteteve italiane, është përpiluar një ditë më vonë nga marrja e vendimit të pushimit, në datën 25.11.2014. Ndërkohë, përkundër sa referon subjekti se prokurori A. Sh. ka ndjekur të njëjtën praktikë, rezulton se ky prokuror ka vendosur pezullimin e hetimeve dhe jo pushimin, me qëllim administrimin e përgjigjeve të letërporosive ndërkombëtare, të cilat ishin kërkuar më parë sipas kërkesës që subjekti u kishte bërë këtyre autoriteteve në datën 25.11.2014.

155. Nga verifikimi i shkresës së lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, informohemi se: *“Në rastet e hetimit të çështjeve që kërkohej kryerja e veprimeve hetimore me letërporosi drejtuar autoriteteve gjyqësore të shteteve të tjera, pasi kryheshin të gjitha veprimet e mundshme hetimore, dosja ose pezullohej në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, kur nuk dihej autori, ose pushohej në përputhje me nenin 328/1, germa ‘dh’, kur nuk provohej kryerja e veprës penale me provat e mbledhura deri në momentin e letërporosisë. Pas miratimit nga Drejtuesi i Prokurorisë, dosja arkivohej në arkivin e Prokurorisë dhe, me ardhjen e letërporosisë, vendimi i pushimit prishej dhe vazhdoheshin hetimet, duke administruar përgjigjen e letërporosisë së autoriteteve të huaja gjyqësore”*. Siç vërehet, sipas kësaj shkrese, pavarësisht se në dispozitat e cituara (nenet 326 dhe 328/1), mungesa e përgjigjes së letërporosisë nuk parashikohet si shkak për pezullimin ose pushimin, në raste të ngjashme kur nuk provohej kryerja e veprës penale me provat e mbledhura deri në momentin e letërporosisë, dosja pezullohej ose pushohej pas miratimit nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë dhe, me administrimin e përgjigjes, vendimi i pushimit prishej dhe vazhdonin hetimet. Në analizë të këtij informacioni, Komisioni çmon se, përveç faktit se praktika e ndjekur bie në kundërshtim me parashikimet ligjore, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është dokumentuar asnjë rast që vërtetonte këtë praktikë pune.

156. Në përfundim të procesit, në një vlerësim tërësor të të gjitha provave të administruara, Komisioni çmon se është e vërtetë që, sipas nenit 24 dhe 25/2 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti në cilësinë e prokurorit, në vendimmarrjet e tij vlerëson provat dhe faktet bazuar në bindjen e tij të brendshme. Por, në rastin konkret u vërtetua se konstatimet e drejtorisë së Task Force pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në vendimin e datës 4.3.2015, për moskryerje të veprimeve të plota hetimore për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme, me qëllim për të konkluduar drejt për ekzistencën e elementeve të veprës penale janë të bazuara, pasi:

(i) Informacioni i Prokurorisë Shkodër, me shkresën nr. *** prot., datë 20.12.2022, në raport me rrethanat konkrete të çështjes, nuk mund të përligjë veprimet e kryera nga subjekti.

(ii) Në vendimin e pushimit, subjekti arsyeton se: *“në lidhje me pretendimet e ngritura në kallëzimin penal, me letërporosi u është kërkuar autoriteteve kompetente gjyqësore të shtetit italian kryerja e disa veprimeve hetimore, të cilat do të bënin të mundur administrimin e të dhënave hetimore të rëndësishme për evidentimin e fakteve e rrethanat që lidhen me burimin e vlerave monetare të përfshira në transaksionet bankare dhe me vërtetimin e marrëdhënies civile të pasqyruara në referencat e këtyre transaksioneve”*. Përkundër sa arsyetohet, deri në ditën e vendimmarrjes së pushimit, kërkesa nuk u ishte drejtuar autoriteteve italiane, pasi ashtu

sikurse ka rezultuar e vërtetuar, kjo kërkesë është bërë nga subjekti një ditë më vonë pasi është marrë vendimi i pushimit.

(iii) Kërkimi i të dhënave me letërporosi nga subjekti pas vendimit të pushimit, në të cilin arsyetohet rëndësia e informacionit nga institucionet e huaja, dëshmon mbi mungesën e një hetimi të plotë me qëllim marrjen e një vendimi sa më të drejte. Nga ana tjetër, vendimi i pushimit të çështjes është shoqëruar me heqjen e sekuestros preventive mbi llogaritë bankare të shtetasit G. S., duke mundësuar kështu lejimin e këtij shtetasi për përdorimin e tyre dhe vijimin e veprimtarisë normale, pa u vërtetuar që këto vlera nuk janë produkt i ndonjë vepr penale apo aktiviteti kriminal. Për më tepër, vetë subjekti në parashtrimet e veta deklaroi se administrimi i të dhënave të përgjigjeve të letërporosive do të shërbente për të hedhur dritë mbi rastin dhe për zgjidhjen në themel të tij.

(iv) Ky rast është një rast i përsëritur nga subjekti (rasti tjetër është trajtuar në paragrafin 157 - 160 të këtij vendimi).

Në këto rrethana, në përfundim të procesit, mosveprimet e subjektit në funksion të hetimeve sa më të plota për çështjen në fjalë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale të tij, në raport me të gjitha rrethanat dhe mangësitë e tjera të evidentuara gjatë vlerësimit të aftësive profesionale.

Në lidhje me dosjen e procedimit penal nr. * për rastin N.**

157. Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁰¹ dosjen e procedimit penal nr. *** për rastin N., nga aktet e së cilës rezultoi se:

- Në datën 15.2.2011, prokurori Saimir Bahiti ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale”, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, sipas të cilit shtetasit P. L. P. dhe A. Q. N. nëpërmjet transferimit të pasurive dhe transaksioneve financiare në vlera të konsiderueshme, synojnë fshehjen apo mbulimin e origjinës së të mirave materiale, të cilat janë ngritur dyshime se janë produkt i veprave penale, për të cilat A. N. vuan dënimin në Gjermani.

- Pas regjistrimit të procedimit penal, me shkresën nr. ***, u është dërguar letërporosi autoriteteve gjyqësore holandeze, ku kërkohet informacion në lidhje me shtetasin A. N., vendbanimin, punësimin, të ardhurat nga puna, prona apo çdo aktivitet në emër të tij apo familjes etj; dënime të tij në shtetin holandez dhe vendimet përkatëse; informacion mbi dënime të shtetasit Q. P. (babai); informacion në lidhje me P. P. (nëna), regjistrimin e saj atje, punësimin apo dënime të mundshme. Me shkresat nr. *** dhe nr. *** u është dërguar letërporosi përkatësisht autoriteteve gjyqësore gjermane dhe autoriteteve belge.

- Me urdhrat e datave 21.3.2011 dhe 5.4.2012 subjekti ka urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, si: marrje informacioni nga Interpoli, informacione bankare në lidhje me llogari bankare të shtetasve të ndryshëm që lidhen me këtë procedim, marrje informacioni identitetesh, marrje informacioni nga BKT-ja lidhur me llogarinë e shtetasit P. L. P., etj.

- Nga aktet në dosje rezulton të jenë administruar: hetimi financiar i DPPP, nga ku kanë rezultuar transaksione financiare pranë BKT-së dhe Raiffeisen Bank në lidhje me shtetasit P. P. dhe A. N.; është marrë informacion nga ALUIZNI, DPSHTRR, informacion nga TIMS, gjendja civile, janë pyetur shtetas; janë marrë informacione nga bankat në lidhje me transaksione të shtetasit P. P. etj.

- Me vendimin e datës 26.3.2012, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur sekuestrimin në cilësinë e provës materiale të praktikave të noterit A. K., si dhe depozitat dhe transaksionet e kryera nga shtetasit P. P., A. N., B. F., R. S. etj.

- Me vendimin e datës 4.6.2012, prokurori Saimir Bahiti ka kërkuar sekuestrimin e praktikave të kontratave të shitblerjes (për 6 apartamente banimi) së pasurive të paluajtshme me palë shtetasin P. P. blerëse dhe R. S. shitëse; pas kërkesës së prokurorit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor

¹⁰¹Shihni fashikujt bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.5.2022, nga Prokuroria Shkodër në dosjen e Komisionit.

Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2012, ka vendosur lëshimin e urdhrin të sekuestrimit të 6 pasurive të paluajtshme në emër të P. P., 7 pasurive të paluajtshme në emër të R. S. dhe dy llogarive bankare. Me urdhrin e datës 29.5.2012, prokurori Saimir Bahiti ka urdhëruar ekzekutimin e vendimit nr. *** të gjykatës.

- Në datën 7.1.2013, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2011. Në datën 29.3.2013, Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë Prokurorisë Shkodër aktet e përcjella nga autoritetet belge. Me vendimin e datës 1.4.2013, Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër, P. K., ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2011, duke argumentuar se përgjigjja e letërporosisë së dërguar autoriteteve belge përmban të dhëna hetimore të reja që kanë të bëjnë me procedimin, të cilat duhet të përkthehen dhe të vlerësohen me të dhënat e tjera hetimore të administruara në dosje.

- Me vendimin e datës 9.7.2013, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. ***, duke arsyetuar se përgjigjja e letërporosisë drejtuar autoriteteve belge nuk përmban asnjë të dhënë të rëndësishme për hetimin. Gjithashtu, prokurori ka parashtruar se autoritetet gjyqësore gjermane dhe holandeze nuk kanë kthyer përgjigje dhe ka arsyetuar se mungesa e të dhënave hetimore, që do të rezultonin nga kryerja e veprimeve nga autoritetet gjermane e holandeze, nuk bën të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.

- Me shkresën e datës 24.10.2013, Prokuroria e Përgjithshme i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër aktet e dërguara nga autoritetet gjermane, ku jepet informacion mbi dënimin e shtetasit A. N. në këtë shtet, deportimin e tij nga Gjermania etj.

- Me vendimin e datës 25.10.2013, Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër, B. C., ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, duke parashtruar se përgjigjja e letërporosisë së dërguar autoriteteve gjermane, përcjellë me shkresën e datës 24.10.2013 nga Prokuroria e Përgjithshme, përmban të dhëna hetimore të reja, të cilat kanë të bëjnë me procedimin që duhet të përkthehen dhe të vlerësohen me të dhënat e tjera hetimore të administruara në dosje.

- Në datën 11.11.2013, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2011, duke arsyetuar se në përgjigjen e tyre autoritetet e drejtësisë gjermane nuk kanë dhënë tjetër informacion për ndonjë të dhënë të rëndësishme për hetimin, siç është kërkuar në letërporosinë drejtuar këtyre autoriteteve. Ai ka arsyetuar se mungesa e të dhënave hetimore nga autoritetet gjyqësore holandeze nuk bën të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.

- Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Pas shqyrtimit të këtij ankimi nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën e datës 4.3.2016 drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është konstatuar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të duhura hetimore, deri në pritje të kthimit të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet holandeze, por duhet t'u ripërsëritet kërkesa autoriteteve gjermane, duke i kërkuar vendimin e gjykatës së landit, si dhe informacion për ndonjë të dhënë të rëndësishme për hetimin, si dhe t'i rikujtohet përsheptimi i kthimit të përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet holandeze.

- Me vendimin e datës 8.3.2016, Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër, G. Sh., ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr. *** të datës 11.11.2013, dhe vazhdimin e hetimeve sipas orientimeve të Prokurorisë së Përgjithshme për kryerjen e veprimeve hetimore përkatëse;

- Me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, ka kërkuar informacion nëse autoritetet gjyqësore të Holandës i kanë kthyer përgjigje letërporosisë, e nëse nuk ka një përgjigje të tillë, t'u bëhet kujtesë këtyre autoriteteve. Kurse me shkresën me nr. ***, datë 10.5.2016, i është drejtuar me kërkesë Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, për ndihmë juridike nga autoritetet gjermane në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2011. Me shkresat e datave 17.5.2016 dhe 24.5.2016, Ministria e Drejtësisë u ka përsëritur kërkesën autoriteteve holandeze dhe gjermane.

- Në datën 26.5.2016, prokurori Saimir Bahiti ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2016. Në këtë vendim, pasi ka parashtruar se ka kryer veprimet hetimore të kërkuara duke i dërguar letërporosinë autoriteteve gjermane dhe një shkresë kujtesë autoriteteve holandeze, prokurori ka arsyetuar se mungesa e të dhënave hetimore, të cilat do të rezultonin nga kryerja e veprimeve nga autoritetet gjyqësore gjermane dhe holandeze, mbi bazën e të cilave do të çmohet nëse pasuritë e shtetasit A. N. dhe familjarëve të tij janë ose jo produkt i ndonjë veprë penale, nuk e bën të mundur zgjidhjen në themel të çështjes penale.

- Pas kërkesës së Komisionit mbi titullarin që ka kryer kontrollin në përfundim të procedimit, Prokuroria Shkodër ka informuar¹⁰² se titullari i institucionit që ka kryer kontrollin e këtij procedimi penal është G. Sh., duke paraqitur kopjen e kapakut të fashikullit të këtij procedimi, në të cilën është shkruar data e arkivimit 14.9.2016, titullar G. Sh.

158. Nga analiza e akteve të këtij procedimi penal, u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka vendosur katër herë pushimin e procedimit penal pa administruar provat e përfituara nga veprimet hetimore të kërkuara për t'u kryer nga autoritetet gjyqësore të huaja. Ndërsa referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar¹⁰³ ka rezultuar se:

(i) nuk ka urdhër për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale në kuadër të hetimit financiar;

(ii) nuk është kërkuar asnjë informacion për shtetasin A. P. (mbiemri i mëparshëm i A. N. ishte P.);

(iii) nuk është bërë asnjë hetim për bashkëshorten e A. N.;

(iv) nuk është bërë asnjë hetim ose nuk jepet asnjë informacion nga disa nga zyrat e ZVRPP-së për pronat e paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasve P. (nëna), A., Q. P., R. S. (tezja/halla e A. N.), C. N. (xhaxhai/daja); (v) nuk ka asnjë kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë/regjistrin noterial për kontratat noteriale ndërmjet A. N./P., P. P., Q. P. (babai) me palë të treta të mundshme;

(vi) nuk ka asnjë kërkesë ndaj institucioneve financiare jobankare për ndonjë transaksion mes shtetasve A. N./P., P. P. dhe palëve të treta;

(vii) arsyetimi/provat e ofruara nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhen me deklaratat e dhëna nga personat e pyetur gjatë hetimit. Përkatësisht, I. V. ka deklaruar se apartamentin e ka blerë nga A. N. dhe paratë janë transferuar në llogarinë bankare të N. Ndërsa subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij i referohet A. M., i cili ka kryer transaksione bankare me P. P. për blerjen e banesës nga P. P. (dhe se A. M. është identifikuar dhe është I. V., por nuk është e qartë se si A. M. është identifikuar si I. V.);

(viii) burimi i 200.000 eurove dhe i depozitave të tjera bankare mbeti i pavërtetuar. P. P. kishte deklaruar se këto para janë mbledhur si rezultat i punës së tyre, si emigrantë ilegalë në Belgjikë, Gjermani dhe Holandë;

159. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të marrë të gjitha të dhënat e nevojshme, me qëllim për të konkluduar drejt për ekzistencën e elementeve të veprës penale, duke treguar mungesë të aftësisë profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

160. Në parashtrimet e tij, subjekti ka përshkruar me detaje veprimet hetimore në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal. Ndër të tjera, subjekti ka informuar se për të pasur informacion për një veprimtari të mundshme, të vazhdueshme kriminale apo për të provuar nëse vepra e

¹⁰²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.9.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit.

¹⁰³Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 7.12.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 9.12.2022, në dosjen e Komisionit.

kryer nga A. N. ishte rast i shkëputur apo i përsëritur, me letërporosi është kërkuar ndihmë nga autoritetet gjyqësore të Gjermanisë, Holandës dhe Belgjikës.

Sikurse në rastin S., ai ka informuar se në të tilla raste kur kërkohej ndihmë nga autoritetet gjyqësore të vendeve të tjera, në Prokurorinë Shqiptare ishte pranuar praktika që prokurori nuk mund të mbajë të hapur hetimin, por të mbyllë atë duke disponuar sipas rastit me vendim pezullimi ose vendim pushimi, dhe me administrimin e letërporosive ta hapë/rifillojë përsëri atë për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare të rastit. Sipas tij, e njëjta procedurë është ndjekur edhe në rastin konkret, duke përkrahur në mënyrë të detajuar konfirmimin e vendimeve të tij nga Drejtuesi i Prokurorisë sipas rastit e, pas mbërritjes së përgjigjes së letërporosisë, shfuqizimin e vendimit të mëparshëm. Subjekti ka paraqitur si provë shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.12.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës *“Në rastet e hetimit të çështjeve që kërkohej kryerja e veprimeve hetimore me letërporosi drejtuar autoriteteve gjyqësore të shteteve të tjera, pasi kryheshin të gjitha veprimet e mundshme hetimore, dosja ose pezullohej në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, kur nuk dihej autori, ose pushohej në përputhje me nenin 328/1, germa “dh”, kur nuk provohej kryerja e veprës penale me provat e mbledhura deri në momentin e letërporosisë. Pas miratimit nga Drejtuesi i Prokurorisë, dosja arkivohej në arkivin e Prokurorisë dhe, me ardhjen e letërporosisë, vendimi i pushimit prishej dhe vazhdoheshin hetimet duke administruar përgjigjen e letërporosisë së autoriteteve të huaja gjyqësore.”*

161. Sa u takon konstatimeve të tjera, subjekti ka parashtruar si vijon:

- Në lidhje me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, subjekti ka sqaruar se regjistrimi i emrit i një personi si autor të veprës penale, bëhet vetëm pasi të provohet kryerja e një vepre penale, që në rastin konkret nuk ka rezultuar. Sipas subjektit, nëse emri i personit që i atribuohet kryerja e veprës penale, do të regjistrohej *apriori*, jashtë rregullimit të dispozitës së nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, atëherë do të krijoheshin probleme serioze për ushtrimin e ndjekjes penale shkaktuar nga ecja e afateve të hetimit.

- Në lidhje me mungesën e hetimit financiar në emër të shtetasit A. P. apo bashkëshortes së tij M. K., subjekti pretendon se asnjë nga institucionet, si Drejtoria Vendore e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme, apo DPPPP, nuk kanë dhënë informacione të tjera hetimore apo indicie të tjera, përveç atyre të dhëna në materialin fillestar. I vetmi moment, sipas subjektit, që del emri i bashkëshortes/bashkëjetueses së shtetasit A. N., është materiali hetimor i administruar si rezultat i letërporosisë belge, ku në këtë material përmendet emri i shtetasit M. K. Nga shqyrtimi i këtij materiali nuk ka rezultuar asnjë e dhënë e rëndësishme për hetimin që të flasë për veprimtari kriminale ose për pastrim produkti të veprës penale. Po kështu, sipas tij, në informacionin hetimor nuk përmendet as babai i shtetasit A. N. (i cili kishte ndërruar jetë). Sipas subjektit, janë kryer hetime edhe në lidhje me motrën e shtetasit P. P., ku është hedhur dritë mbi transaksionet bankare të shtetasit A. N., P. P. dhe motra e saj.

- Lidhur me konstatimin se arsyetimi është i ndryshëm me provat për rastin e shtetasit I. V., subjekti deklaron se ky konstatim nuk qëndron, pasi pas administrimit të referencave bankare në bankën BKT është verifikuar se shtetasi që ka bërë derdhjen prej 38.000 euro ka qenë shtetasi I. V.

- Lidhur me shumën prej 200.000 euro subjekti ka deklaruar se nga hetimi nuk është vërtetuar burimi i tyre. Vetë shtetasja P. P. ka deklaruar se ato e kanë burimin nga puna e saj, e bashkëshortit dhe djalit në emigrim në të zezë, nuk është provuar e kundërta. Për këtë arsye, sipas tij, u është dërguar letërporosi autoriteteve holandeze, gjermane dhe belge. Sipas tij, në rastin konkret organi i akuzës ka detyrimin për të provuar nëse pasuritë e shtetasve P. P. dhe A. N. burojnë nga vepra penale ose aktivitete kriminale, gjë që nuk ka rezultuar nga hetimet. Ndërsa krejt ndryshe është rregullimi sipas ligjit nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”. Kështu, sipas këtij ligji, personi i dyshuar (neni 3, pika 1) dhe personat e tjerë (neni 3, pika 2 dhe neni 8) kanë barrën e provës për të justifikuar origjinin

e ligjshme te pasurisë se tyre, për të provuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale a investim të tyre.

- Në përfundim, subjekti ka informuar se një kopje e dosjes i është dërguar Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë për të kryer një hetim pasuror sipas ligjit nr. 9284, datë 30.9.2004, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, për shtetasit A. N. dhe P. P.

Vlerësimi i Komisionit

162. Në lidhje me konstatimin se subjekti ka vendosur katër herë pushimin e procedimit penal pa administruar përgjigjet e letërporosive të autoriteteve gjyqësore të huaja, referuar informacionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Komisioni ka të njëjtin qëndrim si në rastin S., shprehur në paragrafët 154-156 të këtij vendimi.

163. Në lidhje me mungesën e urdhrin për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, në referencë të jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësohet se argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk qëndrojnë. Kështu, në vendimin nr. 2, datë 20.6.2013, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë trajtuar konceptim e subjektit procedural “person të cilit i atribuohet vepra penale”, duke arsyetuar se “...*Cilësia e personit, të cilit i atribuohet vepra penale, fillon: a) ose kur njoftuesi i saj mendon se e di se cili mund të jetë autori i veprës penale dhe prokurori shënon paralelisht në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, krahas veprës edhe emrin e personit kur ai njihet, ose b) mbasi është bërë regjistrimi i veprës penale, që nga çasti i mëtejshëm kur nga hetimet rezulton një emër personi të cilit i atribuohet vepra penale. Në këto kushte, nuk ka asnjë dyshim se ky cilësim i përket fazës fillestare të procedimit penal... Emri i personit, të cilit i atribuohet vepra penale shënohet në regjistër vetëm në ato raste kur ai është i njohur, por mund të ketë edhe raste kur, shpeshherë, kallëzuesi apo autoriteti referues nuk është akoma në gjendje të tregojë se kush mund të mendohet si autor i mundshëm i një vepre penale në fillimin e hetimeve*”. Nën dritën e këtij arsyetimi, duke qenë se në rastin konkret në kallëzimin penal të paraqitur nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Shkodër, identifikohet qartësisht emri i shtetasit A. N. si autor i dyshuar i veprës penale, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte regjistruar paralelisht, krahas veprës, edhe emrin e shtetasit A. N. si person të cilit i atribuohet vepra penale.

164. Në lidhje me mungesën e veprimeve hetimore, konkretisht mungesën e hetimeve në lidhje me shtetasin A. N., me mbiemrin e tij të mëparshëm P., bashkëshortes, apo babait të tij, argumentet e dhëna nga subjekti se për ta nuk ka pasur informacione në materialin fillestar të Policisë, nuk qëndrojnë dhe janë tërësisht të pabazuara. Organi i akuzës gëzon të drejtën ekskluzive që i njeh ligji të kryejë hetime të pavarura, të pakushtëzuara nga veprimtaria hetimore e institucioneve të tjera. Në këto kushte, gjithmonë duke respektuar bindjen e brendshme të prokurorit në veprimtarinë e tij hetimore, vlerësohet se moskryerja e hetimeve të plota në lidhje me të dyshuarin kryesor dhe personat e tij më të afërt, të cilat konsiderohen bazike nga ana e Komisionit në rastin konkret, tregojnë mangësi serioze në drejtim të hetimit të çështjes.

165. Po kështu, pas verifikimit të akteve të dosjes penale, nuk rezulton i bazuar as pretendimi i subjektit se ai ka kryer verifikime në lidhje me identifikimin e shtetasit A. M. si I. V. Nga aktet e dosjes konstatohet se subjekti ka administruar shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2011 të BKT-së, në të cilën BKT-ja konfirmon se transaksioni i datës 25.4.2007 është kryer nga shtetasi I. V., por jo veprime të tjera që e identifikojnë atë si A. M.

166. Lidhur me konstatimin mbi mungesën e burimit të 200.000 eurove dhe depozitave të tjera bankare, ashtu sikurse konfirmohet edhe nga subjekti, në përfundim të hetimit ky burim mbeti i paprovuar. Komisioni duke mbajtur në konsideratë faktin që në një procedim penal barrën e provës për të provuar kryerjen e veprës penale e ka organi i akuzës, vlerëson se mosvërtetimi i burimit të ligjshëm të shumës 200.000 euro, ka ardhur si pasojë e mungesës e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm nga ana e subjektit të rivlerësimit.

167. Në përfundim të procesit, në një vlerësim tërësor të veprimeve dhe mosveprimeve të subjektit dhe të të gjitha provave të administruara, Komisioni çmon se është e vërtetë që sipas nenit 24 dhe 25/2 të Kodit të Procedurës Penale subjekti në cilësinë e prokurorit në vendimmarrjet e tij vlerëson provat dhe faktet bazuar në bindjen e tij të brendshme, por, në rastin konkret, u vërtetua se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes me qëllim zbardhjen e çështjes, fakt që përkon me informacionet konfidenciale nga organet ligjzbatuese në lidhje me këtë çështje. Përveç kësaj, mospritja e përgjigjeve nga autoritetet e huaja kërkuar me letërporosi është një rast i përsëritur nga subjekti (trajtuar më sipër). Në këto rrethana, mosveprimet e subjektit në funksion të hetimeve sa më të plota për çështjen në fjalë, janë marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale të tij, në raport me të gjitha rrethanat dhe mangësitë e tjera evidentuara gjatë vlerësimit të aftësive profesionale.

Në lidhje me dosjen e procedimit penal nr. *, viti 2016**

168. Nga analiza e akteve të dosjes së procedimit penal nr. ***, viti 2016, e cila është pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të këtij hetimi rezultoi se procedimi penal është trajtuar nga prokurorja B. H. dhe me kryerjen e veprimeve hetimore është ngarkuar OPGJ K. L. Në kushtet kur veprimet hetimore të urdhëruara nga prokurorja janë kryer dhe nuk konstatohen mangësi procedurale, si dhe në kushtet kur kontrolli i dosjes është kryer nga titullari i prokurorisë në atë periudhë G. Sh., nuk mund të arrihet në një përfundim nëse Saimir Bahiti si prokuror në Prokurorinë Shkodër ka ndikuar tek OPGJ K. L. lidhur me këtë rast.

Në lidhje me dosjen procedimit penal nr. ***

169. Nga analiza e akteve të dosjes së procedimit penal nr. ***, e cila është pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, rezultoi se:

- Fillimisht ka qenë prokurori F. L. që ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. *** për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 të Kodit Penal dhe më pas ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore.
- Me vendimin e datës 23.10.2015, nga Drejtuesi i Prokurorisë G. Sh. është vendosur zëvendësimi i prokurorit F. L. me prokurorin S. P.
- Në relacionin mbi përfundimin e hetimeve të kallëzimit penal, të datës 7.12.2015, OPGJ N.L. ka sugjeruar dërgimin për gjykim për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” paragrafi i 3-të dhe “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 186/3 e 248 të Kodit Penal në ngarkim të shtetases G. B.
- Me vendimin e datës 16.2.2016, prokurori S. P. ka urdhëruar shënimin e emrit të personit nën hetim, B. V., në regjistrin e njoftimit të veprave penale, duke argumentuar shkaqet që kanë çuar në këtë vendimmarrje, dhe me vendimin e datës 10.4.2016 ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të noteres G. B.;
- Në datën 26.4.2016 i është përcjellë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të së pandehurës B. V. për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”. Kjo kërkesë është nënshkruar nga zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë Shkodër, Saimir Bahiti, në datën 25.6.2016.
- Pas kërkesës së Komisionit mbi titullarin që ka kryer kontrollin në përfundim të procedimit, Prokuroria Shkodër ka informuar¹⁰⁴ se titullari i institucionit që ka kryer kontrollin e këtij procedimi penal është G. Sh., duke paraqitur kopjen e shkresës përcjellëse me nr. *** prot., datë 26.4.2016, me të cilën është dërguar ky procedim në gjykatë.

169.1. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar materialeve shkresore të administruara, duket se noterja G. B. është përjashtuar totalisht nga përgjegjësia penale, edhe pse detyra e saj

¹⁰⁴Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.9.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në dosjen e Komisionit.

si notere ka qenë pikërisht identifikimi i personit që nënshkruan aktin noterial. Kjo kërkesë është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti në cilësinë e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë Shkodër në atë periudhë. Nga ana tjetër, është i paqartë informacioni i Prokurorisë Shkodër, sipas të cilit titullari i institucionit që ka kryer kontrollin e këtij procedimi penal është G. Sh.

169.2. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë fakt, si dhe mbi rolin e tij si zëvendës drejtues i Prokurorisë Shkodër në trajtimin e këtij procedimi penal, referuar faktit se ka nënshkruar kërkesën për gjykim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se në këtë kohë ka ushtruar detyrën e zëvendës drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe se nuk ka kryer asnjë veprim hetimor. Konkretisht, ai deklaroi se *“Lidhur me nënshkrimin tim në dosje, sqaroj se në praktikën e prokurorisë, dosja përpara se të shkonte tek drejtuesi, kalonte nga zyra e zëvendësuesit. Në praktikën e punës zëvendësuesi kishte rol ndihmës ndaj Drejtuesit të Prokurorisë. Në rastet kur studioja dosjet unë jepja mendim me shkrim, sipas një formulari tip në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të dosjes. Në rastet kur kisha ngarkesë në punë me dosjet në hetim dhe gjykim, pasi kisha ngarkesë të zakonshme pune si prokurorët e tjerë, ashtu dhe në rastet kur kisha konflikt interesi për t’u shprehur për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk shprehja mendim, por thjesht bëja shënimin si në rastin konkret, që tregonte që dosja kishte kaluar sipas procedurës administrative tek zyra e zëvendës drejtuesit. Në rastin konkret, me subjektet e hetuara dhe ato të dëmtuara nuk kam pasur njohje apo konflikt interesi, por mungesë e shprehjes së mendimit dhe hedhja vetëm e nënshkrimit ka ardhur si pasojë e ngarkesës në punë dhe për shkak se nuk kam konstatuar ndonjë fakt për t’u shënuar”*.

Ai i referohet përgjigjes së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në të cilën informohet se kontrolli i dosjes është ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë asokohe, z. G. Sh. Pavarësisht kësaj, sipas subjektit nuk ka pasur asnjë vendimmarrje për hetimin dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale duke deklaruar se *“...në vlerësimin tim, vendimi i pushimit të hetimeve në ngarkim të shtetas G. B. me detyrë notere publike është i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova.... hetimi ndaj noteres është kryer për një akt të përpiluar prej saj, që nga hetimi ka dalë i falsifikuar në nënshkrimin e njëres prej palëve të pasqyruar në këtë akt... Ajo ka kryer procedurën e verifikimit të palëve pjesëmarrëse në këtë akt, duke mbajtur dhe kopje të ID-ve të tyre. Nga hetimi nuk ka rezultuar e provuar nëse identifikimi jo i saktë i njëres palë ka ardhur nga qëndrimi i pakujdesshëm, lajthitja e noteres apo ajo me dashje ka lejuar që një person tjetër të nënshkruajë në emër të një personi tjetër duke përdorur ID-në e tij”*.

169.3. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.12.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku përcillen kopje të kartelave të studimit të disa procedimeve penale, që u përkasin viteve 2013 dhe 2014.

169.4. Nga kartelat e studimit të paraqitura nga subjekti, për rastet e studimit të dosjeve prej tij, vërehet se ato janë sipas një modeli tip, ku përcaktohet shprehimisht se nga kush është kryer studimi i dosjes, ku për rastet e paraqitura është kryer nga vetë subjekti në cilësinë e zëvendës drejtuesit. Duke qenë se në dosjen e procedimit penal objekt shqyrtimi nuk konstatohet një formular tip i tillë, Komisioni bazohet në konfirmimin e dhënë nga Prokuroria Shkodër gjatë hetimit administrativ, e cila ka sqaruar faktin se kontrolli i dosjes është kryer nga Drejtuesi i Prokurorisë asokohe dhe jo nga subjekti i rivlerësimit.

169.5. Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit, pasi: (i) nuk u vërtetua që kontrolli i dosjes të jetë kryer nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e zëvendës drejtuesit të Prokurorisë Shkodër; (ii) sa i takon vendimmarrjes për pushimin e hetimeve për shtetasen G. B., vlerësimi përfundimtar, përveçse i përket themelit të çështjes, i takon prokurorit të çështjes, i cili vendos mbi faktet dhe provat sipas bindjes së tij të brendshme.

Dosja e procedimit penal nr. *, viti 2016**

170. Nga Komisioni u analizua çështja e procedimit penal nr. ***, viti 2016, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga nenet 178/3, 288/a/2, 178/2, në ngarkim të shtetasit N. B., nga aktet e së cilës rezultuan disa veprime hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë përshkruar në mënyrë të hollësishme në aktin rezultatet e hetimit administrativ. Në analizë të këtyre veprimeve nuk u evidentuan mangësi procedurale nga subjekti në trajtimin e çështjes.

170.1. Sa i takon kërkimit të masës së dënimit lidhur me këto vepra penale, Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër¹⁰⁵ vendimin nr. ***, datë 30.5.2017, nga përmbajtja e të cilit konstatohet se prokurori i çështjes Saimir Bahiti, ndër të tjerë, për të pandehurit K. G., N. B., A. M., N. S., ka kërkuar deklarinimin fajtorë për veprën penale “tregtimi dhe transportim i mallrave kontrabandë”, e kryer në bashkëpunim, që parashikohet nga neni 178/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me nga 5 vite. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë kohe prej 5 vitesh.

170.2. Në përfundim, gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprave penale, për të cilat është ngritur akuza nga subjekti, duke caktuar të njëjtën masë dënimi të kërkuar nga prokurori. Konkretisht, për shtetasin N. B. gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor për veprën penale “tregtim dhe transportim i mallrave kontrabandë”, e kryer në bashkëpunim, që parashikohet nga neni 178/3 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e të pandehurit përfundimisht me 3 vite e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit për një periudhë kohe për 4 vitesh.

170.3. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim i pandehuri N. B., dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 11.9.2017, ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. ***, datë 30.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

170.4. Referuar Kodit Penal, për veprën penale “tregtimi dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 178/3, parashikohet dënim me burgim nga pesë deri në 10 vjet. Ndërsa për veprën penale “prodhim i kundërligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimore”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 288/a/2, parashikohet dënim me burgim nga 3 gjer në 10 vjet. Nga aktet e mësipërme rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar minimumin e dënimit të parashikuar për veprat penale të përcaktuara në nenet 178/3 dhe 288/a/2 të Kodit Penal.

170.5. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime e argumente nëse në përfundim të hetimit të këtij procedimi penal është arsyetuar mbi kërkesën e tij për dënimin e të pandehurve në minimumin e parashikuar nga dispozitat e mësipërme të Kodit Penal, dhe në cilin akt të dosjes penale gjen pasqyrim ky arsyetim. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se në konkluzionet përfundimtare, prokuroria ka marrë parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore të autorëve të kryerjes së veprave penale, kushtet në të cilat janë kryer veprat penale, motivin/qëllimin e kryerjes së tyre, moshën e të pandehurve, gjendjen ekonomike, sociale, familjare dhe shëndetësore të të pandehurve (dokumentet bashkëgjitur), përhapjen e veprave penale. Veç këtyre, referuar rrethanave personale për secilin prej të pandehurve, subjekti deklaroi se janë marrë në konsideratë edhe faktet se të pandehurit kanë kryer veprën penale të detyruar për të

¹⁰⁵Shihni dokumentet bashkëgjitur - shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 9.10.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në dosjen e Komisionit.

mbajtur familjet e tyre, pasi nuk kanë pasur asnjë të ardhur për të përballuar jetesën. Subjekti gjithashtu i referohet faktit se kërkesa e Prokurorisë është gjetur e drejtë dhe e bazuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin e saj nr. ***, datë 30.5.2017, ka vendosur sipas kësaj kërkesë. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër.

170.6. Në procesin e vlerësimit të çështjes, sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit u vlerësuan bindëse nga ana e Komisionit, pasi: (i) masa e dënimit të kërkuar nga subjekti për shtetasin N. B. për veprën penale që akuzohet është brenda kufirit të dispozitës së posaçme të Kodit Penal, parashikuar në nenin 178/3 të tij; (ii) subjekti ka arsyetuar në konkluzionet e tij përfundimtare se në dhënien e kësaj mase dënimi janë mbajtur në konsideratë rrethana që lidhen me të pandehurit, si gjendja e tyre familjare, shëndetësore, shoqërore, rrezikshmëria e tyre etj.; (iii) vendimmarrja e subjektit pasi i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor është gjetur e drejtë duke konfirmuar vendimmarrjen e tij. Në konkluzion nuk u konstatuan problematika që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Dosja e procedimit penal nr. * e vitit 2018**

171. Nga Komisioni u analizua çështja e procedimit penal nr. *** e vitit 2018, të regjistruar për veprën penale “*prishje e qetësisë publike*”, të parashikuar nga neni 274, dhe “*mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*” 278/1 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit N. P., të dërguar për gjykim në datën 10.4.2018. Gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprave penale për të cilat është ngritur akuza nga subjekti. Nga shqyrtimi i akteve të kësaj dosjeje janë verifikuar veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ dhe, në përfundim të hetimit, nuk rezultuan problematika.

Dosja e procedimit penal nr. * e vitit 2020**

172. Nga Komisioni u analizua çështja e procedimit penal nr. *** e vitit 2020, regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 278/1, 130/a/2, 274 dhe 84 të Kodit Penal, që lidhet me shtetasin N. Gj., të dërguar me kërkesë për gjykim më 11.11.2020, ku gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprave penale për të cilat është ngritur akuza nga subjekti. Nga shqyrtimi i akteve të kësaj dosjeje, janë verifikuar veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti në cilësinë e prokurorit të çështjes, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ dhe, në përfundim të hetimit, nuk rezultuan problematika.

Dosja e procedimit penal që lidhet me subjektin “**” sh.a.**

173. Pas kërkesës së Komisionit mbi një procedim penal të vitit 2012 që lidhet me subjektin “****” sh.a., Prokuroria Shkodër¹⁰⁶ në përgjigjen e saj të parë informoi se nuk u bë e mundur gjetja e një procedimi të tillë me të dhënat e referuara, duke kërkuar më shumë të dhëna. Në përgjigjen e saj të dytë, Prokuroria Shkodër¹⁰⁷ informoi se nuk rezultojnë kallëzime apo procedime penale në emër dhe në ngarkim të shtetasës D./D. G., administratore e subjektit “****” sh.a.

Ne lidhje me një opinion të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar

174. Në opinionin e tij¹⁰⁸ vëzhguesi ndërkombëtar ka parashtruar disa gjetje në lidhje me etikën e subjektit të rivlerësimit, duke sjellë në vëmendje të Komisionit parimet e Bangalorit apo jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi sjelljen gjyqësore. Sipas këtyre parimeve, etika nuk zbatohet vetëm në përmbushjen e detyrave të gjyqësorit dhe

¹⁰⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.9.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁷Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.9.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁸ Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 7.12.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 9.12.2022, në dosjen e Komisionit.

prokurorisë, ato përfshijnë gjithashtu sjelljen në jetën private dhe aktivitetet jashtëgjyqësore. Gjyqtarët dhe prokurorët, përveç respektimit të ligjit si çdo person tjetër, duhet të sillen me integritet, ndershmëri, vetëpërmbyaje dhe diskrecion, si gjatë, edhe jashtë ushtrimit të detyrës¹⁰⁹. Është pa dyshim e vërtetë se kontaktet e papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar që janë përshtatshme (ose që kanë qenë përfshirë) në krimin e organizuar - por edhe në aktivitete kriminale në përgjithësi - mund të konsiderohet se ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes, dhe prandaj kanë një ndikim negativ në vlerësimin e etikës së një prokurori. Sipas vëzhguesit, subjekti ka pasur njohje dhe kontakte me individë të cilët do të dëmtonin etikën e tij. Vëzhguesi ndërkombëtar sjell në vëmendje të Komisionit disa informacione nga burime publike, në lidhje me personat fizikë dhe juridikë, të cilët dyshohet se kanë qenë kontakte të subjektit të rivlerësimit, të cilat iu bënë të ditur subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

175. Me kalimin e barrës se provës, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente në lidhje me informacionin e këtyre të dhënave të bëra publike. Konkretisht, iu kërkua të informojë nëse ai ka shqyrtuar çështje penale për sa informacionet publike bëjnë me dije, dhe nëse po, të japë sqarime në lidhje me veprimet hetimore duke paraqitur dosjet penale, e nëse jo, ta vërtetojë këtë fakt me dokument shkresor. Në parashtrimet e tij, subjekti informoi se, pasi ka verifikuar informacionet mediatike, ka konstatuar se nuk ka njohje me asnjë nga personat e përmendur në to, përveç shtetasit *F. B., me të cilin deklaroi se “nuk ka miqësi, por njohja me të ka qenë vetëm gjatë kohës që ka biseduar për blerjen e apartamentit si një klient i zakonshëm”*. Subjekti ka paraqitur shkresat e Prokurorisë Shkodër, Kurbin dhe Durrës, nga të cilat vërtetohet se nuk ka hetuar çështje penale ku të përshtatshme në këto çështje të jenë personat e përmendur në mediat online.

Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

176. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, për një vlerësim sa më objektiv të aftësive profesionale, por edhe një vlerësim tërësor të çështjes, Komisioni i është referuar veprimeve/mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit të trajtuara hollësisht në këtë vendim, përmbledhur si vijon:

- Në dy raste, nga pesë dosjet e shortuara, përkatësisht në dosjet nr. 3 dhe 4, janë evidentuar mangësi në drejtim të administrimit të akteve në dosjen penale;
- Në një rast, konkretisht procedimi penal nr. ***, urdhrat për zgjatjen e afatit të hetimeve kanë qenë të pajustificuara në raport me kushtet e parashikuara në nenin 324/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në to nuk parashikohen veprimet hetimore konkrete që nevojitet të kryhen, si dhe ka mungesë veprimesh hetimore në afatin e shtyrë.
- Në dy raste, konkretisht, rasti S. dhe N. të referuara nga organet ligjzbatuese, subjekti nuk ka kryer hetime të plota e të gjithanshme që do të hidhnin dritë mbi faktet e rrethanat e çështjeve me objekt hetimi transaksione të dyshimta në shuma monetare të konsiderueshme.
- Në dy raste u evidentuan elemente që cenojnë etikën e subjektit si funksionar i sistemit të drejtësisë, për shkak të: (i) udhëtimit me një person të proceduar penalisht prej tij; (ii) marrjes së huas prej 50.000 euro pa interes në rrethana të pajustificuara, analizuar hollësisht më sipër në këtë vendim. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe parimeve të Bangalorit, sjelljet e dyshimta, të pajustificuara dhe jo në përputhje me rolin, funksionet, detyrat dhe figurën e një prokurori, të cilët nuk justifikohen nga ushtrimi i funksionit të një magjistrati, kanë një ndikim negativ në vlerësimin e etikës dhe atë të

¹⁰⁹Në lidhje me gjyqtarët, Shihni Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndjekur jurisprudencën e saj të mëparshme në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë* (vendimi i datës 26.9.1995, Dhoma e Madhe, aplikimi nr. ***) dhe çështjen *Kurtulmus kundër Turqisë* (vendimi i datës 24.1.2006, aplikimi nr. ***), mbajtur në çështjen *Ozpinar* (vendimi i datës 19.10.2010, aplikimi nr. ***) që magjistratët kanë detyrë të rezervohen edhe në jetën e tyre private.

përgjithshëm të një prokurori në kuadër të procesit të rivlerësimit. Parë nën këtë këndvështrim, referuar edhe orientimeve të ONM-së në opinionin e datës 7.12.2022, nga ana e Komisionit çmohet se subjekti ka cenuar etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, duke cenuar besimin e publikut te figura e tij si pjesë e sistemit të drejtësisë.

177. Në vlerësimin përfundimtar të aftësive profesionale, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit 58, pika 1/b, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon marrjen e masës disiplinore - pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, pasi, sipas pikës 4 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, mangësitë e evidentuara si më sipër dhe sjelljet e papërshtatshme të subjektit nuk mund të korrigjohen përmes programit njëvjeçar të edukimit.

178. Në përfundim të procesit, pavarësisht se mangësitë procedurale të evidentuara nuk u vlerësuan të tilla që subjekti të vlerësohet “i papërshtatshëm” sipas nenit 44/c të ligjit nr. 84/2016, në një vlerësim tërësor të rrethanave, këto mangësi gërshetuar me rastet e cenimit të etikës nga ana e subjektit, çmohen se kanë çuar në cenimin e besimit të publikut të subjektit si pjesë e sistemit të drejtësisë dhe subjekti ndodhet në kushtet e parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *“Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”*, atij duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

SEANCA DËGJIMORE

179. Në datën 10.1.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Saimir Bahiti dhe shpalli vendimin në seancën e datës 13.1.2023, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

180. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm dhe bashkëpunues, pasi i është përgjigjur brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime për informacionin e kërkuar.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

181. Bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi që vendimmarrja për subjektin Saimir Bahiti të bazohet në përfundimet në vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2014. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, në një vlerësim tërësor të rrethanave për të tria kriteret e vlerësimit, trajtuar hollësisht në këtë vendim, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Saimir Bahiti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit në pikën 5 të nenit 61, pikat 6 dhe 7 të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Saimir Bahiti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.1.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli